



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2049/ 21 prot.

Datë 16.02.2026

V E N D I M
Nr. 261/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK, si dhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK dhe “Kristalina KH” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e

lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik *“Marketing & Distribution” SHPK dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.*

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik *“Kristalina KH” SHPK dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “Dynamicx Group” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.*

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, si dhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK me NIPT L42306022T, me adresa: Zona Kadastrale 3183, Nr. Pasurie 30/13, Krujë.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK me NIPT L01524018M me adresa: Lagjia “Qafe Kasha”, Ndertese Private Nr. 5, Autostrada Tiranë - Durrës, km 6, Tiranë.

Operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK me NIPT K11501002D me adresa: Rruga “Lord Bajroni” Laprakë, Tiranë.

Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK me NIPT J72124001N me adresa: Autostrada Tirane - Durres, Km. 10, Tiranë.

Operatori ekonomik “Adel Co” SHPK me NIPT L22117021M me adresa: Rruga “Efendiu”, Nr. 13, Kodi 1050, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ndërsa operatori ekonomik “Adel Co” SHPK nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.04.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa

TVSH, ose 748,658.1 (*shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një*) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.2. Në datën 23.06.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe informacionit të autoritetit kontraktor ardhur me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2049/5 prot, datë 13.08.2025, rezulton, se më datë 14.07.2025 operatori ekonomik i kualifikuar i pari “*Kristalina KH*” SHPK i është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor dorëzimi i dokumentacionit sipas parashikimeve ligjore.

II.4. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe informacionit të autoritetit kontraktor ardhur me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2049/5 prot, datë 13.08.2025, rezulton, se më datë 16.07.2025 operatori ekonomik i kualifikuar i pari “*Kristalina KH*” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin pranë autoritetit kontraktor sipas parashikimeve ligjore.

II.5. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe informacionit të autoritetit kontraktor ardhur me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, rezulton se në datën 14.07.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ <i>Kristalina KH</i> ” SHPK	46,336,920	lekë	kualifikuar
2. “ <i>Marketing & Distribution</i> ” SHPK	47,041,415	lekë	kualifikuar
3. “ <i>Dynamicx Group</i> ” SHPK	47,717,240	lekë	skualifikuar
4. BOE “ <i>Office Paper</i> ” SHPK & “ <i>Inpress</i> ” SHPK	53,595,760	lekë	kualifikuar
5. “ <i>InfoSoft Office</i> ” SHPK	59,699,557	lekë	skualifikuar
6. “ <i>Adel Co</i> ” SHPK	64,666,170	lekë	skualifikuar
7. “ <i>Albdesign PSP</i> ” SHPK	73,640,790	lekë	skualifikuar

II.6. Në datën 14.07.2025, operatori ekonomik “*Dynamicx Group*” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

1. OE “*Dynamicx Group*”, nuk përmbush kriteret e vecanta të kualifikimit, piken 1, pasi nuk arrin të ketë realizuar për një nga vitet 22-23-24 një vlere sa fondi limit 74,439,074 leke, pasi:

- *Xhiro e realizuar nga operatori per vitin 22 eshte – 23,165,932;*
- *Xhiro e realizuar nga operatori per vitin 23 eshte – 22,199,583*
- *Xhiro e realizuar nga operatori per vitin 24 eshte – 23,165,932*

Gjithashtu, DT nuk ka kufizuar operatorët ekonomikë ofertues që të mbështeten në kapacitetet e subketeve të tjera në lidhje me xhiron vjetore. Në rregullat e prokurimit publik

konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë se: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;” Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcaktuar që: “4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Dynamicx Group” Shpk, në rastin konkret kemi një kontratë angazhimi, të nënshkruar midis palëve, për mbështetjen e shoqërisë “Dynamicx Group” sh.p.k mbi kapacitetet e shoqërisë “Europaper” sha, ku do të angazhohet që të mbështesë shoqërinë “Dynamicx Group” sh.p.k sipas pikës në DST 2.2/1 për Xhiron 22-23-24 Në rastin konkret, duke gjykuar se, operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” si subjekt mbështetës operatorin ekonomik “Europaper” sha, lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.2/1 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, KVO gjykon t’i drejtohet urdhërimeve të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku është përcaktuar qartë se: “4.Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”. Referuar parashikimeve më sipër duhet që operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK, si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera të plotësojë 50% të kërkesës së përcaktuar në pikën 2.2/1 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë ndërkohë ky operator rezulton të jetë mbështetur me shume se 50% te subjekti mbështetës “Europaper” sha i deklaruar si subjekt mbështetës në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit çfarë bie ndesh edhe me parashikimet e dispozitës më sipër. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. KVO gjykon se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo gjykohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve financiare, teknike dhe profesionale si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik është përcaktuar që jo vetëm duhet të deklarohet në

dokumentet e ofertës mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera por janë përcaktuar edhe kriteret për këtë mbështetje, njëri prej të cilëve është që në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, dispozitë e cila në rastin konkret me dokumentacionin e paraqitur nuk plotësohet nga “Dynamicx Group” SHPK pasi ky OE është mbështetur mbi 50% të xhiros vjetore 2022-2023-2024 të operatori ekonomik “Europaper” sha, lidhur me Kapacitetin ekonomik dhe financiar pika 2.2/1 e DT. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KVO thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente dhe kërkesat ligjore duhet të refuzohen si të papranueshme. Për këtë arsye, operatori ekonomik skualifikohet.

2. Nuk permbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 2.2./1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” pasi referuar Totalit të Ardhurave/(Humbjeve) Gjithëpërfshirëse (1+/-7) për vitin 2023, rezulton të jete me humbje në vlerën (16,570,683) leke si edhe Totali i të Ardhurave/(Humbjeve) Gjithëpërfshirëse (1+/-7) për vitin 2024 rezulton po ashtu me humbje në shumën (17,172,929) leke. Operatori nuk e ka permbushur kriterin i cili specifikon se: Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin konkret, rezulton se dy bilancet e njëpasnjëshme 2023 + 2024 kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit për këtë arsye OE skualifikohet.

3. Nuk permbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 3, pasi nuk ka paraqitur Autorizim nga Prodhuesi dhe/ose Autorizim nga Distributori i cili duhet të ishte i Autorizuar nga Prodhuesi për mallrat objekt prokurimi. Në vetmin dokument që OE ka paraqitur për përmbushjen e kriterit të vecante të kualifikimit është Autorizimi leshuar nga "EURO-PAPER" sha i cili nuk rezulton të jete Prodhues dhe as Distributor i ndonjë prodhuesi por thjesht shfaqet në Autorizim në cilesinë e Tregetuesit: “objekt tregetar: "Tregetim dhe import - eksport me shumicë dhe pakicë të letres së shkrimit dhe amballazhimit, furnizimi me material leter i shtypshkronjave, shtepive të botimit. etj.” Pra, edhe sikur subjekti në fjalë "EURO-PAPER" sha të ishte Distributor ai duhet që në përmbushje të kriterit të vecante të kualifikimit të paraqiste: Autorizim nga Prodhuesi ose nga Distributori i autorizuar nga prodhuesi duke vertetuar lidhjen midis Distributorit dhe Prodhuesit. Në rastin kur Autorizimi do të ishte leshuar nga Prodhuesi atëherë në këtë autorizim duheshin të dhenat të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, ëbbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi.

II.7. Në datën 22.07.2025, është publikuar Njoftimi i Fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku fitues rezulton operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK

II.8. Në datën 31.07.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar me numër elektronik ankimi A/2025/5622 dhe me nr. 2049/2025 protokollin, datë 31.07.2025 e operatorit ekonomik “Dynamicx Group” SHPK për procedurën e

“Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimit të tij si dhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin operatorëve ekonomikë “Marketing & Distribution” SHPK, “Kristalina KH” SHPK dhe BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, si më poshtë vijon:

Per arsyen e pare te s’kualifikimit qe OE “Dynamicx Group” shpk nuk arrin të përmbushë 50% të kërkesës për xhiron vjetore të parashikuar në DST, për të pasur të drejtë qe të mbështetet tek një subjekt tjetër, duam te theksojmë se shoqëria “Dynamicx Group” shpk ka deklaruar qartë në Formularin Permbledhes te Vetdeklarimit se mbështetet tek i euro Paperë shpk, dhe ka dorëzuar marreveshjen e angazhimit të nevojshme si edhe dokumentacionin qe verteton kapacitetin financiar te subjektit mbeshtetes. Qëllimi i nenit 90 pika 2 është të parandalojë abuzimin dhe të garantojë që operatori ofertues të ketë një pjesëmarrje reale dhe të besueshme në realizimin e kontratës. Në rastin tonë, ndërsa ne nuk arrijmë 50% të xhiros së kërkuar, kapacitetet e garantuara përmes subjektit tjetër janë reale, të vërtetuara dhe të disponueshme, duke garantuar kështu përmbushjen e kërkesës nga pikëpamja e aftësisë financiare.

Ne VKM nr. 285/2021, neni 90 pika 2 nenpika 4, thuhet qe: 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklaroj? Nj? Gj? T? Till? Q? N? Dokumentet e ofertës; - të vërtetoj? Me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme. - të provoj Autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së. - Në cdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Pika e mesiperme percakton qe OE të përmbushë të paktën 50% të kërkesës, por kjo nuk do të thotë një vlerë fikse apo e pandryshueshme, sepse edhe vete ligji nuk e percakton si te detyrueshme qe duhet te permbushet patjeter 50%, por thote te pakten 50% dhe për sa kohë OE ka kapacitet real ekonomik. Shoqeria jone ka kapacitete reale për ta realizuar kontratën si eksperiencia (e vërtetuar edhe me ane te kontratave te ngjashme me objektin e prokurimit), punonjesit e kerkuar, makinerite dhe vleresimi duhet te behet në bazë të aftësisë së përgjithshme për përmbushjen e kontratës. Shoqeria jone per te permbushur piken 1 per xhiron vjetore eshte mbeshtetur ne kapacitetet e nje kompanie tjeter duke vërtetuar me dokumenta reale financiare kapacitetin e subjektit tjetër ashtu si edhe e kerkon ligji i prokurimit publik. Persa me siper, firma jone e permbush piken 1 te Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar per xhiron vjetore dhe kerkojme kualifikimin e shoqerise “Dynamicx Group”.

Referuar arsyes se dyte te s'kualifikimit qe shoqeria jone nuk permbush piken 2 te Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar per paraqitjen e bilanceve te certifikuara per vitet financiare (2022, 2023, 2024) ku dy bilance te njepasnjeshme nuk ka raport negative ndermjet aktivitetit dhe pasivit. Ky kriter ne vetvete nuk eshte absolut dhe perjashtues sipas ligjit nr. 162/2020. Nese shoqeria ka likuiditet, asetet e mjaftueshme, dhe mbështetje nga subjekt tjetër, nuk mund të penalizohet automatikisht për shkak të humbjes neto, sidomos kur përmbushet pjesa tjetër e kërkesave financiare. Shoqeria jone ka kapacitete reale për ta realizuar kontratën dhe gjithashtu duke u mbështetur ne kapacitetin ekonomik te nje subjekti tjetër i euro Paperë shpk e vertetuar me dokumentacion konkret financiar per Kapacitetin Ekonomik dhe Financiar duke permbushur kriteret e kualifikimit te kerkuara ne DST. Persa me siper, firma jone ka asetet e mjaftueshme per te realizuar kontraten dhe kerkojme kualifikimin e shoqerise "Dynamicx Group".

Persa i perket arsyes se trete te s'kualifikimit shoqeria se nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 3, pasi nuk ka paraqitur Autorizim nga Prodhuesi dhe/ose Autorizim nga Distributori i cili duhej te ishte i Autorizuar nga Prodhuesi per mallrat objekt prokurimi. Firma jone ka marre nje Autorizim nga shoqeria "Euro Paper" shpk e cila eshte nje subjekt tregtar me eksperiencë të gjatë në tregun shqiptar, i profilizuar në tregtim dhe import - eksport me shumice dhe pakice te letres dhe shpërndarjen me shumicë të mallrave të ngjashme ose identike me ato që përbëjnë objektin e prokurimit. Në mungesë të një autorizimi direkt nga prodhuesi, në shumë raste është pranuar autorizimi nga një distributor rajonal apo subjekt i zinxhirit të tregtimit, veçanërisht kur prodhuesi është jashtë shqipërisë dhe nuk jep autorizime të drejtpërdrejta për cdo OE. Në dokumentacionin e dorëzuar kemi paraqitur autorizim nga një distributor zyrtar që operon në rajon, i cili zotëron marrëdhënie kontraktuale me prodhuesin dhe ka të drejtën të shpërndajë produktet në fjalë. Kërkesa për autorizim nga vetë prodhuesi nuk duhet të interpretohet në mënyrë përjashtuese nëse operatori ekonomik është në gjendje të dëshmojë se produktet që ofron janë origjinale dhe të gjurmueshme nëpërmjet një zinxhiri të rregullt furnizimi. Persa me siper, shoqeria idynamicx Groupë e permbush piken e mesiperme dhe kerkojme kualifikimin e shoqerise "Dynamicx Group".

Per firmen Marketing & Distribution

1) Ne piken 1 te Kapacitetit Teknik eshte kerkuar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë: a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. B. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Marketing & Distribution eshte kancelari dhe merret me blerjen dhe shitjen e materialeve kancelarike dhe te letres. Kjo firme nuk ka kontrata te ngjashme me objektin e

prokurimit, por ka paraqitur kontrata vetem per leter dhe materiale kancelarike. Ne kemi bindjen qe firma Marketing & Distribution nuk e ploteson vleren prej 40% te fondit limit qe kerkohet ne kete tender per kuti dhe dosje sic kerkohet ne objektin e prokurimit. Persa me siper, Marketing & Distribution nuk e ploteson piken e mesiperme per kontratat e ngjashme dhe duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure.

2) Ne piken 3 te Kapacitetit Teknik eshte kerkuar:

3. Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi. Sipas pikes me larte, operatoret ekonomike ofertues duhet të paraqesin autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Ne mendojme se autorizimi i paraqitur nga kjo firme nuk eshte i sakte sepse firma qe ka leshuar autorizimin nuk eshte prodhuese e kartonit te kutise dhe dosjes, por tregon materiale te ndryshme qe kane te bejne kryesisht me restaurimin e objekteve arkivore. Persa me larte, kjo firme nuk e ploteson kete pike dhe duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

3) Ne piken 5 te Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit kerkohet:

Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm
- 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm
- 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim. Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes se tenderit, me adresë: Rr “Rreshit Collaku”, Godina Nr. 6/337, tiranë (në krah të gjykatës së lartë).

Sipas pikes me larte, te gjitha firmat pjesemarrese ne daten dhe oren e hapjes se procedures do te paraqesin nga nje model per artikujt e mesiperm. Ne mendojme se Marketing & Distribution nuk i ka modelet sipas specifikimeve teknike. Ne specifikimet teknike jane te shprehura qarte te gjitha parametrat sesi duhet te jete dosja dhe etiketa si lloji i shkrimit, hapesirat ,vijezimet etj, dhe ju garantojme se kjo firme si dosjen dhe etiketen nuk i ka sipas parametrave te kerkuara ne specifikimet teknike.

Persa me siper kerkojme te behet analiza e kutive dhe te dosjes per gramaturen, ph, dhe matjen e permasave e tre kutive, dosjes dhe etiketave ne nje laborator te akredituar dhe te njohur nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit. Gjithashtu kerkojme te maten hapesirat nga rreshti ne rresht, vijeziomet, te percaktohet lloji i shkrimit, matja e kornizimit nga border line ne limitin e etiketes dhe te dosjes. Persa me siper kjo firme, nuk e ploteson piken e mesiperme dhe duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

Per firmen Kristalina KH

1).Ne piken "c" dhe "ç" te Kriterëve te Pergjithshme te Perzgjedhjes/Kualifikimit eshte kerkuar: Ofertuesi Deklaron se:

c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për cdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

Duke qene se firma Kristalina ka marre pjese edhe ne disa procedura te meparshme me te njejtin objekt prokurimi , kjo firme ka mashtruar dhe ka paraqitur makineri jo te sakta per te fituar kontraten. Kjo firme ka bere deklarim te rreme dhe ka mashtruar dhe per kete arsye eshte marre e pandehur me procedim penal Nr. 3325 date 11.10.2024 me vendim nga Prokuroria për veprën penale të ifalsifikimi i vulave, i stampave ose i formulareve ë si firma Kristalina edhe Administratori i saj Kadri Hykaj. Gjithashtu kjo firme e ndodhur ne keto kushte nuk ka mundesi te marre vertetim nga Prokuroria qe nuk eshte ne ndjekje penale dhe cdo vertetim i paraqitur eshte fallco. Per kete arsye kerkojme verifikimin prane Prokurorise se Tiranes te gjendjes penale qe ndodhet firma Kristalina dhe Administratori i saj. Ne jemi te bindur qe kjo firme ka bere nje deklarim te rreme per gjendjen penale ne Formularin Permbledhes te Vetdeklarimit dhe duhet te perjashtohet nga kjo procedure prokurimi. Persa me siper, firma Kristalina duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

2) Ne kriteret e pergjithshme te perzgjedhjes/kualifikimit, pika ía í ku thuhet se ofertuesi deklaron se: është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit te posacëm rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; . Po te shohim ekstraktin e firmes Kristalina adresa e ushtrimit te aktivitetit eshte: Tirane Lord Bajroni Laprake, po ashtu ne te gjitha dokumentet e tjera te kerkuara si ISO etj. Kjo firme duhet te kishte ndryshuar adresen e veprimtarise pasi firma Kristalina ne vitin 2020, objektin ku ushtron aktivitetin e saj e ka dhene per ndertim pallati shoqerise ndertuese BELHAUS. Trualli i deklaruar si vend i ushtrimit te aktivitetit nga shoqeria Kristalina eshte bllokua prane zyrove te Kadastrës ne interes te shoqerise Belhaus me qellim ndertimi. Vendi i ushtrimit te aktivitetit te deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetdeklarimit nga shoqeria Kristalina KH ne kete procedure prokurimi eshte i deklarim i rreme, pasi ne adresen Tirane Lord Bajroni Laprake, e deklaruar nga ky i fundit eshte bere bllokimi i pasurise per llogari te shoqerise

ndertuese, per rrjedhoje dhe trualli ne adresen e deklaruar nuk eshte me prone ne disponim te shoqerise Kristalina KH.

Të dy palët e përfshira në marrëveshjen e qirasë si Kadri dhe Hatixhe Hyka kanë firmosur bashkërisht kontratën me firmën İbelhausë, ku shprehin qarte vullnetin për të vënë pasurinë në dispozicion të firmes ndertuese. Ne kete menyre ata kanë hequr dorë nga zbatimi i cdo marrëdhënieje të mëparshme që bie ndesh me kontratën e re, ne kete rast te kontrates se qirase me firmen Kristalina. Në kontratën e ndërtimit është përfshirë klauzola ligjore që përcakton se: cdo akt ose marrëveshje e lidhur më parë me këtë pasuri nuk ka fuqi ligjore.ë Kjo klauzolë është një deklaram i qartë ligjor për heqjen dorë nga cdo kontratë e mëparshme, përfshirë kontratën e qirasë me firmen Kristalina. Në lejen e ndërtimit dhe projektin e zhvillimit parashikohet prishja e objektit ekzistues dhe ndërtimi i një objekti të ri dhe në këto kushte kontrata e qirasë pushon automatikisht, pasi objekti i marrë me qira nuk ekziston më si objekt fizik dhe juridik mbi të cilin të ushtrohet qiraja. Kriteret per kualifikim vendosen nga Autoriteti Kontraktor qe te krijoje bindjen se operatoret ekonomike ofertues të kenë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën. Ne kete rast firma Kristalina nuk ka vend per ushtimin e aktivitetit pasi vendi I deklaruar nga kjo firme per ushtimin e aktivitetit, eshte e rrethuar nga firma ndertuese gati per prishje.

Referuar ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Neni 76, kriteret detyruese për skualifikim, pika 3, germa ë) parashikon se «cdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;ë Persa me siper, firma Kristalina nuk ka nje ambient per ushtimin e aktivitetit dhe ka bere nje deklaram te rreme ne Formularin Permbledhes te Vetdeklarimit per adresen reale ku ushtron aktivitetin dhe per kete arsye duhet te sikuallifikohet nga kjo procedure prokurimi. Per kete arsye kerkojme verifikimin ne vend te adreses se firmes Kristalina.

3) Ne piken 3 te Kapacitetit Teknik eshte kerkuar:

Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, ëëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi. Persa me siper, AK ka kerkuar nje Autorizim Prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Ne mendojme qe Autorizimi i Prodhuesit i paraqitur nga kjo firme nuk eshte i sakte, sepse firma SCHEMPP eshte distributor i materialeve te ndryshme per arkivat, bibliotekat per produktet e gatshme. Ne faqen e tij te internetit gjithshu kjo firme tregton kuti dhe dosje arkivi, pra eshte distributor dhe jo fabrike prodhimi kartoni. Kete mund ta verifikoni ne faqen zyrtare te kompanise <https://schempp.de>, rezulton se prodhon kuti dhe dosje duke marre materialin lende e pare te gatshem, pra nuk eshte prodhuese e kartonit sepse nuk i ka kapacitetet per prodhimin e tij si celuloza, fibrat, procesi i valezimit. Gjithashtu fokusi primar i kesaj kompanie

është tregtimi i materialeve që shërbejnë për restaurimin dhe konservimin e objekteve të ndryshme të arkivave, biblioteka apo koleksione. Kutitë apo dosjet që kerkohen në këto procedura janë të ndërtuara karton të gatshëm dhe jo karton të prodhuar nga vete kompania. Schempp nuk e prodhon vetë kartonin e përdorur në kutitë dhe dosjet arkivore, dhe Autorizimi i Prodhuarit i paraqitur nga firma Kristalina nuk është i saktë sepse ku autorizim është leshuar nga një kompani që nuk është prodhuese e kartonit por distributor i tij dhe për këtë arsye duhet të s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

4) Në piken 6 të Kriterëve të Kualifikimit kerkohet:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisitë ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Duke u bazuar te pika e mesiperme, shoqëria Kristalina KH duhet të ketë certifikatën ISO, por këto certifikatë janë leshuar për adresën që është në rrugën Lord Bajron, Tiranë. Kontrata e qerash që ka paraqitur Kristalina me znj. Hatixhe Hykaj, sipas se ciles kjo firmë ka të drejtë që të ushtrojë aktivitetin në këtë ambient deri në vitin 2025, është nul sepse znj. Hatixhe Hykaj këtë ambient në 17.12.2020 ia ka dhënë për ndërtim shoqërisë BELHAUS SHPK për të ndërtuar pallat, pra të njëjtin adresë ku firma Kristalina ushtron aktivitetin. Në të gjitha dokumentat e paraqitura nga firma Kristalina thuhet që e ushtron aktivitetin në rrugën Lord Bajron, ku në fakt sipas kontratës me firmën ndërtuese, kontrata e qirash hidhet poshtë dhe firma Kristalina nuk posedon me një ambient për ushtrimin e aktivitetit. Për rrjedhojë edhe dokumentet e paraqitura si certifikatat ISO janë nul.

Për këtë arsye të gjitha certifikatat ISO janë nul për arsye se kjo adresë nuk figuron me pasi godina ku ushtronte aktivitetin kjo firmë është prishur dhe nuk e ushtron me aktivitetin në këtë adresë. Për këtë arsye kërkojmë verifikimin e ISO-ve të firmës Kristalina.

5) Në piken 4 të ndryshuar është kerkuar:

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe/ose skedën teknike të prodhuarit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi. Firma Kristalina edhe në tenderat e mëparshëm me të njëjtin objekt, ka paraqitur fletë analize për kartonin e kutisë dhe të dosjes nga

nje laborator qe nuk eshte i akredituar nga organizma kombetar dhe nderkombetar dhe gjithashtu nuk eshte i akredituar per analizen e te gjitha parametrave te kerkuar ne specifikimet teknike. Analizat e bera nga ky laborator nuk jane te sakta dhe njekohesisht edhe parametrat nuk jane sipas specifikimeve te kerkuara nga ana juaj. Firma Schempp nga e cila firma Kristalina ka marre Autorizimin e Prodhuesit, per te cilen ne jemi te bindur se kjo firme eshte distributor dhe jo prodhues, nuk disponon dhe nuk ka blere ndonjehere karton 620 gr, por tregtojne kuti kartoni ondulat 570 gr me valem. Prandaj nuk e dime ku e ka marre kartonin qe e ka cuar per analize dhe per kete arsye kerkojme qe te kontrolloni korrespondencen qe ka pasur firma Kristalina me firmen Schempp dhe ku e ka marre kartonin 620 gr. Persa me siper kerkojme te verifikohet nese firma Kristalina eshte pajisur ndonjehere me karton 620 gr nga firma Schempp per kryerjen e ketyre analizave dhe a disponon karton 620 gr kjo kompani ?. Persa thame me siper, duke qene se kjo firme nuk ploteson piken 4 te Kriterave te Kualifikimit kerkojme perjashtimin e firmes Kristalina nga kjo procedure.

6) Ne piken 5 te Kriterave te Vecanta te Kualifikimit kerrohet:

Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm
- 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm - 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim. Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Rreshit Collaku”, Godina Nr.6/337, tiranë (në krah të gjykatës së lartë).

Sipas pikes me larte, te gjitha firmat ne daten dhe oren e hapjes se procedures do te paraqesin nga nje model per artikuljt e mesiperm. Duke qene se firma Schempp nuk ka karton 620 gr dhe duke u bazuar edhe te tenderat e meparshem per arkiven ku firma Kristalina ka marre pjese dhe ne te gjitha testimet e kryera kartoni i kesaj firme nuk ka dale me shume se 570 gr/m2.

Ne specifikimet teknike eshte e shprehur qarte sesi duhet te jete dosja dhe etiketa si lloji i shkrimit, hapesirat ndermjet rreshtave, vijeizimet etj, ju garantojme se firma Kristalina si dosjen dhe etiketen nuk i ka sipas parametrave te kerkuara ne specifikimet teknike.

Persa me siper kerkojme te behet analiza e tre kutive dhe te dosjes per gramaturen, ph, dhe percaktimin e bojes se kutive dhe dosjes, se firmes Kristalina ne nje laborator te akredituar dhe te njohur nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit. Kerkojme qe te perjashtohet Laboratori Qendror i Restaurimit ne Drejtorine e Pergjithshme te Arkivave, duke qene se jemi ne konflikt interesi sepse mbas lidhjes se kontrates do te jete DPA qe do te beje verifikimin e te gjitha kutive dhe dosjeve. Gjithashtu, kerkojme qe te maten edhe permasat e tre kutive, dosjes dhe etiketave dhe gjithashtu

kerkojme te maten hapesirat nga rreshti ne rresht, vijeizimet, te percaktohet lloji i shkrimit, matja e kornizimit nga border line ne limitin e etiketes dhe te dosjes.

Si perfundim, kjo firme nuk e ploteson piken 5 per modelet dhe duhet te perjashtohet nga kjo procedure.

Per Office Paper & Inpress

1) Ne kriteret e Pergjithshme te Perzgjedhjes/Kualifikimit thuhet: nese oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Ne procedurat e mëparshme Office Paper është futur se bashku me firmen Inpress si bashkim operatorësh ekonomike të ndare në % 75 x 25, kurse këto here janë 70x30, ku nga informacionet që ne kemi janë po të njëjtat punë. Po të besh një analizë prerja dhe kartoni zënë 10%-15% të punës në vlerë lekë. Shohim që po me të njëjtat gjëra kjo firmë ka marrë përsipër të përballojë 30% të kontratës. Në bashkimin e këtyre dy operatorëve firma Inpress ka vetëm shtypin dhe prerjen dhe Office Paper ka sigurimin e letres dhe kartonin, magazinimin dhe shpërndarjen. Por dogana në emër të kujt do bëhet dhe kush do e paguante doganën për materialin produkt të gatshëm që është shumë thelbësore. Dogana do të ndahet 70 x30 apo do të paguhej nga firma Office Paper. Njëkohësisht në kontratën e bashkëpunimit nuk është përmendur fare etiketa se nga cila firmë do të sigurohet adezivi që duhet për etiketën.

Përsa me sipër, kontrata e bashkëpunimit ka mangesi të theksuara sepse nuk i ka të gjitha elementet që duhet të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit dhe BOE Inpress & Office Paper duhet të s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

2) Në pikën 1 të Kapacitetit Teknik është kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë: a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. B. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit

në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

BOE në kontratën e bashkëpunimit ka përcaktuar se secili anëtar i bashkimit do të përmbush kushtin e përcaktuar në paragrafin 2 pikë 3 të nenit 88 të VKM Nr. 285. Kur oferta e paraqitur nga një bashkim operatorësh kushti për përmbushjen e kontratave të ngjashme plotësohet nga operatori që ka % më të madhe dhe anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me % e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Nga informacionet që ne kemi firma Office Paper dhe Inpress nuk e plotësojnë këtë pikë. Office Paper nuk e plotëson 70% të 40% të fondit limit për kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, pra për kuti dhe dosje dhe jo materiale kancelarie dhe shtypshkrime të thjeshta. Firma Office Paper është firmë që tregton produkte kancelarie dhe nuk ka kontrata apo fatura të ngjashme me objektin e prokurimit, ndërsa firma Inpress nuk ka kontrata të ngjashme për kuti e dosje por vetëm për shtypshkrime të ndryshme. Përsa me siper, BOE Office Paper & Inpress nuk e plotësojnë pikën për kontratat e ngjashme dhe duhet të s'kualifikohen nga kjo procedure.

4) Në pikën 6 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit është kërkuar:

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Aertifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001 imbi sistemet e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës); ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisitë ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës); ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës); Nga informacionet që ne kemi në certifikatat ISO të paraqitura në këtë tender nga firma Office Paper nuk është shënuar objekti i prokurimit sepse kjo firmë nuk është certifikuar për kuti dhe dosje arkivore. Pra, kjo firmë certifikatat ISO nuk i ka në përputhje me objektin e prokurimit dhe duhet të përjashtohet nga kjo procedure prokurimi.

5) Në pikën 3 të Kapacitetit Teknik është kërkuar:

3. Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, ëbësite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi. Duke qenë se firma Office Paper & Inpress kanë hyrë me të njëjtat dokumente si në tenderat e mëparshëm shohim se firma XCD si prodhuese e kartonit ondulat dhe të dosjeve ka autorizuar një distributor të saj në Shqipëri. Por për çudinë tonë pas hulumtimit të bërë në internet, kjo e zbuluar edhe në tenderat e mëparshëm, shohim që firma CXD nuk është prodhuese e këtyre produkteve. Po të shikoni në faqen në internet rezulton që tregton materiale arkivore por nuk është prodhuese. Duke qenë se është distributor i këtyre materialeve nuk ka sesi të autorizojë një

distributor tjetër për shitjen e këtyre materialeve. Përsa me lartë, kjo firmë duhet të s'kualifikohet nga kjo procedurë prokurimi.

6) Në pikën 4 të ndryshuar të kapacitetit teknik është kërkuar:

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedurë prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe/ose skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedurë prokurimi. Sipas pikës së mesipërme OE pjesëmarrës duhet të paraqesin fletë analizen për kartonin e kutisë dhe dosjes ose skedat teknike të prodhuesit të kartonit. Ne mendojmë se analiza e paraqitur nga BOE është bërë në një laborator që nuk është i akredituar për të gjitha parametrat në specifikimet teknike. Gjithashtu jemi të bindur se parametrat nuk janë sipas specifikimeve teknike. Kërkojmë që të bëhet analiza e gramatës, pH, matja e përmasave në një laborator të akredituar për leterë kartoni. Përsa me sipër, kjo firmë nuk e plotëson pikën e mesipërme dhe duhet të s'kualifikohet nga kjo procedurë prokurimi.

7) Në pikën 7 të ndryshuar të Kapacitetit Teknik është kërkuar:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetin e mëposhtme: Mjete Sasia Gjendja Mjet për transportin e mallrave 1 (një) pronësi / Me qerë / huapërdorje a) për mjetet me gomë që shënohen në regjistrin publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikatën e pronësisë së mjetit. B) për mjetet e siguruar me qerë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikatën e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerës, ose të huapërdorjes (sipas rastit). Shënim: Kriteri nr.7 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojcë 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Sipas pikës së mesipërme operatorët ekonomikë ofertues duhet të kenë një automjet për transportin e mallrave, por ne mendojmë se BOE Office Paper & Inpress nuk e kanë mjetin e transportit, automjet për transport të mallrave, por e kanë për përdorim vetjak e nuk mund të bëhet transporti i të gjithë mallrave të kutive dhe dosjeve në të gjitha institucionet e kërkuara me një mjet ëveturë që është vetëm për transportin e njerezve. Gjithashtu, ne mendojmë se firma Office Paper dhe Inpress nuk e kanë deklaruar mjetin e transportit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas pikës së mesipërme. Kjo firmë duhet të kishin deklaruar mjetin e transportit nëse është në pronësi apo qerë me të dhënat e mjaftueshme për të identifikuar mjetin e transportit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, gjë të cilën BOE Office Paper & Inpress nuk e ka bërë. Për sa më sipër, BOE Office Paper & Inpress nuk e përmbushin pikën 7 të DST për mjetin e transportit dhe duhet të s'kualifikohen nga kjo procedurë prokurimi.

8) Ne piken 5 te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit kerkohet:

Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm
- 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm
- 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim. Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Reshit “Collaku, Godina Nr.6/337, tiranë (në krah të gjykatës së lartë).

Sipas pikes me larte, te gjitha firmat pjesemarrese ne daten dhe oren e hapjes se procedures do te paraqesin nga nje model per artikujt e mesiperm. Ne mendojme se BOE Office Paper & Inpress nuk i ka modelet sipas specifikimeve teknike. Ne specifikimet teknike jane te shprehura qarte te gjitha parametrat sesi duhet te jete dosja dhe etiketa si lloji i shkrimit, hapesirat ,vijeizimet etj, dhe ju garantojme se kjo firme si dosjen dhe etiketen nuk i ka sipas parametrave te kerkuara ne specifikimet teknike.

Persa me siper kerkojme te behet analiza e kutive dhe te dosjes per gramaturen, ph, dhe matjen e permasave e tre kutive, dosjes dhe etiketave ne nje laborator te akredituar dhe te njohur nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit. Gjithashtu kerkojme te maten hapesirat nga rreshti ne rresht, vijeizimet, te percaktohet lloji i shkrimit, matja e kornizimit nga border line ne limitin e etiketes dhe te dosjes. Persa me siper kjo firme, nuk e ploteson piken e mesiperme dhe duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

Gjithashtu ankimuesi kerkon te behet analiza e gramatures dhe te ph per 4 kampionet e dorezuara, pra 3 kuti dhe 1 dosje te dorezuara nga firma “Kristalina KH”, firma “Marketing & Distribution” dhe BOE “Office Paper” & “Inpress” ne kete tender. Te behet matja e permasave te kutive te formuara dhe te dosjes se palosur, etiketes dhe gjithashtu te behet percaktimi i ngjyres nga nje laborator i licensuar per leter dhe karton per firmen Kristalina, firmen Marketing & Distribution dhe firmen BOE Office Paper & Inpress.

II.9. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2049/1 prot., datë 01.08.2025, janë publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, si dhe kriteret e kualifikimit

për të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga ana e operatorëve ekonomikë “Marketing & Distribution” SHPK, “Kristalina KH” SHPK dhe BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, i cili kundërshton me anë të ankesës me nr. 2049 prot., datë 31.07.2025.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se më datë 05.08.2025 operatori ekonomik i interesuar “Kristalina KH” SHPK ka paraqitur formularin e argumentave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Dynamicx Group” SHPK protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me nr. 2049/2 prot, datë 05.08.2025, sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se më datë 05.08.2025 bashkimi i operatorëve ekonomikë të interesuar “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK ka paraqitur formularin e argumentave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Dynamicx Group” SHPK protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me nr. 2049/3 prot, datë 05.08.2025, sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.12. Me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2049/4 prot., datë 12.08.2025, ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike si dhe shkresës nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2049/5 prot., datë 13.08.2025, ardhur nëpërmjetë shërbimit postar autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Dynamicx Group” SHPK, ku me vendimin nr. 78/2025, datë 11.08.2025, ka vendosur mospranimin e pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK”.

II.13. Me shkresën nr. 2049/6 prot, datë 17.09.2025, me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie e mostrave KPP-së lidhur me ankesat e operatorit ekonomik “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, “Adel Co” SHPK dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK”, Komisioni Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor, duke kërkuar informacion me përmbajtje si vijon:

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë paraqitur ankesat e operatorëve ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK me nr elektronik A/2025/5622 datë 31.07.2025, dhe me nr. 2049/2025 datë 31.07.2025; “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK me nr. elektronik

A/2025/5624 datë 31.07.2025 dhe me numer 2052/2025 prot, datë 31.07.2025; “Kristalina KH” SHPK me nr. elektronik A/2025/5625 datë 31.07.2025 dhe me numer 2053/2025 prot, datë 31.07.2025; “Marketing & Distribution” SHPK me nr. elektronik A/2025/5627, datë 31.07.2025 dhe me numer 2064/2025 prot, datë 01.08.2025; “Adel Co” SHPK me nr elektronik A/2025/5656 datë 08.08.2025, dhe me nr. 2157/2025 datë 11.08.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi arsyet e skualifikimit dhe kriteret për të cilat operatorët ekonomik ankimes pretendojnë se nuk përmbushen nga pjesëmarrësit në këtë procedurë.

Referuar nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: **“Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.**

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar vetëm informacion dhe dokumentacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi. Me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë

pranë Komisionit të Prokurimit Publik, **Mostrat** e paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, “Adel Co” SHPK dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK për këtë procedurë prokurimi, së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre, si dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e mostrave.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i sipërcituar të dorëzohet pranë KPP-së, brenda ditës së mërkurë datë 22.09.2025.

II.14. Me shkresën nr. 2577/3 prot., datë 24.09.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2049/7 prot, datë 24.09.2025 me objekt: “Dërgim i mostrave dhe dokumentacioni sipas shkrësës nr. 2049/6 prot, datë 17.09.2025”, autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin e kërkuar si dhe mostrat e operatorëve ekonomikë ankimes.

II.15. Me shkresën 2049/8 prot., datë 16.10.2025 me objekt “Kërkesë për Informacioni” Komisioni i Prokurimit Publik kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesave të paraqitura për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesa. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor përse i përket specifikimeve teknike të artikujve Kuti dhe Dosje për ruajtje të përhershme.

Sa më sipër, bazuar në nenin 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij, si dhe në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, duke qenë se, ju jeni institucioni kompetent i caktuar me ligj të posaçëm në fushën e akreditimit, si dhe në cilësinë e institucionit përgjegjës, për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë të ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga institucioni juaj si më poshtë vijon:

1- A ka laboratorë privat ose shtetërorë në Republikën e Shqipërisë të akredituar nga institucioni juaj për kryerjen e analizave për komponentët e mëposhtëm:

- Gramaturë.
- pH.

- Rezervë alkaline.
- Lignin.
- Ngjyrën e kutisë.

2- Në rast se ka laboratorë të akredituar nga ana juaj cilët janë këto laboratorë dhe për cilin nga komponentët e sipërcituar janë të akredituar nga ana juaj për të kryer analiza.

Për sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj maksimal, korrekt dhe eficient. Afati për kthimin e përgjigjes suaj është brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese, pasi informacioni juaj është i rëndësishëm për marrjen e një vendimi të drejtë nga ana jonë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të informacionit sa më të shpejtë nga ana juaj.

II.16. Me shkresën 463/1 prot., datë 20.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/9, datë 22.10.2025 me objekt “Dhënie Informacioni”, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, na informon si më poshtë vijon:

Në përgjigje të shkresës suaj, Nr. Prot, datë 16.10.2025, drejtuar DPA për kërkesë informacioni në lidhje me laboratorë testues të akredituar për kryerjen e testimeve të artikujve kuti dhe dosje, ju informojmë se DPA nuk ka akredituar asnjë laborator testues, të vëndit apo të huaj që kryen testet e lignit dhe rezervës alkaline në produktet e sipërpërmendura. Në lidhje me testet e PH, barshësisë/ngjyrës, dhe gramaturës DPA ka akredituar 2 laboratorë testues si më poshtë:

1- Laboratorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave LT 129, për pH dhe gramaturën, por jo për bardhësinë/ngjyrën.

2- Laboratorin Eko-Studio Projekt SHPK LT 070 për pH, gramaturën dhe bardhësinë/ngjyrën.

Fushën e akreditimit të këtyre laboratorëve mund ta gjeni në ëëbsitin e DPA, ëëë.dpa.gov.al.

II.17. Me shkresën nr. 2049/10 prot., datë 04.11.2022 me objekt “Kërkesë për Informacion” Komisioni Prokurimit Publik kërkoi Informacion nga laboratorit testues “Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave” SHPK si më poshtë vijon:

“Në kuadër të shqyrtimit të ankesave të paraqitura për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesa. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor përsa i përket specifikimeve teknike të artikujve Kutit dhe Dosje për ruajtje të përhershme.

kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm

kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm

kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm

dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm

Me shkresën nr. 2049/8 prot., datë 16.10.2022, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, informacion në lidhje me laboratorët e akredituar për testimin e letrës dhe kartonit, për komponentët - Gramaturë;, - pH;, - Rezervë alkaline;, - Lignin;, dhe - Ngjyrën e kutisë. Me shkresën nr. 463/1 prot, datë 20.10.2025 me objekt “Dhënie Informacioni” Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon Komisionin e Prokurimit Publik se në lidhje me testet e pH, bardhësisë/ngjyrës, dhe gramaturës DPA ka akredituar 1- Laboratorin Eko-Studio Projekt SHPK për kryerjen e analizës së: pH, bardhësisë/ngjyrës, dhe gramaturës dhe 2- Laboratorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për kryerjen e analizës së: pH, dhe gramaturën.

Sa më sipër, bazuar në nenin 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij, si dhe në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë të ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga ana juaj si më poshtë vijon:

1. Subjekti juaj mund të kryej analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet pH dhe gramaturë ?.

2. Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifat e analizave për secilin komponentë të sipërcituar.

Për sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj maksimal, korrekt dhe eficient. Afati për kthimin e përgjigjes suaj është brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese, pasi informacioni juaj është i rëndësishëm për marrjen e një vendimi të drejtë nga ana jonë.

II.18. Me shkresën nr. 2049/11 prot., datë 04.11.2022 me objekt “Kërkesë për Informacion” Komisioni Prokurimit Publik kërkoi Informacion nga laboratorit testues “Eko-Studio-Projekt” SHPK si më poshtë vijon:

Në kuadër të shqyrtimit të ankesave të paraqitura për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesa. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor përsa i përket specifikimeve teknike të artikujve Kuti dhe Dosje për ruajtje të përhershme.

kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm
kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm
kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm
dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm

Me shkresën nr. 2049/8 prot., datë 16.10.2022, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, informacion në lidhje me laboratorët e akredituar për testimin e letrës dhe kartonit, për komponentët - Gramaturë;, - pH;, - Rezervë alkaline;, - Lignin;, dhe - Ngjyrën e kutisë. Me shkresën nr. 463/1 prot, datë 20.10.2025 me objekt “Dhënie Informacioni” Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon Komisionin e Prokurimit Publik se në lidhje me testet e pH, bardhësisë/ngjyrës, dhe gramaturës DPA ka akredituar 1-Laboratorin Eko-Studio Projekt SHPK për kryerjen e analizës së: pH, bardhësisë/ngjyrës, dhe gramaturës dhe 2-Laboratorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për kryerjen e analizës së: pH, dhe gramaturën.

Sa më sipër, bazuar në nenin 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij, si dhe në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga ana juaj si më poshtë vijon:

1. Subjekti juaj mund të kryej analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet pH, bardhësi/ngjyrë, dhe gramaturë ?.

2. Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifat e analizave për secilin komponentë të sipërcituar.

Për sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj maksimal, korrekt dhe eficient. Afati për kthimin e përgjigjes suaj është brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese, pasi informacioni juaj është i rëndësishëm për marrjen e një vendimi të drejtë nga ana jonë.

II.19. Me shkresën nr. 11844/1 prot., datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/12, datë 11.11.2023 me objekt “Kthim-përgjigje kërkesës për informacionnr. 2049/10 prot, datë 04.11.2025”, laboratorit testues “Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave”, informon si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të kërkesës suaj nr. 11844 prot., datë 06.11.2025 (protokoll hyrës), “Kërkesë për informacion”, ju bëjmë me dije se, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave më datë 09.04.2025,

është akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit sipas Certifikatës së Akreditimit nr. L 129 Laborator Testues, në përpythje me standartin SSH ISO/IEC 17025:2017, për kryerjen e analizës së pH dhe gramaturës.

Në lidhje me çfarë parashtroni në shkresën tuaj, për të kryer analizat e materialeve kuti dhe dosje për analizat pH dhe gramaturë, ju informojmë se, ne si institucion e ofrojmë shërbimin e matjes së pH dhe gramaturës për letër/karton.

Gjithashtu, për sa i përketë tarifës së analizave për pH është 1,500 (një mijë e pesëqindë) lekë, për gramaturën është 1,500 një mijë e pesëqindë) lekë. Afati i përgjigjes për secilën analizë është 4 (katër) ditë pune.

II.20. Me shkresën nr. 1061 prot., datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/13, datë 11.11.2025 me objekt “Kthim-përgjigje shkresës me nr. 2049/11 prot, datë 04.11.2025”, laborator testues “Eko-Studio-Projekt” SHPK, informon si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 2049/11 prot., datë 04.11.2025, me lëndë “Kërkesë për Informacion”, drejtuar pranë zyrës sonë, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Eko-Studio-Projekt ShPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikas dhe kryhet testime pëmanente të kapineve të ujit, tokës, ajrit, mikroklimës, zhurmave, radioaktivitetit, letrës dhe kartonit.

Oferta ekonomike është si më poshtë vijon:

Nr.	Shërbim	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSh	Vlera pa TVSH
1	Analiza gramaturës	Copë	4	6600	26400
2	Analiza e Bardhësisë	Copë	4	5500	22000
3	Analiza e pH	Copë	4	7400	29600

II.21. Me shkresën nr. 4036 prot, datë 02.12.2025, me objekt “Kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesave, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përshërshme”, me REF-43560-04-03-2025”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2049/14 prot, datë 04.12.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara kërkon përshpejtimin e vendimarrjes për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.22. Me shkresën nr. 2049/15 prot., datë 11.12.2025 me objekt “Kërkesë për Informacioni” Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit duke i kërkuar informacion si vijon:

[.....]

Në kuadër të shqyrtimit të ankesave të paraqitura për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesa. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave konstatohen

pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor përsa i përket specifikimeve teknike të artikujve Kuti dhe Dosje për ruajtje të përhershme.

Sa më sipër, bazuar në nenin 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij, si dhe në zbatim të nenit 115/I e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, duke qenë se, ju jeni institucioni kompetent i caktuar me ligj të posaçëm në fushën e akreditimit, si dhe në cilësinë e institucionit përgjegjës, për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga institucioni juaj si më poshtë vijon:

1- A është i akredituar laborator i privat ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing nga institucioni juaj për kryerjen e analizave për komponentët e mëposhtëm:

- Gramaturë.*
- pH.*
- Rezervë alkaline.*
- Lignin.*
- Ngjyrën e kutisë.*
- Matjen e përmasave të kutive dhe dosjeve për arkiv.*

Për sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj maksimal, korrekt dhe eficient. Afati për kthimin e përgjigjes suaj është brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese, pasi informacioni juaj është i rëndësishëm për marrjen e një vendimi të drejtë nga ana jonë.

II.23. Me shkresën 547/1 prot., datë 15.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/16, datë 18.12.2025 me objekt “Dhënie Informacioni”, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, informon si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të shkresës suaj, Nr. 2049/15, datë 11.12.2025, drejtuar DPA për kërkesë informacioninë lidhje me fushën e akreditimit të laboratorit testues ECCAT SHPK, ju informojmë se ky laborator është akredituar së fundmi më datë 09.10.2025, për analizat e mëposhtme në matricat letër/karton: - Gramaturë; - pH; - ngjyra/bardhësia.

Laboratori ECCAT nuk është i akredituar për kryerjen e testave të Rezervës alkaline, Lignit dhe matjes së përmasave të kutive dhe dosjeve për arkivë në matricat letër/karton. Për këto teste, ashtu sic jeni informuar edhe më parë, nëpërmjet shkresës nr. 463/1 prot, datë 20.10.2025 DPA nuk ka akredituar asnjë laborator testues, të vendit apo të huaj që ti kryejë

ato. Përveç dhënies së këtij informacioni, DPA ndjen detyrimin dhe përgjegjësinë të sqarojë se në kërkesën për informacion të drejtuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, në shkresën e sipërpërmendur (nr. 463/1 prot, datë 20.10.2025), është dhënë pa dashje një informacion jo i përditësuar duke përjashtuar nga lista e laboratorëve që kryejnë testet e kërkuara në shkresë, laboratorin ECCAT SHPK i cili në atë periudhë sapo i është zgjeruar fusha e akreditimit për një pjesë të testeve të përmendura shkresë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i një gabimi njerëzor për shkak të çështjeve teknike dhe ngarkesës së lartë të punës gjatë periudhës përkatëse. Duke ju kërkuar ndjesë për krijimin e kësaj situate, jemi të gatshëm që të ridërgojmë cdo informacion tjetër që i nevojitet Institucionit tuaj në lidhje me verifikimet e fushave të akreditimit të subjekteve të akredituara që ju merrni në shqyrtim”.

II.24. Me shkresën nr. 2049/17 prot., datë 22.12.2025 me objekt “Kërkesë për Informacion” ju drejtua laboratorit testues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK si më poshtë vijon:

Bazuar në nenin 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesave të paraqitura për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesa. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor përsa i përket specifikimeve teknike të artikujve Kuti dhe Dosje për ruajtje të përhershme.

kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm

kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm

kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm

dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm

Me shkresën nr. 2049/15 prot., datë 11.12.2022, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, informacion në lidhje me laboratorët e akredituar për testimin e letrës dhe kartonit, për komponentët - Gramaturë;, - pH;, - Rezervë alkaline;, - Lignin;, - Ngjyrën e kutisë;, dhe – Matjet e përmasve të kutive dhe dosjeve për arkiv. Me shkresën nr. 547/1 prot, datë 15.12.2025 me objekt “Dhënie Informacioni” Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon Komisionin e Prokurimit Publik se në lidhje me testet e Gramaturës, pH, dhe ngjyrës/bardhësisë, DPA ka akredituar ndër të tjerë edhe ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing për kryerjen e analizës së: Gramaturës, pH, dhe ngjyrës/bardhësisë.

Sa më sipër, bazuar në nenin 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij, si dhe në

zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë të ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga ana juaj si më poshtë vijon:

- 1- Subjekti juaj mund të kryej analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet Gramaturë, pH, ngjyrë/bardhësi, dhe Matje të përmasave të kutive dhe dosjeve për arkivën ?.
- 2- Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifat e analizave për secilin komponentë të sipërcituar.

Për sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj maksimal, korrekt dhe eficient. Afati për kthimin e përgjigjes suaj është brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese, pasi informacioni juaj është i rëndësishëm për marrjen e një vendimi të drejtë nga ana jonë.

II.25. Me shkresën nr. 364 prot., datë 24.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/18, datë 29.12.2025 me objekt “Kthim-përgjigje”, laboratorit testues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, informon si më poshtë vijon:

Në vijim të shkresës suaj me nr 2049/17 prot, ju informojmë se shoqëria ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing është e akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) me Numër Akreditimi LT 128, për kryerjen e analizave laboratorike për materialet letër/karton/pulpë, sipas parametrave dhe metodave të mëposhtme: -Trashësia; - Vëllimi specifik; - Densiteti; - Gramatura; - pH; - Përcaktimi i bardhësisë. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se oferta jonë për analizimin e parametrave të kërkuar nga ana juaj është bashkangjitur kësaj shkrese, sipas kërkesës suaj.

Nr.	Testi/Parametri	Çmimi ALL pa TVSH/Parametër	Numri i mostrave	Cmimi total ALL pa TVSH
1	Gramatura	6200	4	24800
2	pH	6900	4	27600
3	Ngjyra/Bardhësia	4800	4	19200
Cmimi total ALL pa TVSH				71.600
Cmimi total ALL me TVSH				85.920

II.26. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe informacionit të autoritetit kontraktor ardhur me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, rezulton se në datën 14.07.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të

prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.	“Kristalina KH” SHPK	46,336,920	lekë	kualifikuar
2.	“Marketing & Distribution” SHPK	47,041,415	lekë	kualifikuar
3.	“Dynamicx Group” SHPK	47,717,240	lekë	skualifikuar
4.	BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK	53,595,760	lekë	kualifikuar
5.	“InfoSoft Office” SHPK	59,699,557	lekë	skualifikuar
6.	“Adel Co” SHPK	64,666,170	lekë	skualifikuar
7.	“Albdesign PSP” SHPK	73,640,790	lekë	skualifikuar

II.27. Në datën 14.07.2025, bashkimi operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.28. Në datën 22.07.2025, është publikuar Njoftimi i Fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku fitues rezulton operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK

II.29. Në datën 31.07.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar me numër elektronik ankimi A/2025/5624 dhe me nr. 2052/2025 protokoll, datë 31.07.2025 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK për procedurën e “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin operatorëve ekonomikë “Marketing & Distribution” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, si më poshtë vijon:

Së Pari, Operatori ekonomik “Kristalina KH”, ka paraqitur një ofertë ekonomike tërësisht dhe anomalisht të ulët. Fondi limit i përcaktuar në DST për këtë procedurë prokurimi është 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” është në vlerën e 46,336,920 (dyzet e gjashtë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Thënë ndryshe kjo ofertë është më shumë se 38% (tridhjetë e tetë përqind) më e ulët se vlera e fondit limit. Duke qenë se, në këtë procedurë prokuruese janë paraqitur vetëm 3 (tre) oferta ekonomike të vlefshme nga operatorë ekonomikë pjesëmarrës, si dhe duke pasur bindjen se oferta ekonomike e paraqitur nga OE Marketing & Distribution shpk është e pavlefshme, dhe si rrjedhojë do të duhet të skualifikohet,....rrjedhimisht, në zbatim të nenit 93, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 82, pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke iu referuar procedurës prokuruese të lartpërmendur, kjo ofertë do të duhej të konsiderohej i) anomalisht e ulët, dhe si rrjedhojë të konsiderohej ii) e papranueshme nga KVO e AK. Në nenin 93, pika 1 dhe 2, të LPP që përcakton se: 1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për cmimin ose kostot e propozuara në ofertë. 2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen vecanërisht për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore. Vetëm pasi, OE të ketë dhënë në mënyrë të detajuar shpjegimet për secilën prej shtyllave të lartpërmendura, duke sqaruar në mënyrë shteruese arsyet teknike dhe mundësinë e realizueshmërinë së kontratës (duke mos rrezikuar kështu realizimin e kontratës), bazuar në vlerën e ofertuar prej tij, atëherë AK do të mund të vlerësonte nëse kjo ofertë ekonomike mund të konsiderohej ose jo e pranueshme, duke mos rrezikuar kështu për asnjë moment realizimin e kontratës. Referuar nenit 93, pika 1, të LPP, bazuar në sasitë dhe specifikimet teknike të mallrave, nisur edhe nga eksperiencia dhe ekspertiza e padiskutueshme e stafit teknik të specializuar të BOE Office Paper shpk dhe Inpress shpk., të cilat janë ndër shoqëritë tregtare më të mëdha, që operon në tregun shqiptar për prodhimin dhe tregtimin e materialeve të arkivës, do të donim t’ju theksonim se OE “Kristalina KH” shpk e ka të pamundur teknikisht të prodhojë mallrat e kërkuara (sipas specifikimeve, cilësisë dhe sasive të përcaktuara në DST) në vlerën e ofertuar prej tij, dhe rrjedhimisht e ka të pamundur të realizojë me sukses kontratën e prokuruar, për arsyet e mëposhtme: Fillimisht do të donim t’ju informojmë se procesi i prodhimit të produkteve / artikujve të arkivës është kompleks, ku ekzistojnë një sërë faktorësh, të cilët diktojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë koston e prodhimit, dhe si rrjedhojë cmimet e ofruara. Zërat kryesorë të kostove që ndikojnë drejtëpërdrejtë në procesin e prodhimit janë: i) Kosto e lëndëve dhe materialeve të para (letër + karton, lastra, format, tonerat, bojrat, etj.); ii) Kosto e punës (orët punës) e stafit teknik dhe administrativ; iii) Shpenzimet e përgjithshme administrative, etj. Bazuar në elementët teknikë të lartpërmendur, bazuar gjithashtu në sasitë dhe specifikimet teknike të mallrave të kërkuara në DST, nga përlllogaritja e bërë nga stafi teknik i specializuar i BOE Office Paper shpk. Dhe Inpress shpk., vetëm KOSTO e prodhimit të këtyre mallrave është më e lartë se vetë oferta ekonomike e paraqitur nga OE “Kristalina KH” shpk., e cila është në vlerën e 46,336,920 lekë pa TVSH. Nuk kuptohet se si ky OE do të mund të realizojë këtë kontratë prokuruese, dhe pa e rrezikuar atë, ku vetëm Kosto e Prodhimit është më e lartë se Oferta Ekonomike e paraqitur...???. Rrjedhimisht, OE “Kristalina KH” shpk., NUK jep asnjë garanci teorike, praktikë / teknike dhe ligjore, që do të mund të realizojë me sukses furnizimin me mallrat e kërkuara në procedurën prokuruese, objekt ankese. Përsa mësipër, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore të lartpërmendura... KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Së Dyti, Ne kemi bindjen, që në kundërshtim me pikën 2.2.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar, të DST, OE Kristalina KH shpk. Nuk ka paraqitur raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore (për vitet 2022, 2023 dhe 2024), të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Është detyrim i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore (për vitet 2022, 2023 dhe 2024), të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese, me përjsahtim të rasteve kur operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009. NË dijeninë tonë OE Kristalina KH shpk. Nuk është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009. Rrjedhimisht, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartpërmendura... ..KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik ëkppì, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik ëkristalina khì shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Së Treti, Ne kemi bindjen, që në zbatim të pikës 2.3.3 kapaciteti teknik, të DST, OE Kristalina KH shpk. Nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, pasi NUK ka paraqitur autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt / lëndët e para të Kartonit për kutitë, kartonit oër Dosjet dhe Letren per Etiketart artikujt objekt i prokurimit. Është e vërtetë që OE Kristalina KH shpk është përpunues përfundimtar për artikujt objekt të kësaj procedure (kuti kartoni, dosje kartoni dhe etiketa letre), por OE Kristalina KH shpk., bazuar ne dokumentat zyrtare dhe ligjore nuk është kurrësesi prodhues i Kartonit per kutitë, Dosjet dhe Letren per Etiketart artikujt objekt i prokurimit. Kriteri kërkon që nëse operatori nuk është vetë prodhues, të paraqesë autorizim nga prodhuesi, të dhëna të plota dhe lidhje të dokumentuar me prodhuesin. Në rastin konkret, nuk është paraqitur autorizim nga prodhues i certifikuar, dhe nuk është paraqitur autorizim nga Distributor te vërtetuar lidhje me prodhues të mirëfilltë, për të gjitha artikujt / lëndët e para të Kartonit për kutitë, kartonit oër Dosjet dhe Letren per Etiketart. Ky Kriter kualifikues kërkon autorizim nga një prodhues i artikujve objekt prokurimi (kuti kartoni, dosje kartoni), jo nga një subjekt që vetëm shtyp apo dekoron materialin. Pra, në përputhje me pikën 2.3.3 kapaciteti teknik, të DST nëse operatori blen karton dhe e printon, ai nuk është prodhues i lëndës së parë dhe as i produktit final, për sa kohë që nuk ka linjë të prodhimit të vetë artikujve të tenderit. Kriteri kërkon një subjekt që e prodhon materialin (dosje, kuti), jo që vetëm i stampojnë apo i shtypin ato. Kriteri kërkon identifikim të qartë të prodhuesit. Nëse nuk je vetë prodhuesi i artikujve, duhet të paraqesësh autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i tij, me të dhëna të plota për prodhuesin. Për më tepër, ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis Kriterit 3.3.3 dhe Kriterit 3.3.4. Kriteri 3.3.4 kërkon paraqitjen e fletë-analizës së lëndës së parë (kartonit) të përdorur për kutitë dhe dosjet, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit. Kjo kërkesë nënkupton qartë se Kriteri 3.3.3 kërkon që operatori të jetë prodhues i kartonit që përdoret për artikujt objekt të prokurimit ose prodhues i plotë i artikujve përfundimtarë (kuti, dosje). Pra, nuk është e mjaftueshme që operatori të kryejë vetëm përpunim printimi apo dekorimi mbi materialet e gatshme, por duhet të ketë kapacitet prodhimi të lëndës bazë dhe/ose të produktit final. Në konkluzion, do të donim të parashtronim se OE Kristalina KH sh.p.k. Nuk është prodhues i artikujve (kuti kartoni, dosje kartoni, etiketa letre) por vetëm përpunues printimi dhe shërbimesh mbështetëse. Në lidhje me këtë pikë, KVO e AK ka mbajtur qendrim të drejtë për sa i përket vlerësimit të ofertës ekonomike të paraqitur nga operatorët ekonomikë

pjesëmarrës Infosoft Office shpk dhe Albdesign PSP shpk., duke i skualifikuar këto operator ekonomikë ?. Por në mënyrë të gabuar nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe nuk e ka vlerësuar në të njëjtën mënyrë ofertën e paraqitur nga OE Kristalina KH shpk. Për sa mësipër, në përputhje me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Së katërti, Ne kemi bindjen, që në zbatim të pikës 2.3.4 kapaciteti teknik, të DST, OE Kristalina KH shpk nuk përmbush kriterin e vëçantë të kualifikimit, pasi NUK ka paraqitur: As fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e shqipërisë As (dhe/ose) skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë, që janë objekt i kësaj procedure prokurimi. Në rastin e parqitjes së fletë analizës së lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, fletëanaliza do të duhet të përmbante të dhënat / karakteristikat e mëposhtme: Për kartonin e kutive:

Gramatura së paku 615 g/m².

Ph midis 7.0 dhe 9.5.

Rezerva alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit.

Jo më shumë se 1% lignin.

Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c.

Për kartonin e dosjeve:

Gramatura së paku 325 g/m²

Ph midis 7.0 dhe 9.5.

Rezerva alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit.

Jo më shumë se 1% lignin.

Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c

Për kartonin e dosjeve:

Gramatura së paku 325 g/m²

Ph midis 7.0 dhe 9.5.

Rezerva alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit.

Jo më shumë se 1% lignin.

Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c

Referuar sa mësipër, ne kemi bindjen që OE Kristalina KH shpk. NUK ka paraqatur as fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të specifikohen qartazi edhe specifikimet teknike të kërkuara në DST,... ..as skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë objekt prokurimi, e cila të përmbante qartazi të dhënat / specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Gjithashtu, OE Kristalina KH shpk. Nuk ka paraqitur autorizim të vlefshëm nga prodhuesi i kartonit, që të vërtetojë lidhjen midis

operatorit ofertues dhe prodhuesit. Ky autorizim është i domosdoshëm për verifikimin e vlefshmërisë së ofertës dhe për të garantuar që operatori ekonomik ka të drejtën ligjore për të ofruar produktin e prodhuesit. Për sa mësipër, në përputhje me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Së Pesti, Ne kemi bindjen, që OE Kristalina KH shpk., në kundërshtim me pikën 2.3.5 kapacitetet teknik, të shtojcës 8, Kriteret e vecanta të Kualifikimit të DST, nuk ka paraqitur mostrat në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Në pikën 2.3.5 kapaciteti Teknik, të shtojcës 8, Kriteret e vecanta të kualifikimit të DST përcaktohet se: Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm
- 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm
- 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim.ë

Në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST përcaktohet se: “Formulari i specifikimeve teknike” specifikimet teknike - vendim nr. 7, datë 9.9.2024 “Për miratimin e standardeve të kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre - shtojca 1 standardet e kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre.

Në lidhje me këtë kriter kualifikues, ne kemi bindjen që mostrat e paraqitura nga OE Kristalina KH shpk., NUK janë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara dhe të kërkuara në shtojcën 8 kriteret e vecanta të kualifikimit - kapaciteti teknik, pika 2.3.5, të DST, sa mëposhtë:

Përsa i përket mostrës së paraqitur Kutit për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x28x18 cm: NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket:

Përmasave të kutisë të dorëzuar - 40x28x18 cm (Marzhi i gabimit të përmasave ? 3 mm)

Peshës së Kartonit të kutisë të dorëzuar - me gramaturë së paku 615 g/m2;

ph të Kartonit të kutisë së dorëzuar - ph midis 7.0 dhe 9.5;

Rezervës së alkalines Kartonit të kutisë të dorëzuar - minimalisht prej 2% të karbonatit të kalciumit;

Të përmbajtjes së ligninit të Kartonit të kutisë së dorëzuar - jo më shumë se 1% lignin.

Ngjyrës së të kutisë të dorëzuar - të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c.

Sic përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës kuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x28x18 të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunueshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

Përsa i përket mostrës së paraqitur Kutitë për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x55x18 cm: NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket:

Përmasave të kutisë të dorëzuar - 40x55x18 cm (Marzhi i gabimit të përmasave ? 3 mm)

Peshës së Kartonit të kutisë të dorëzuar - me gramaturë së paku 615 g/m²;

ph të Kartonit të kutisë së dorëzuar - ph midis 7.0 dhe 9.5;

Rezervës së alkalines Kartonit të kutisë të dorëzuar - minimalisht prej 2% të karbonatit të kalciumit;

Të përmbajtjes së ligninit të Kartonit të kutisë së dorëzuar - jo më shumë se 1% lignin.

Ngjyrës së të kutisë të dorëzuar - të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c.

Sic përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës ëkuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x55x18 të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunueshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk. Do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

Përsa i përket mostrës së paraqitur Kuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x70x9 cm: NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket:

Përmasave të kutisë të dorëzuar - 40x70x9 cm (Marzhi i gabimit të përmasave ? 3 mm)

Peshës së Kartonit të kutisë të dorëzuar - me gramaturë së paku 615 g/m²;

ph të Kartonit të kutisë së dorëzuar - ph midis 7.0 dhe 9.5;

Rezervës së alkalines Kartonit të kutisë të dorëzuar - minimalisht prej 2% të karbonatit të kalciumit;

Të përmbajtjes së ligninit të Kartonit të kutisë së dorëzuar - jo më shumë se 1% lignin.

Ngjyrës së të kutisë të dorëzuar - të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c.

Siç përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës kuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x70x9 të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga laboratorë të Akredituar në republikën e shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk. Do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

Përsa i përket mostrës së paraqitur Dosje për ruajtje të përhershme, me përmasa 36x24 cm: NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket:

Përmasave të Dosjes së dorëzuar - 40x70x9 cm (Marzhi i gabimit të përmasave ? 3 mm)

Peshës së Kartonit të Dosjes të dorëzuar - me gramaturë së paku 325 g/m²;

ph të Kartonit të Dosjes së dorëzuar - ph midis 7.0 dhe 9.5;

Rezervës së alkalines Kartonit të Dosjes së dorëzuar - minimalisht prej 2% të karbonatit të kalciumit;

Të përmbajtjes së ligninit të Kartonit të Dosjes së dorëzuar - jo më shumë se 1% lignin.

Ngjyrës së Dosjes të dorëzuar - të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c.

Siç përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në

DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës ë Dosje për ruajtje të përhershme, me përmasa 36x24 cm të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST.

Gjithashtu, mostra e paraqitur nga OE Kristalina KH shpk. Dosje për ruajtje të përhershme, me përmasa 36x24 cm, nuk është në përputhje me specifikimet teknike plotësuese (që nuk janë në vendimin nr. Nr.7, datë 09.09.2024 të KLA) të përcaktuara nga Grupi i punës, sa mëposhtë: Dizajni nuk është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; madhësia / përmasat e Shkrimit dhe vijëzimit nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës;

Numri i vijëzimeve / dhe distancat ndërmjet vijëzimeve (12 vijëzime të pa ndërprera me distancë 1.5 cm) nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës;

Distanca e kornizimit të dosjes nga broder line në limitin e dosjes nuk është 2 cm sipas specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës;

Korniza e Dosjes nuk është me gjerësi 2 mm sipas specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës.

Sic përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifiimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të matjes me pajisje të kalibruara dhe certifikuar të mostrës dosje për ruajtje të përhershme, me përmasa 36x24 cm të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga Institucione / laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

Përsa i përket mostrës së paraqitur Etiketa, me përmasa 15x10 cm:

Mostra e paraqitur nga OE Kristalina KH shpk. Etiketa, me përmasa 15x10 cm, nuk është në përputhje me specifikimet teknike plotësuese (që nuk janë në vendimin nr. Nr.7, datë 09.09.2024 të KLA) të përcaktuara nga Grupi i punës, sa mëposhtë:

Përmasat e etiketës së dorëzuar - 15x10 cm, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara;

Dizajni nuk është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; madhësia / përmasat e Shkrimit dhe vijëzimit nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës;

Madhësia / përmasat e Logos (2 cm lartësia dhe 2.5 cm gjerësi) dhe ngjyra e logos (5C (katër ngjyrat bazë plus bojë speciale panton 1505c)+llak) nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës;

Numri i Rreshtave / dhe distancat (hapësira nga rreshti në rresht) ndërmjet Rreshtave / vijëzimeve (8 vijëzime/rreshta x 0.6 cm = 4.8 cm dhe duke shtuar lartësinë e logos 2.5 cm shkon në 7.2 cm.) Nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; Distanca e kornizimit të etiketës nga broder line në limitin e dosjes nuk është 0.5 cm sipas specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; siç përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë.

Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të matjes me pajisje të kalibruara dhe certifikuar të mostrës etiketa, me përmasa 15x10 cm të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga Institucione / laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpuethshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST.

Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5 kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

Së Gjashti, Operatori ekonomik Kristalina KH shpk nuk disponon personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, në pikën 2.3.2. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, përcaktohet:

2. Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) punonjës, ku përfshihet edhe stafi teknik si më poshtë:

- 1 (një) dizenjues (ose staf teknik ekuivalent) kërkesa për 1 (një) dizenjues është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit kërkesa për 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse kërkesa për 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) Shofer, i cili mund të jenë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) punëtor shpërndarje

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet për plotësimin e këtij kriteri:

Listëpagesa e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik.

Kontrata pune të vlefshme, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme.

Kontratat e shërbimit të vlefshme për të gjithë periudhën kohore të realizimit të kontratës objekt prokurimi, për specialistët 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent; 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse dhe shoferin, në rast se këta punonjës janë me kontratë shërbimi. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme.

Diplome që vërteton kualifikim profesional për 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent. Ky dokument do të paraqitet për këtë punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur është marrë me kontratë shërbimi.

Për punonjësit 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, duhet të paraqiten dokumentat:

Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional në drejtimin poligrafi të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ose

Librezë punë apo çdo dokument të barazvlefshëm me të, që vërteton eksperiencën e punës jo më pak se dy vite në këtë profesion.

Dokumentat e kërkuara për 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit dhe 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, do të paraqitet për këta punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur janë marrë me kontratë shërbimi.

Shenim: Kriteri nr. 2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

Ne kemi bindjen që OE Kristalina KH shpk nuk disponon të gjithë personelin teknik të nevojshëm, referuar objektit të prokurimit, të kërkuar në DST.

Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE Kristalina KH shpk nuk ka paraqitur pranë AK dokumentacionin e nevojshëm ligjor, me anë të së cilës provohet/vërtetohet disponimi i stafit / personelit teknik të kërkuar në DST, si dhe dokumentacioni plotësues i kërkuar në DST.

Së fundi, do të donim të parashtronim, se stafi / personeli teknik, i deklaruar nga OE Kristalina KH shpk., nuk është i regjistruar në listëpagesat e këtij operatori ekonomik, me kodet korresponduese përkatëse, sipas profesioneve të kërkuara në DST, objekt ankese, dhe në përputhje me kodet e listës kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”. Rrjedhimisht, përse i përket këtij kriteri teknik / profesional. Bazuar në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, si dhe në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST, OE Kristalina KH shpk do të duhet të skualifikohet.

Së Shtati, mendojmë që në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST, dhe rregullat e prokurimit publik, OE Kristalina KH shpk., ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur detyrime tatimore të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar mbi këtë ankesë dhe përse i përket kësaj pike, të kërkojnë zyrtarisht një informacion nga Drejtoria e përgjithshme e Tatimeve.

Gjithashtu, mendojmë që OE Kristalina KH shpk., nuk ka paraqitur / dorëzuar në sistemin SPE të APP, një vërtetim të vlefshëm, i cili vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të faturave të energjisë elektrike. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk., do të duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe në rregullat e prokurimit publik.

Përse i përket vendimit të KVO të AK, për Kualifikimin e Operatorit Ekonomik “Marketing & Distribution” shpk., ju paraqesim kundërshtitë tona si vijon:

Së Pari, Operatori ekonomik “Marketinga & Distribution”, ka paraqitur një ofertë ekonomike tërësisht dhe anomalisht të ulët.

Fondi limit i përcaktuar në DST për këtë procedurë prokurimi është 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketinga & Distribution” është në vlerën e 47,041,415 (dyzet e shtatë milion e dyzet e një mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH. Thënë ndryshe kjo ofertë është më shumë se 37% (tridhjetë e shtatë përqind) më e ulët se vlera e fondit limit.

Duke qenë se, në këtë procedurë prokuruese janë paraqitur vetëm 3 (tre) oferta ekonomike të vlefshme nga operatorë ekonomikë pjesëmarrës, si dhe duke pasur bindjen se oferta ekonomike e paraqitur nga OE Kristalina KH shpk është e pavlefshme, dhe si rrjedhojë do të duhet të skualifikohet,.... rrjedhimisht, në zbatim të në zbatim të nenit 93, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; dhe nenit 82, pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke iu referuar procedurës prokuruese të lartpërmendur, kjo ofertë do të duhej të konsiderohej i) anomalisht e ulët, dhe si rrjedhojë të konsiderohej ii) e papranueshme nga KVO e AK.

Më poshtë ju parashtrojmë në mënyrë të detajuar se ky operator ekonomik, bazuar në cmimet për njesi të ofertuara, dhe vlerës totale të ofertuar nuk arrin të realizojë pjesën dërrmuese të artikujve/mallrave të kërkuara nga DST për këtë procedurë të prokurimit publik. Në nenin 93,

pika 1 dhe 2, të LPP që përcakton se: 1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. 2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93, pika 1, të LPP, bazuar në sasi të dhe specifikimet teknike të mallrave, nisur edhe nga eksperiencia dhe ekspertiza e padiskutueshme e stafit teknik të specializuar të BOE Office Paper shpk dhe Inpress shpk., të cilat janë ndër shoqëritë tregtare më të mëdha, që operojnë në tregun shqiptar për prodhimin dhe tregtimin e materialeve të arkivës, do të donim t'ju theksonim se OE "Marketing & Distribution" shpk e ka të pamundur teknikisht të furnizojë autoritetin kontraktor me mallrat e kërkuara (sipas specifikimeve, cilësisë dhe sasive të përcaktuara në DST) në vlerën e ofertuar prej tij, dhe rrjedhimisht e ka të pamundur të realizojë me sukses kontratën e prokuruar, për arsye të mëposhtme: Fillimisht do të donim t'ju informonim se OE Marketing & Distribution shpk nuk është prodhues i mallrave të kërkuara në DST. Ky operator ekonomik është tregtues i tyre, nëpërmjet importimit të mallrave të gatshëm përfundimtarë. Rrjedhimisht, kostot për furnizimin e këtyre mallrave është më i lartë në raport me operatorët ekonomikë pjesëmarrës të cilët përpunimin / prodhimin përfundimtarë të tyre e realizojnë vetë në shqipëri. Bazuar në elementët teknikë të lartpërmendur, bazuar gjithashtu në sasi të dhe specifikimet teknike të mallrave të kërkuara në DST, nga përllogaritja e bërë nga stafi teknik i specializuar i BOE Office Paper shpk dhe Inpress shpk., vetëm KOSTO e importimit të këtyre mallrave është më e lartë se vetë oferta ekonomike e paraqitur nga OE "Marketing & Distribution" shpk., e cila është në vlerën e 47,041,415 lekë pa TVSH. Nuk kuptohet se si ky OE do të mund të realizojë këtë kontratë prokuruese, dhe pa e rrezikuar atë, ku vetëm Kosto e Importimit është më e lartë se Oferta Ekonomike e paraqitur...???. Sic mund të vërehet lehtësisht, produktet / mallrat e kërkuara nga DST, nuk mund të prodhohen / realizohen nga OE "Marketing & Distribution" shpk., duke marrë për bazë vetëm koston e importimit të tyre. Këtu do të donim të theksonim gjithashtu, që në këtë analizë, nuk është marrë parasysh asnjë marzh fitimi (pra marzhi i fitimit është konsideruar "0").

Rrjedhimisht, OE "Marketing & Distribution" shpk., NUK jep asnjë garanci teorike, praktiko / teknike dhe ligjore, që do të mund të realizojë me sukses furnizimin me mallrat e kërkuara në procedurën prokuruese, objekt ankese. Përsa mësipër, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore të lartpërmendura KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik "Marketing & Distribution" shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Së Dyti, Ne kemi bindjen, që në kundërshtim me pikën 2.2.2 "kapaciteti ekonomik dhe financiar, të DST, OE "Marketing & Distribution" shpk. Nuk ka paraqitur raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore (për vitet 2022, 2023 dhe 2024), të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Është detyrim i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin

raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore (për vitet 2022, 2023 dhe 2024), të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese, me përjashtim të rasteve kur operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009. Në dijeninë tonë OE Marketing & Distribution shpk nuk është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009. Rrjedhimisht, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartpërmendura KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Së Treti, Ne kemi bindjen, që në zbatim të pikës 2.3.3 Ëkapaciteti teknikë, të DST, OE Marketing & Distribution shpk nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, pasi NUK ka paraqitur autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt / mallrat objekt i prokurimit: Kuti Kartoni Dosje Etiketa OE Marketing & Distribution shpk., bazuar ne dokumentat zyrtare dhe ligjore nuk është kurrësesi prodhues i Kutive të Kartonit, Dosjeve dhe Etiketave, artikujt objekt i prokurimit. Kriteri kërkon që nëse operatori nuk është vetë prodhues, të paraqesë autorizim nga prodhuesi, të dhëna të plota dhe lidhje të dokumentuar me prodhuesin. Në rastin konkret, nuk është paraqitur autorizim nga prodhuesi i certifikuar, dhe nuk është paraqitur autorizim nga Distributor te vërtetuar lidhje me prodhues të mirëfilltë, për të gjitha artikujt / mallrat objekt i prokurimi: Kuti kartoni, Dosje kartoni dhe për Etiketat. Ky Kriter kualifikues kërkon autorizim nga një prodhues i artikujve objekt prokurimi (kuti kartoni, dosje kartoni), jo nga një subjekt që vetëm shtyp apo dekoron materialin. Pra, në përputhje me pikën 2.3.3 kapaciteti teknik, të DST nëse operatori blen karton dhe e printon, ai nuk është prodhues i lëndës së parë dhe as i produktit final, për sa kohë që nuk ka linjë të prodhimit të vetë artikujve të tenderit. Kriteri kërkon një subjekt që e prodhon materialin (dosje, kuti), jo që vetëm i stampojnë apo i shtypin ato. Kriteri kërkon identifikim të qartë të prodhuesit. Nëse nuk je vetë prodhuesi i artikujve, duhet të paraqesësh autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i tij, me të dhëna të plota për prodhuesin. Për më tepër, ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis Kriterit 3.3.3 dhe Kriterit 3.3.4: Kriteri 3.3.4 kërkon paraqitjen e fletë-analizës së lëndës së parë (kartonit) të përdorur për kutitë dhe dosjet, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit. Kjo kërkesë nënkupton qartë se Kriteri 3.3.3 kërkon që operatori të jetë prodhues i kartonit që përdoret për artikujt objekt të prokurimit ose prodhues i plotë i artikujve përfundimtarë (kuti, dosje). Pra, nuk është e mjaftueshme që operatori të kryejë vetëm përpunim printimi apo dekorimi mbi materialet e gatshme, por duhet të ketë kapacitet prodhimi të lëndës bazë dhe/ose të produktit final. Në konkluzion, do të donim të parashtronim se OE Marketing & Distribution sh.p.k nuk është prodhues i artikujve (kuti kartoni, dosje kartoni, etiketa letre) por tregtues / importues. Në lidhje me këtë pikë, KVO e AK ka mbajtur qendrim të drejtë përse i përket vlerësimit të ofertës ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës Infosoft Office shpk. Duke e skualifikuar këto operator ekonomik, por në mënyrë të gabuar nuk ka mbajtur të njejtin qendrim dhe nuk e ka vlerësuar në të njejtën mënyrë ofertën e paraqitur nga OE Marketing & Distribution shpk. Për sa mësipër, në përputhje me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Së katërti, Ne kemi bindjen, që në zbatim të pikës 2.3.4 kapaciteti teknik, të DST, OE Marketing & Distribution shpk nuk përmbush Kriterin e Vëcantë të Kualifikimit, pasi NUK ka paraqitur: As fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ss (dhe/ose) skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë, që janë objekt i kësaj procedure prokurimi.

Në rastin e parqitjes së fletë analizës së lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, fletëanaliza do të duhet të përmbante të dhënat / karakteristikat e mëposhtme:

Për kartonin e kutive:

Gramatura së paku 615 g/m²

ph midis 7.0 dhe 9.5.

Rezerva alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit.

Jo më shumë se 1% lignin.

Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c

Për kartonin e dosjeve:

Gramatura së paku 325 g/m²

ph midis 7.0 dhe 9.5.

Rezerva alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit.

Jo më shumë se 1% lignin.

Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c

Në rastin e parqitjes së skedës teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë objekt prokurimi, skeda teknike do të duhet të përmbante të dhënat / karakteristikat e mëposhtme:

Për kartonin e kutive:

Gramatura së paku 615 g/m²

ph midis 7.0 dhe 9.5.

Rezerva alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit.

Jo më shumë se 1% lignin.

Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c

Për kartonin e dosjeve:

Gramatura së paku 325 g/m²

ph midis 7.0 dhe 9.5.

Rezerva alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit.

Jo më shumë se 1% lignin.

Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c

Referuar sa mësipër, ne kemi bindjen që OE Marketing & Distribution shpk NUK ka paraqatur as fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të specifikohen qartazi edhe specifikimet teknike të kërkuara në DST.

As skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë objekt prokurimi, e cila të përmbante qartazi të dhënat / specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Gjithashtu, OE Marketing & Distribution shpk. Nuk ka paraqitur autorizim të vlefshëm nga prodhuesi i kartonit, që të vërtetojë lidhjen midis operatorit ofertues dhe prodhuesit. Ky autorizim është i domosdoshëm për verifikimin e vlefshmërisë së ofertës dhe për të garantuar që operatori ekonomik ka të drejtën ligjore për të ofruar produktin e prodhuesit. Për sa mësipër, në përputhje me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Së Pesti, Ne kemi bindjen, që OE Marketing & Distribution KH shpk., në kundërshtim me pikën 2.3.5 kapacitetet teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, nuk ka paraqitur mostrat në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Në pikën 2.3.5 kapaciteti teknikë, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST përcaktohet se: “Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm*
 - 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm*
 - 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm*
 - 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm*
 - 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).*
- Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim.ë*

Në shtojcën 6, “Specifikimet teknike”, të dst përcaktohet se: “Formulari i specifikimeve teknike” Specifikimet teknike - vendim nr. 7, datë 9.9.2024 “Për miratimin e standardeve të kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre – shtojca 1 standardet e kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre.

Në lidhje me këtë kriter kualifikues, ne kemi bindjen që mostrat e paraqitura nga OE Marketing & Distribution shpk., NUK janë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara dhe të kërkuara në shtojcën 8 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit - kapaciteti teknik, pika 2.3.5, të DST, sa mëposhtë:

Përsa i përket mostrës së paraqitur Kuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x28x18 cm: NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket:

*Përmasave të kutisë të dorëzuar - 40x28x18 cm (Marzhi i gabimit të përmasave ? 3 mm)
Peshës së Kartonit të kutisë të dorëzuar - me gramaturë së paku 615 g/m²;
Ph të Kartonit të kutisë së dorëzuar - ph midis 7.0 dhe 9.5;
Rezervës së alkalines Kartonit të kutisë të dorëzuar - minimalisht prej 2% të karbonatit të kalciumit;
Të përmbajtjes së ligninit të Kartonit të kutisë së dorëzuar - jo më shumë se 1% lignin.
Ngjyrës së të kutisë të dorëzuar - të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c.*

Sic përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës ekuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x28x18 të dorëzuar nga OE Marketing & Distribution shpk. Nga Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpuethshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Marketing & Distribution shpk do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

Përsa i përket mostrës së paraqitur Kuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x55x18 cm: NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket:

*Përmasave të kutisë të dorëzuar - 40x55x18 cm (Marzhi i gabimit të përmasave ? 3 mm)
Peshës së Kartonit të kutisë të dorëzuar - me gramaturë së paku 615 g/m²;
Ph të Kartonit të kutisë së dorëzuar - ph midis 7.0 dhe 9.5;
Rezervës së alkalines Kartonit të kutisë të dorëzuar - minimalisht prej 2% të karbonatit të kalciumit;
Të përmbajtjes së ligninit të Kartonit të kutisë së dorëzuar - jo më shumë se 1% lignin.
Ngjyrës së të kutisë të dorëzuar - të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c.*

Sic përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në

DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës ëkuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x55x18 të dorëzuar nga OE Marketing & Distribution shpk. Nga Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpuethshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Marketing & Distribution shpk do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

Përsa i përket mostrës së paraqitur Kuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x70x9 cm: NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket:

*Përmasave të kutisë të dorëzuar - 40x70x9 cm (Marzhi i gabimit të përmasave ? 3 mm)
Peshës së Kartonit të kutisë të dorëzuar - me gramaturë së paku 615 g/m²;
Ph të Kartonit të kutisë së dorëzuar - ph midis 7.0 dhe 9.5;
Rezervës së alkalines Kartonit të kutisë të dorëzuar - minimalisht prej 2% të karbonatit të kalciumit;
Të përmbajtjes së ligninit të Kartonit të kutisë së dorëzuar - jo më shumë se 1% lignin.
Ngjyrës së të kutisë të dorëzuar - të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c.*

Sic përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës ëkuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x70x9 të dorëzuar nga OE Marketing & Distribution shpk. Nga Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpuethshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Marketing & Distribution shpk do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

Përsa i përket mostrës së paraqitur Dosje për ruajtje të përhershme, me përmasa 36x24 cm: NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket:

*Përmasave të Dosjes së dorëzuar - 40x70x9 cm (Marzhi i gabimit të përmasave ? 3 mm)
Peshës së Kartonit të Dosjes të dorëzuar - me gramaturë së paku 325 g/m²;
Ph të Kartonit të Dosjes së dorëzuar - ph midis 7.0 dhe 9.5;*

Rezervës së alkalines Kartonit të Dosjes së dorëzuar - minimalisht prej 2% të karbonatit të kalciumit;

Të përmbajtjes së ligninit të Kartonit të Dosjes së dorëzuar - jo më shumë se 1% lignin.

Ngjyrës së Dosjes të dorëzuar - të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c.

Sic përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës së Dosje për ruajtje të përhershme, me përmasa 36x24 cm të dorëzuar nga OE Marketing & Distribution shpk. Nga laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST.

Gjithashtu, mostra e paraqitur nga OE Marketing & Distribution shpk. Dosje për ruajtje të përhershme, me përmasa 36x24 cm, nuk është në përputhje me specifikimet teknike plotësuese (që nuk janë në vendimin nr. Nr.7, datë 09.09.2024 të KLA) të përcaktuara nga Grupi i punës, sa mëposhtë:

Dizajni nuk është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; Madhësia / përmasat e Shkrimit dhe vijëzimit nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës;

Numri i vijëzimeve / dhe distancat ndërmjet vijëzimeve (12 vijëzime të pa ndërprera me distancë 1.5 cm) nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës;

Distanca e kornizimit të dosjes nga broder line në limitin e dosjes nuk është 2 cm sipas specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës;

Korniza e Dosjes nuk është me gjerësi 2 mm sipas specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës.

Sic përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të matjes me pajisje të kalibruara dhe certifikuar të mostrës dosje për ruajtje të përhershme, me përmasa 36x24 cm të dorëzuar nga OE Marketing & Distribution shpk. Nga Institucione / Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me

specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Marketing & Distribution shpk do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

Përsa i përket mostrës së paraqitur Etiketa, me përmasa 15x10 cm:

Mostra e paraqitur nga OE Marketing & Distribution shpk. Etiketa, me përmasa 15x10 cm, nuk është në përputhje me specifikimet teknike plotësuese (që nuk janë në vendimin nr. Nr.7, datë 09.09.2024 të KLA) të përcaktuara nga Grupi i punës, sa mëposhtë:

Përmasat e etiketës së dorëzuar - 15x10 cm, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara;

Dizajni nuk është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; Madhësia / përmasat e Shkrimit dhe vijëzimit nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës;

Madhësia / përmasat e Logos (2 cm lartësia dhe 2.5 cm gjerësi) dhe ngjyra e logos (5C (katër ngjyrat bazë plus bojë speciale panton 1505c)+llak) nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës;

Numri i Rreshtave / dhe distancat (hapësira nga rreshti në rresht) ndërmjet Rreshtave / vijëzimeve (8 vijëzime/rreshta x 0.6 cm = 4.8 cm dhe duke shtuar lartësinë e logos 2.5 cm shkon në 7.2 cm.) Nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës;

Distanca e kornizimit të etiketës nga broder line në limitin e dosjes nuk është 0.5 cm sipas specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës;

Sic përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të matjes me pajisje të kalibruara dhe certifikuar të mostrës etiketa, me përmasa 15x10 cm të dorëzuar nga OE Marketing & Distribution shpk. Nga Institucione / Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpuethshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Marketing & Distribution shpk do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

Së Gjashti, mendojmë që në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST, dhe rregullat e prokurimit publik, OE Marketing & Distribution shpk., ditën dhe orën e hapjes së ofertave, nuk

ka paraqitur / dorëzuar në sistemin SPE të APP, një vërtetim të vlefshëm, i cili vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të faturave të energjisë elektrike, për të gjitha adresat ku ushtron aktivitetin tregtar. Rrjedhimisht, OE Marketing & Distribution shpk., do të duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe në rregullat e prokurimit publik.

Për të gjitha sa u parashtruan mësipër, KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, pasi të kryejnë verifikimet e kërkuara të duhura, do të duhet të:

Ndryshojë vendimin e marrë nga KVO e AK Operatori i Blerjeve të përqendruara;

Skualifikojë OE Kristalina KH shpk.;

Skualifikojë OE Marketing & Distribution shpk.;

...si dhe të shpallë fitues të procedurës së prokurimit të lartpërmendur, BOE Office Paper shpk. Dhe Inpress shpk.

Gjithashtu bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues kërkon testimin e të gjitha mostrave të dorëzuara nga OE Kristalina KH shpk. Nga laboratorë të Akredituar në republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrave të paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5, të DST, pasi kemi bindjen që mostrat e paraqitura nga ky operator ekonomik nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 7, të DST.

Të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të matjes me pajisje të kalibruara dhe certifikuar të mostrave: Dosje për Ruajtje të Përhershme 36x24 cm dhe Etiketa, me përmasa 15x10 cm të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga Institucione / Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrave të paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST.

Testimin e të gjitha mostrave të dorëzuara nga OE Marketing & Distribution shpk. Nga Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrave të paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5, të DST, pasi kemi bindjen që mostrat e paraqitura nga ky operator ekonomik nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 7, të DST.

Të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të matjes me pajisje të kalibruara dhe certifikuar të mostrave: Dosje për Ruajtje të Përhershme 36x24 cm dhe Etiketa, me përmasa 15x10 cm të dorëzuar nga OE Marketing & Distribution shpk. Nga Institucione / Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrave të paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST.

II.27. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2052/1 prot., datë 01.08.2025, janë publikuar kriteret e kualifikimit për të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga ana e operatorëve ekonomikë “Marketing & Distribution” SHPK dhe “Kristalina KH” SHPK, i cili i kundërshton me anë të ankesës me nr. 2052 prot., datë 31.07.2025.

II.28. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se më datë 05.08.2025 operatori ekonomik i interesuar “Kristalina KH” SHPK ka paraqitur formularin e argumentave në lidhje me ankesën e BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me nr. 2052/2 prot, datë 05.08.2025, sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.29. Me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2052/3 prot., datë 12.08.2025, ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike si dhe shkresës nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2052/4 prot., datë 13.08.2025, ardhur nëpërmjetë shërbimit postar autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, ku me vendimin nr. 78/2025, datë 11.08.2025, ka vendosur mospranimin e pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK”.

II.30. Në datë 04.12.2025, Komisioni Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1798/2025, për testimin e mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK dhe “Marketing & Distribution” SHPK, ku ka vendosur si më poshtë vijon:

1. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për ekzaminimin e mostrave të kutive dhe dosjeve të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Marketing & Distribution” SHPK dhe “Kristalina – KH” SHPK nga laborator i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

2. Të testohen komponentët 1- Gramaturë; 2- pH; 3- Bardhësi/ngjyrë, të mostrave të operatorit ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK dhe “*Kristalina – KH*” SHPK, për:
 - kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm)
 - kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
 - kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
 - dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
3. Laboratori testues “*Eko-Studio Projekt*” SHPK, të argumentojë në nivel teknik nëse në rezultatet e testimit, ndikon marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm, i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK, të parapaguajë për llogari të laboratorit testues “*Eko-Studio Projekt*” SHPK, shumën prej 156,000 lekë pa TVSh sipas tarifave të përcaktuara me shkresën nr. 1061 prot., datë 07.11.2025, për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 10.12.2025 ora 12:00.
5. Në datë 11.12.2025, ora 12:15 të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të operatori ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK dhe përfaqësues të Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a për verifikimin e mostrave për të cilët ngrihen pretendimet.
6. Në datë 11.12.2025, ora 12:30 të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK dhe përfaqësues të Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a për verifikimin e mostrave për të cilët ngrihen pretendimet.
7. Më datë 11.12.2025 ora 12:45 përfaqësuesit e pranishëm në këtë seancë do të dorëzojnë mostrat për testim pranë laboratorit të shoqërisë “*Eko-Studio Projekt*” SHPK
8. Të njoftojet laboratori testues “*Eko-Studio Projekt*” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën 11.12.2025.
9. Afati për kthimin e përgjigjes së testimit është brenda 5 (pesë) ditëve punë, nga dita e nesërme e marrjes në dorëzim të mostrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.31. Përmes shkresës nr. 90 prot, datë 08.12.2025 protokolluar me tonën me nr. 2052/8 prot., datë 09.12.2025 është paraqitur nga operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK kërkesa me lëndë “*Kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 1798/2025, datë 04.12.2025*”. Nëpërmjetë së cilës ngren pretendime që mostrat e dorëzuara prej tij të mos analizohen nga laboratorit Eko Studio Projekt pasi ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, por të përzgjidhet një laborator tjetër.

II.32. Me datë 10.12.2025, me shkresën nr. 2052/9, është protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik mandat - pagesa e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK në favor të laboratorit Eko Studio Projekt SHPK.

II.33. Në datën 11.12.2023, ora 12:15, në prani të përfaqësuesve të shoqërisë “*Marketing & Distribution*” SHPK, “*Kristalina KH*” SHPK, të autoritetit kontraktor, dhe të Komisionit të Prokurimit Publik, në ambientet e KPP-së u mbajt seancë dëgjimore me regjistrim audio të seancës. Në këtë seancë përfaqësuesja e operatorit ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK pasi u pyet për mostrat e nëse ka pretendime për to, u pohua se nuk ka asnjë pretendim dhe se mostrat janë të tyre, gjithashtu përfaqësuesja e operatorit ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK shprehu dakortësin për analizimin e mostrave në laboratorin “Eko Studio Projekt”, dhe përfaqësuesit e autoritetit kontraktor nuk patën pretendime dhe kërkesa paraprake, ndërsa përfaqësuesi i operatorit ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK, nuk pati edhe ai pretendime për mostrat e dorëzuara pohoi se janë mostrat e tij, por në seancë pati një kërkesë paraprake, kërkesë të cilën e ka dërguar edhe me rrugë postare, ku konteston laboratorin e përzgjedhur nga ana e Komisionit Prokurimit Publik për kryerjen e analizimit të mostrave, i cili nuk ishte dakort që mostrat e tij të analizoheshin nga laboratorin “Eko Studio Projekt” me pretendimin se ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me këtë laborator. Në lidhje me këtë kërkesë paraprake Komisioni gjykon të merret në konsideratë dhe do të kryejë verifikimet edhe njëherë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në lidhje me laboratorët e akredituar. Në përfundim kërkesa e operatorit ekonomik ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK lidhet me rishimin e vendimit në lidhje me veprimet proceduriale të testimit të mostrave. Në përfundim të saj kjo seancë dëgjimore deklarohet e mbyllur.

II.34. Në datë 06.01.2026, Komisioni Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 19/2026, për testimin e mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK dhe “*Marketing & Distribution*” SHPK, ku ka vendosur si më poshtë vijon:

1. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për ekzaminimin e mostrave të kutive dhe dosjeve të paraqitura nga operatorët ekonomikë “*Marketing & Distribution*” SHPK nga laboratorin i akredituar i shoqërisë “*Eko-Studio Projekt*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “*Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme*”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Të testohen komponentët 1- Gramaturë; 2- pH; 3- Bardhësi/ngjyrë, të mostrave të operatorit ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK, për:
 - kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm)

- kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
 - kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
 - dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
3. Laboratori testues “*Eko-Studio Projekt*” SHPK, të argumentojë në nivel teknik nëse në rezultatet e testimit, ndikon marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm, i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.
 4. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për ekzaminimin e mostrave të kutive dhe dosjeve të paraqitura nga operatorët ekonomikë “*Kristalina KH*” SHPK nga laboratorit i akredituar i shoqërisë “*ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “*Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme*”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
 5. Të testohen komponentët 1- Gramaturë; 2- pH; 3- Bardhësi/ngjyrë, të mostrave të operatorit ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK, për:
 - kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm)
 - kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
 - kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
 - dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
 6. Laboratori testues “*ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing*” SHPK, të argumentojë në nivel teknik nëse në rezultatet e testimit, ndikon marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm, i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.
 7. Të urdhërojë laboratorin testues “*Eko-Studio Projekt*” SHPK të bëjë kthimin e tarifës prej 78.000 lekë të parapaguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK në llogarinë e tyre, si dhe të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik për veprimet e kryera.

8. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, të parapaguajë për llogari të laboratorit testues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, shumën prej 71,6000 lekë pa TVSh sipas tarifave të përcaktuara me shkresën nr. 364 prot., datë 24.12.2025, për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 12.01.2026 ora 12:00.
9. Në datë 12.01.2026, ora 12:15 të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK dhe përfaqësues të Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a për të shoqëruar dorëzimin e mostrave pranë laboratorit testues *Eko-Studio Projekt*” SHPK.
10. Në datë 12.01.2026, ora 13:30 të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK dhe përfaqësues të Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a për të shoqëruar dorëzimin e mostrave pranë laboratorit testues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK.
11. Të njoftojt laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën 12.01.2026.
12. Të njoftojt laboratorit testues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën 12.01.2026.
13. Afati për kthimin e përgjigjes së testimit është brenda 5 (pesë) ditëve punë, nga dita e nesërme e marrjes në dorëzim të mostrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.35. Me datë 12.01.2026, me shkresën nr. 2052/13, është protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik mandat - pagesa e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK në favor të laboratorit ECCAT SHPK.

II.36. Në datën 12.01.2024, në mjediset e laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK , u mbajt procesverbali me përmbajtje si më poshtë:

“Mbi dorëzimin e mostrave te operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK pranë laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK

I mbajtur sot me datë 12.01.2025 ora 12:15 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik në prani të Z. XXXXXX me detyrë, Inspektor në KPP dhe Z/Znj. XXXXX përfaqësues i operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, si dhe Z/Znj. XXXXX përfaqësues i autoritetit kontraktor do të shoqërojnë dorëzimin e mostrave të operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK pranë laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK lidhur me ankimin

administrativ me nr. 2052 protokoli, viti 2025 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “*Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme*”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Nga ana e operatorit ekonomik të interesuar “*Marketing & Distribution*” SHPK mostrat e të cilëve do të testohen nuk patën pretendime në lidhje me mostrat.

II.37. Në datën 12.01.2024, në mjediset e laboratorit testues “*ECCAT*” SHPK , u mbajt procesverbali me përmbajtje si më poshtë:

“Mbi dorëzimin e mostrave të operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK pranë laboratorit testues “ECCAT” SHPK


I mbajtur sot me datë 12.01.2025 ora 13:30 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik në prani të Z. XXXXXX me detyrë, Inspektor në KPP dhe Z/Znj. XXXXX përfaqësues i operatorit ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK, si dhe Z/Znj. XXXXXX përfaqësues i autoritetit kontraktor do të shoqërojnë dorëzimin e mostrave të operatorit ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK pranë laboratorit testues “*ECCAT*” SHPK lidhur me ankimin administrativ me nr. 2052 protokoli, viti 2025 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “*Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme*”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Nga ana e operatorit ekonomik të interesuar “*Kristalina KH*” SHPK mostrat e të cilit do të testohen nuk pati pretendime në lidhje me mostrat.

II.38. Me shkresën nr. 369 prot., datë 16.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 2052/14, datë 21.01.2026, me objekt “*Dorëzim i raporteve të analizave laboratorike*”, laboratorit testues “*ECCAT*” SHPK, ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik Raport - Testimin në zbatim të vendimit nr. 19/2026, datë 06.01.2026, ndër të tjera me përmbajtje edhe si vijon:



ENVIRONMENTAL CONSULTING, CHEMICAL ANALYSIS & TESTING



Nr. 369 Prot.

Tiranë më: 16/01/2026

Shkresë Përcjellëse

DREJTUAR: Komisionit të Prokurimit Publik (KPP)

LËNDA: Dorëzim i raporteve të analizave laboratorike

Me anë të kësaj shkresë përcjellëse, shoqëria ECCAT sh.p.k. paraqet dhe dorëzon raportet e analizave për katër mostrat e sjella pranë laboratorit më datë 12.01.2026 nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), në zbatim të Vendimit nr. 19/2025, me Nr.Prot. 2052/11, datë 06.01.2026

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

Për ECCAT sh.p.k.
Fatlinda Ballabani



RAPORT ANALIZË

MATJA E PARAMETRAVE TË KARTONIT



Data e raportimit: 15.01.2026

Operatori: Komisioni Prokurimit Publik (KPP)

NIPT: -

Klient: Komisioni Prokurimit Publik (KPP)

Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë

Qyteti: Tiranë

Shteti: Shqipëri

Informacioni i Mostrës

Identifikimi: 001/01/2026

Materia: Karton

Data e marrjes mostrës: 12/01/2026

Data e pranimit mostrës: 12/01/2026

Data e fillimit të testimit: 12/01/2026

Data e mbarimit të testimit: 14/01/2026

Mostruesi: Klient

Vendndodhja e kryerjes së testit: Laborator

Raport Nr.1 – Kuti për ruajtje të përhershme 40x28x18cm

Nr.	Parametri	Njësia	Rezultati	Metoda e Analizës
1.	Gramatura	g/m ²	637.33	ISO 536:2019
2.	pH	-	7.44	ISO 6588-1:2021
3.	Percaktimi i bardhësisë CIE _L C/2°	-	70.2	ISO 11476:2016

**Shënim : Rezultati i referohet mostres se sjelle nga Komisioni Prokurimit Publik (KPP) ne daten 12/01/2026 per subjektin Kristalina KH me NIPT K11501002D dhe Adrese: Tiranë, LORD BAJRONI-LAPRAKE.*

INFORMACION MBI MOSTREN

- Përmasat paraqesin një tolerancë prej ± 3 mm.
- Indeksi i bardhësisë i referohet ngjyrës së kutisë, e cila korrespondon me Pantone 427c.

Administrator

Data e raportimit: 15.01.2026

Operatori: Komisioni Prokurimit Publik (KPP) NIPT: - Klient: Komisioni Prokurimit Publik (KPP) Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë Qyteti: Tiranë Shteti: Shqipëri	Informacioni i Mostrës Identifikimi: 002/01/2026 Matrica: Karton Data e marrjes mostrës: 12/01/2026 Data e pranimit mostrës: 12/01/2026 Data e fillimit të testimit: 12/01/2026 Data e mbarimit të testimit: 14/01/2026 Mostruesi: Klient Vendndodhja e kryerjes së testit: Laborator
--	--

Raport Nr.2 – Kutë për ruajtje të përhershme për amza 40x55x18cm

Nr.	Parametri	Njësia	Rezultati	Metoda e Analizës
1.	Gramatura	g/m ²	625.64	ISO 536:2019
2.	pH		7.20	ISO 6588-1:2021
3.	Percaktimi i bardhësisë CIE, C/2°	-	70.2	ISO 11476:2016

**Shënim : Rezultati i referohet mostrës së sjellë nga Komisioni Prokurimit Publik (KPP) në datën 12/01/2026 për subjektin Kristalina KH me NIPT K11501002D dhe Adresë: Tiranë, LORD BAJRONI-LAPRAKE.*

INFORMACION MBI MOSTREN

- Përmasat paraqesin një tolerancë prej ±3 mm.
- Indeksi i bardhësisë i referohet ngjyrës së dosjes, e cila korrespondon me Pantone 427c.

Administratë
Fatlinda Ballabani

Data e raportimit: 15.01.2026

Operatori: Komisioni Prokurimit Publik (KPP) NIPT: - Klient: Komisioni Prokurimit Publik (KPP) Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë Qyteti: Tiranë Shteti: Shqipëri	Informacioni i Mostrës Identifikimi: 003/01/2026 Matrica: Karton Data e marrjes mostrës: 12/01/2026 Data e pranimit mostrës: 12/01/2026 Data e fillimit të testimit: 12/01/2026 Data e mbarimit të testimit: 14/01/2026 Mostruesi: Klient Vendndodhja e kryerjes së testit: Laborator
--	--

Raport Nr.3 – Kutë për ruajtje të përhershme për regjistra 40x70x9cm

Nr.	Parametri	Njësia	Rezultati	Metoda e Analizës
1.	Gramatura	g/m ²	617.48	ISO 536:2019
2.	pH		7.29	ISO 6588-1:2021
3.	Percaktimi i bardhësisë CIE, C/2°	-	70.2	ISO 11476:2016

**Shënim : Rezultati i referohet mostrës së sjellë nga Komisioni Prokurimit Publik (KPP) në datën 12/01/2026 për subjektin Kristalina KH me NIPT K11501002D dhe Adresë: Tiranë, LORD BAJRONI-LAPRAKE.*

INFORMACION MBI MOSTREN

- Përmasat paraqesin një tolerancë prej ±3 mm.
- Indeksi i bardhësisë i referohet ngjyrës së kutisë, e cila korrespondon me Pantone 427c.

Administratë
Fatlinda Ballabani

Data e raportimit: 15.01.2026

Operatori: Komisioni Prokurimit Publik (KPP) NIPT: - Klient: Komisioni Prokurimit Publik (KPP) Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë Qyteti: Tiranë Shteti: Shqipëri	Informacioni i Mostrës Identifikimi: 004/01/2026 Matrica: Karton Data e marrjes mostrës: 12/01/2026 Data e pranimit mostrës: 12/01/2026 Data e fillimit të testimit: 12/01/2026 Data e mbarimit të testimit: 14/01/2026 Mostruesi: Klient Vendndodhja e kryerjes së testit: Laborator
--	--

Raport Nr.4 – Dosje per ruajtje te perhershme 36x24cm

Nr.	Parametri	Njësia	Rezultati	Metoda e Analizës
1.	Gramatura	g/m ²	326.95	ISO 536:2019
2.	pH	-	7.14	ISO 6588-1:2021
3.	Percaktimi i bardhësisë CIE, C/2°	-	70.2	ISO 11476:2016

**Shenim : Rezultati i referohet mostres se sjelle nga Komisioni Prokurimit Publik (KPP) ne daten 12/01/2026 per subjektin Kristalina KH me NIPT K11501002D dhe Adrese: Tiranë, LORD BAJRONI-LAPRAKE.*

INFORMACION MBI MOSTREN

- Përmasat paraqesin një tolerancë prej ±3 mm.
- Indeksi i bardhësisë i referohet ngjyrës së dosjes, e cila korrespondon me Pantone 427c.

Administratë
Fatllinda Ballabani

II.39. Me shkresën nr. 42 prot., datë 19.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 2052/15, datë 21.01.2026, me objekt “Kthim-përgjigje shkresës me Nr. 2052/12 Prot, datë 06.01.2026”, laborator testues “Eko-Studio-Projekt” SHPK, ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik Raport - Testimin në zbatim të vendimit nr. 19/2026, datë 06.01.2026, ndër të tjera me përmbajtje edhe si vijon:



Eko - Studio - Projekt Sh.p.k.
NIPT-1 L036148030 - Licence Profesionale OKI LN-2652-01-2011
Bulevardi Gjergj Fishta, Nr. 48 Tiranë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
 Nr. 2052/15 Prot
 Data: me 21.01.2026

Nr. 42 Prot. Tiranë, më 19/01/2026

Lënda: Kthim Përgjigje shkresës me Nr.2052/12 Prot., datë 06.01.2026

Drejtuar: Komisionit të Prokurimit Publik
Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Kati I, Tiranë.

Në përgjigje të shkresës Suaj me Nr. 2052/12 Prot., datë 06.01.2026, me lëndë "Dërgim Vendimi nr. 19/2025", drejtuar pranë zyrës sonë, ju bëjmë me dije sa vijon:

Pranë laboratorit “Eko – Studio-Projekt” sh.p.k. janë paraqitur, me datë 12.01.2026, disa kampionë të tipologjisë kuti kartoni në formate të ndryshme, si dhe dosje kartoni, për të cilët janë kryer analizat laboratorike për përcaktimin e parametrave të gramaturës, pH-së dhe bardhësisë, për secilin kampion përkatës. Bashkëlidhur kësaj shkresë gjëni raportin e testimit, i cili përmban rezultatet e matjeve për parametrat e sipërcituar.

Gjithashtu, në përgjigje të pikës 3 të Vendimit nr. 19/2025, të regjistruar me Nr. 2052/11 Prot., datë 06.01.2026, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Nga pikëpamja metrologjike, çdo pasaktësi dimensionale kontribuon në pasigurinë e përgjithshme të matjes, në përputhje me parimet e përcaktuara në ISO/IEC Guide 98-3 (GUM). Në rastet kur testimi lidhet me parametra që varen nga përmasat gjeometrike të mostrës (si p.sh. vëllimi specifik, dendësia, rezistenca mekanike, përthithja, përcueshmëria termike apo parametra të tjerë të normalizuar ndaj sipërfaqes ose vëllimit), një devijim prej ±3 mm mund të sjellë ndryshime të ndjeshme në vlerat e përlogaritura, veçanërisht kur përmasat nominale të mostrës janë të vogla ose kur kërkohet një nivel i lartë saktësie. Në testet ku përmasat e mostrës nuk përbëjnë parametra kritikë (p.sh. analiza kimike cilësore ose teste që nuk varen nga gjeometria e mostrës), marzhi ±3 mm mund të konsiderohet i papërfillshëm, për sa kohë që mostrat mbeten brenda kufijve të pranueshëm të përcaktuar nga standardi i metodës së provës. Për rrjedhojë, ndikimi i marzhit të gabimit ±3 mm në rezultatet e testimit nuk mund të përgjithësohet, por duhet të vlerësohet rast pas rasti, në varësi të:

- llojit të testimit dhe standardit të aplikuar;
- ndjeshmërisë së parametrave ndaj ndryshimeve dimensionale;
- madhësisë nominale të mostrës;
- nivelit të pasigurisë së pranueshme për rezultatin përfundimtar.

Duke Ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të marrjes në konsiderim të shkresës tonë.

Per Eko – Studio - Projekt Sh.p.k.

Nr. 20 Prot.

Tiranë, më 19/01/2026

Raport Testimi

Për institucionin:

"Komisioni i Prokurimeve Publike"

Adresa:

Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Pallati i Kongreseve, Kati i I, Tirane.

Te dhenat e kontaktit:

Perfaqesuesi i komisionit te KPP: Ergys Streza

Adrese e-mail : kpp_info@kpp.gov.al

Nr. Kontakti: +355 4 2281 851

Monitorues:

"Eko-Studio-Projekt" sh.p.k. me laborator testues te Akredituar nga DPA sipas standartit S SH ISO/IEC 17025:2017, me Nr. LT 070 per kryerjen e analizave te komponenteve mjedisor. Eshte certifikuar per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise sipas EN-ISO 9001:2015, per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit sipas EN-ISO 14001:2015, per monitorim mjedisor dhe hartim i dokumentacionit perkates dhe per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune sipas ISO 45001:2018.

Pergatiti Raportin :

"Eko-Studio-Projekt" Sh.p.k. regjistruar me NIPT: L03614803Q dhe me Licencë Profesionale LN-2652-01-2011.

Administrator
"Eko-Studio-Projekt" Sh.p.k.

EKO STUDIO PROJEKT					
NIPT-i L03614803Q - Licencë Profesionale QKL LN-2652-01-2011 Bulevardi Gjergj Fishta, Nr. 48, Tiranë, Albania.					
Raport - Testimi			Nr. <u>20</u>		
Data e marrjes se kampionit		<u>12/01/2026</u>		Data e analizimit te kampionit <u>14/01/2026</u>	
Nr. <u>20</u> Prot.		Data <u>19/01/2026</u>			
Subjekti i Monitoruar		Komisioni i Prokurimeve Publike			
Vendndodhja e Subjektit		Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Pallati i Kongreseve, Kati i I, Tirane			
Vendndodhja e kryerjes se matjes		☒ Ne mjediset e laboratorit		☐ Jashte mjedisese te Laboratorit	
Tipi i kampionit		☒ SPS – Kampion letre i ngurte		☐ OS- Tip tjetër Kampioni	
Lloji i kampionit		☐ PS- Kampion Letre		☒ CBS – Kampion Kartoni	
☐ PPS – Kampion Pulpe Letre					
Kodi i mostres:		SPS-CBS-20		Plani i kampionimit	
Amballazhi i Mostres		Karton		Sasija e Mostres	
				Kuti kartoni	
Nr.	Komponentët e matur	Metoda	Të dhënat e matjes	Pasig. e matjes	Njesia
1.	Gramatura	ISO 536:2019	576.919	± 1.41	g/m ²
2.	Bardhesia	SSH ISO 11475:2017	67.8	± 0.5	CIE
3.	pH	SSH ISO 6588-1:2021	8.31	± 1.32	
Analizat u kryen nga:			Aprovuar nga:		
Ing:			Shefi i Laboratorit		
Ky raport testimi kryhet nga kampionit te marre ose sjelle nga klienti i kontraktuar, nuk lejohet e premtja e riprodhimit dhe shpalljes se tij pa dijenine e laboratorit testues te Eko-Studio-Projekt. Çdo reklamim i tij behet me shkrim ne nje periudhe 5 dite nga data e dorezimit te këtij raporti testimi duke marre parasysh kushtet ambientale ne te cilat eshte kryer testimi (lloji, presion, temp etj.)					
Pikat ku u kryen matjet dhe kampionimet.					
Përshkrimi			Shënimi		
Analiza e kartonit u realizua per kampionin me kod SPS-CBS-20-I i cili i perket kutise se kartonit me permasa 40 cm * 70 cm * 9 cm. Nga kampioni u perzgjodh nje siperfaqe e padentuar e kutise e cila u pre ne permasa 15cm * 15 cm.			Prane laboratorit te ESP jane paragjitur disa kampion te tipologjise 3 (tre) kuti kartoni te formateve te ndryshme dhe 1 (nje) dosje kartoni nga ku u rregjistrua me:		
Pika I-			1. nr. I kutia per ruajtjen e perhershme me permasa 40*70*9 cm e perbere nga karton i forte me mes te vazezuar		
			2. nr. II kutia per ruajtjen e perhershme me permasa 40*28*18 cm e perbere nga karton i forte me mes te vazezuar		
			3. nr. III kutia per ruajtjen e perhershme me permasa 40*55*18 cm e perbere nga karton i forte me mes te vazezuar.		
			4. nr. IV dosje per ruajtjen e perhershme me permasa 36*24 cm e perbere nga karton te njetrajtshem.		

**Parametrat e shprehur me "C" shprehne pjese e fushes se Akreditimit

EKO STUDIO PROJEKT

NIPT-i L03614803Q - Licencë Profesionale QKI LN-2652-01-2011

Bulevardi Gjergj Fishta, Nr. 48, Tiranë, Albania.

Raport - Testimi

Nr. 20/1

Data e marrjes së kampionit	<u>12/01/2026</u>	Data e analizimit të kampionit	<u>14/01/2026</u>
Nr. <u>20</u> Prot.	Data <u>18/01/2026</u>		
Subjekti i Monitoruar	Komisioni i Prokurimeve Publike		
Vendndodhja e Subjektit	Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Pallati i Kongreseve, Kati i I, Tirane		
Vendndodhja e kryerjes së matjes	☒ Ne mjediset e laboratorit	☐ Jashtë mjedisve të Laboratorit	
Tipi i kampionit	☒ SPS - Kampion letre i ngurte	☐ OS- Tip tjetër Kampioni	
Lloji i kampionit	☐ PS- Kampion Letre	☒ CBS - Kampion Kartoni	
Kodi i mostres:	SPS-CBS-20	Plani i kampionimit	-
Amballazhi i Mostres	Karton	Sasi e Mostres	Kuti kartoni

Nr.	Komponentët e matur	Metoda	Të dhënat e matjes	Pasig. e matjes	Njesia
1.	Gramatura	ISO 536:2019	Pika II 567.960	± 1.41	g/m ²
2.	Bardhesia	SSH ISO 11475:2017	68.5	± 0.5	CIE
3.	pH	SSH ISO 6588-1:2021	8.26	± 1.32	

Analizat u kryen nga: Ing. [Signature] Aprovuar nga: Shefi i Laboratorit [Signature]

Ky raport testimi i kampionit të marrë ose sjellë nga klienti i kontraktuar, nuk lejohet të drejta e riprodhimit pa lejen e autorit të testimit. Çdo reklamim i tij behet me shkrim në një periudhë jo më shumë se 5 ditë nga data e dorëzimit të këtij raporti testimi duke marrë parasysh kushtet ambientale në të cilat është kryer testimi (lagështi, presion, temp etj.)

Pikat ku u kryen matjet dhe kampionimet.

Përshkrimi	Shënim
Pika I Analiza e kartonit u realizua për kampionin me kod SPS-CBS-20-II i cili i përket kutisë së kartonit me përmasa 40 cm * 28 cm * 18 cm. Nga kampioni u përzgjedh një sipërfaqe e padëmtuar e kutisë e cila u prë në përmasa 15cm * 15 cm.	Prane laboratorit të ESP janë paraqitur disa kampion të tipologjisë 3 (tre) kuti kartoni të formave të ndryshme dhe 1 (një) dosje kartoni nga ku u rregjistrua me: 1. nr. I kutia për ruajtjen e perhershme me përmasa 40*70*9 cm e perbere nga karton i forte me mes të vëzhguar 2. nr. II kutia për ruajtjen e perhershme me përmasa 40*28*18 cm e perbere nga karton i forte me mes të vëzhguar 3. nr. III kutia për ruajtjen e perhershme me përmasa 40*55*18 cm e perbere nga karton i forte me mes të vëzhguar 4. nr. IV dosje për ruajtjen e perhershme me përmasa 36*24 cm e perbere nga karton të njetratshëm.

**Parametrat e shënuar me * nuk janë pjesë e fushës së Akreditimit

EKO STUDIO PROJEKT

NIPT-i L03614803Q - Licencë Profesionale QKI LN-2652-01-2011

Bulevardi Gjergj Fishta, Nr. 48, Tiranë, Albania.

Raport - Testimi

Nr. 20/2

Data e marrjes së kampionit	<u>12/01/2026</u>	Data e analizimit të kampionit	<u>14/01/2026</u>
Nr. <u>20</u> Prot.	Data <u>18/01/2026</u>		
Subjekti i Monitoruar	Komisioni i Prokurimeve Publike		
Vendndodhja e Subjektit	Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Pallati i Kongreseve, Kati i I, Tirane		
Vendndodhja e kryerjes së matjes	☒ Ne mjediset e laboratorit	☐ Jashtë mjedisve të Laboratorit	
Tipi i kampionit	☒ SPS - Kampion letre i ngurte	☐ OS- Tip tjetër Kampioni	
Lloji i kampionit	☐ PS- Kampion Letre	☒ CBS - Kampion Kartoni	
Kodi i mostres:	SPS-CBS-20	Plani i kampionimit	-
Amballazhi i Mostres	Karton	Sasi e Mostres	Kuti kartoni

Nr.	Komponentët e matur	Metoda	Të dhënat e matjes	Pasig. e matjes	Njesia
1.	Gramatura	ISO 536:2019	Pika III 576.262	± 1.41	g/m ²
2.	Bardhesia	SSH ISO 11475:2017	66.7	± 0.5	CIE
3.	pH	SSH ISO 6588-1:2021	8.25	± 1.32	

Analizat u kryen nga: Ing. [Signature] Aprovuar nga: Shefi i Laboratorit [Signature]

Ky raport testimi i kampionit të marrë ose sjellë nga klienti i kontraktuar, nuk lejohet të drejta e riprodhimit pa lejen e autorit të testimit. Çdo reklamim i tij behet me shkrim në një periudhë jo më shumë se 5 ditë nga data e dorëzimit të këtij raporti testimi duke marrë parasysh kushtet ambientale në të cilat është kryer testimi (lagështi, presion, temp etj.)

Pikat ku u kryen matjet dhe kampionimet.

Përshkrimi	Shënim
Pika III- Analiza e kartonit u realizua për kampionin me kod SPS-CBS-20-III i cili i përket kutisë së kartonit me përmasa 40 cm * 55 cm * 18 cm. Nga kampioni u përzgjedh një sipërfaqe e padëmtuar e kutisë e cila u prë në përmasa 15cm * 15 cm.	Prane laboratorit të ESP janë paraqitur disa kampion të tipologjisë 3 (tre) kuti kartoni të formave të ndryshme dhe 1 (një) dosje kartoni nga ku u rregjistrua me: 1. nr. I kutia për ruajtjen e perhershme me përmasa 40*70*9 cm e perbere nga karton i forte me mes të vëzhguar 2. nr. II kutia për ruajtjen e perhershme me përmasa 40*28*18 cm e perbere nga karton i forte me mes të vëzhguar 3. nr. III kutia për ruajtjen e perhershme me përmasa 40*55*18 cm e perbere nga karton i forte me mes të vëzhguar 4. nr. IV dosje për ruajtjen e perhershme me përmasa 36*24 cm e perbere nga karton të njetratshëm.

**Parametrat e shënuar me * nuk janë pjesë e fushës së Akreditimit

11.01.2026
 11.01.2026


EKO STUDIO PROJEKT

NIPT-I L03614803Q - Licencë Profesionale QKL LN-2652-01-2011

Bulevardi Gjergj Fishta, Nr. 48, Tiranë, Albania.

Raport - Testimi

Nr. 20
Prot. 3

Data e marrjes së kampionit: 12/01/2026
Data e analizimit të kampionit: 14/01/2026

Nr. 20
Prot. 3

Subjekti i Monitoruar Komisioni i Prokurimeve Publike

Vendndodhja e Subjektit Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Pallati i Kongreseve, Kati i I, Tirane

Vendodhja e kryerjes së matjes

☒ Ne mjediset e laboratorit

☐ Jashte mjedisve të Laboratorit

Tipi i kampionit

☒ SPS – Kampion letre i ngurte

☐ OS- Tip tjetër Kampioni

Lloji i kampionit

☐ PS- Kampion Letre

☒ CBS – Kampion Kartoni

Kodi i mostres: SPS-CBS-20

Amballazhi i Mostres Karton

Plani i kampionimit

Sasija e Mostres Dosje kartoni

Nr.	Komponentët e matur	Metoda	Të dhënat e matjes	Pasig. e matjes	Njesia
			Pika IV		
1.	Gramatura	ISO 536:2019	304.050	±1.41	g/m ²
2.	Bardhesia	SSH ISO 11475:2017	64.8	±0.5	CIE
3.	pH	SSH ISO 6588-1:2021	8.43	±1.32	

Analizat u kryen nga:

Ing: [Signature]

Aprovuar nga:

Shefi i Laboratorit [Signature]

Ky raport testimi përfshijë kampionin të marrë ose sjellë nga klienti i kontraktuar, nuk lejohet drejta e rikthimit të kampionit në laboratorin e testuesit të Eko-Studio-Projekt. Çdo reklamim i tij behet me shkrim në një periudhë 30 ditësh nga data e dorëzimit të këtij raporti testimi duke marrë parasysh kushtet ambientale në të cilat është kryer testimi dhe kushtet mjedisore.

Pikat ku u kryen matjet dhe kampionimet.

	Përshkrimi	Shënim
Pika III-	Analiza e kartonit u realizua për kampionin me kod SPS-CBS-20-IV i cili përfaqëson dosjen e kartonit me përmasa 36 cm * 24 cm. Nga kampioni u përzgjedh një sipërfaqe e padëmtuar e dosjes e cila u pre në përmasa 15cm * 15 cm.	Prane laboratorit të ESP janë paraqitur disa kampion të tipologjise 3 (tre) kuti kartoni të formateve të ndryshme dhe 1 (një) dosje kartoni nga ku u rregjistrua me: - nr. I kutia për ruajtjen e perhershme me përmasa 40*70*9 cm e perbere nga karton i forte me mes të vazezuar - nr. II kutia për ruajtjen e perhershme me përmasa 40*28*18 cm e perbere nga karton i forte me mes të vazezuar - nr. III kutia për ruajtjen e perhershme me përmasa 40*55*18 cm e perbere nga karton i forte me mes të vazezuar. - nr. IV dosje për ruajtjen e perhershme me përmasa 36*24 cm e perbere nga karton të njetrajtshëm.

**Parametrat e shënuar me * nuk janë pjesë e fushës së Akreditimit

Peshimi u krye me peshoren analitike elektronike KREN e tipit ABT 120-5DM e klasit të I. Kjo peshore është e kalibruar me ane të standardit ISO 45501 dhe në përputhje me rekomandimet e OIML, dhe R76-1 nga Laboratori i Mases së Drejtorisë së Përgjithshme të Meteorologjisë. Marzhi i gabimit të vete aparatit është 0.1 g, gabim i pranueshëm. Kushtet e mjedisit gjatë kryerjes së peshimit janë normale, me temperaturë 21.8 °C, lagështi relative 55.8 % dhe presion atmosferik 14.413 psi.

Mostra e parë e peshuar është e tipit Karton i vazezuar me përmasa: gjatësi 15 cm dhe gjerësi 15cm. Sipërfaqja totale e kartonit së peshuar është 225 cm². Pësja mesatare e kartonit për sipërfaqen e peshuar është 12.98067. Për gjetjen e masës së kartonit të te njëjtit tip për sipërfaqen 1 m² na shërben formula si mëposhtë:

$$\text{masa në m}^2 = \frac{M}{S} \times 10000$$

Ku:

M → është masa e peshuar e letres në g (12.98067 g)
 S → është sipërfaqja e kartonit së peshuar në cm² (225cm²)

Bazuar në formulën e sipër permendur masa e letres është 576.919 g/m².

Mostra e dytë e peshuar është e tipit Karton i vazezuar me përmasa: gjatësi 15 cm dhe gjerësi 15cm. Sipërfaqja totale e kartonit së peshuar është 225 cm². Pësja mesatare e kartonit për sipërfaqen e peshuar është 12.77910. Për gjetjen e masës së kartonit të te njëjtit tip për sipërfaqen 1 m² na shërben formula si mëposhtë:

$$\text{masa në m}^2 = \frac{M}{S} \times 10000$$

Ku:

M → është masa e peshuar e letres në g (12.77910 g)
 S → është sipërfaqja e kartonit së peshuar në cm² (225cm²)

Bazuar në formulën e sipër permendur masa e letres është 567.960 g/m².

Mostra e tretë e peshuar është e tipit Karton i vazezuar me përmasa: gjatësi 15 cm dhe gjerësi 15cm. Sipërfaqja totale e kartonit së peshuar është 225 cm². Pësja mesatare e kartonit për sipërfaqen e peshuar është 12.96590 g. Për gjetjen e masës së kartonit të te njëjtit tip për sipërfaqen 1 m² na shërben formula si mëposhtë:

$$\text{masa në m}^2 = \frac{M}{S} \times 10000$$

Ku:

M → është masa e peshuar e letres në g (12.96590 g)
 S → është sipërfaqja e kartonit së peshuar në cm² (225cm²)

Bazuar në formulën e sipër permendur masa e letres është 576.262 g/m².

Mostra e katërt e peshuar është e tipit Karton me përmasa: gjatësi 15 cm dhe gjerësi 15cm. Sipërfaqja totale e kartonit së peshuar është 225 cm². Pësja mesatare e kartonit për sipërfaqen e peshuar është 6.84112 g. Për gjetjen e masës së kartonit të te njëjtit tip për sipërfaqen 1 m² na shërben formula si mëposhtë:

$$\text{masa ne } m^2 = \frac{M}{S} \times 10000$$

Ku:

M → është masa e peshuar e letres ne g (6.84112 g)
S → është sipërfaqja e kartonit se peshuar ne cm² (225cm²)

Bazuar ne formulen e siper permendur masa e letres eshte 304.050 g/m².

Foto gjate analizimit te kampionit SPS-CBS-20.



❖ Konkluzione dhe perfundime

Nga ana metrologjike, çdo pasaktesi dimensionale kontribuon ne pasigurine e pergjithshme te matjes, sipas parimeve te perkufizuara ne ISO/IEC Guide 98-3 (GUM). Ne rastet kur testimi lidhet me parametra te varur nga permasat gjeometrike te mostres (si p.sh. volumi specifik, dendesia, rezistenca mekanike, perthithja, perqeshmeria termike ose parametra te tjere te normalizuar ndaj sipërfaqes apo vellimit), nje devijim prej ±3 mm mund te sjelle ndryshim te ndjeshem ne vlerat e perlllogaritura, vecanerisht kur permasat nominale te mostres jane te vogla ose kur kerkohet saktesi e larte. Ne testet ku permasat e mostres nuk jane parametra kritike (p.sh. analiza kimike cilesore ose teste qe nuk varen nga gjeometria e mostres), marzhi ±3 mm mund te konsiderohet i paperfillshem, per sa kohe qe mostrat mbeten brenda kufijve te praneshem te standardit te metodës se proves. Per sa eshte shkruar me siper ndikimi i marzhit te gabimit ±3 mm ne rezultatet e testimit nuk mund te pergjithesohet, por duhet te vleresohet rast pas rasti, ne funksion te:

- llojit te testimit dhe standardit te aplikuar,
- ndjeshmerise se parametrave ndaj ndryshimeve dimensionale,
- madhësisë nominale te mostres,
- dhe nivelit te pasigurise se pranueshme per rezultatin perfundimtar.

Laboratori Eko - Studio - Projekt Sh.p.k

Për fiksimin e rezultateve u perdoren, instrumente dhe aparaturat si me posht:

Nº	Materiali/ Produkti/ Matrica të testuar	Emërtimi i provës/ vetia e matur	Teknika e provës (2)	Standardi / Metoda e proves (3)
1.	Ajer ne mjediset e punes (te Jashteme dhe te brendeshme)	Temperatura ne ajer	Metoda sensoriale elektrokimike	SSH EN ISO 7730:2025
2.	Ajer ne mjediset e punes (te Jashteme dhe te brendeshme)	Shpejtesi e Eres ne ajer	Metoda sensoriale elektrokimike	SSH EN ISO 7730:2025
3.	Ajer mjedis i jashtem	Lageshtia	Sensor	SSH EN ISO 7726:2025
4.	Ajer mjedis i jashtem	Presioni atmosferik	Sensor	SSH EN ISO 7726:2025
5.	Ajer mjedis i jashtem	Temperatura e ajrit	Sensor	SSH EN ISO 7726:2025
6.	Leter / Karton	Densiteti	Llogaritje	SSH EN ISO 534:2011
7.	Leter / Karton	Trashesia	Matje	SSH EN ISO 534:2011
8.	Leter / Karton	Volumi specifik	Llogaritje	SSH EN ISO 534:2011
9.	Leter / Karton	Gramatura	Gravimetri	SSH EN ISO 536:2019
10.	Leter / Karton	Bardhesia	D65 Illumination	SSH ISO 11475:2017
11.	Leter / Karton	pH	Potenciometrik	SSH ISO 6588-1:2021
12.	Leter / Karton	Lageshtia	pH-Meter Dixhital	SSH EN ISO 287:2017
13.	Leter / Karton	Opaciteti	Gravimetri	SSH ISO 2471:2008



➤ Sistemi IEQ portabel me multi-matje dhe multi-point.

Sistemi i lëvizshëm modular i përbërë nga dataloggeri M-log për matjen e njëkohshme të:



- Sasi të termo-hidrometrike: temperatura e ajrit, temperatura rrezatuese dhe lagështia relative
- Ventilimi: matja e shpejtësisë së ajrit dhe llogaritja e rrjedhave të ajrit dhe ndryshimit të ajrit
- Llogaritja lokale e indeksit TO

(Temperatura Operative) % e pakënaqur nga temperatura e dyshemesë, flukset e ajrit dhe asimetria rrezatuese

- Llogaritja në PC (pas përpunimit) e indekseve të komoditetit termik PMV-PPD
- Cilësia e ajrit (CO, CO₂, VOC)
- Ndriçim

Prezantimi i Studios qe kreu Monitorimin

Ne funksion e kryerjes se monitorimit te komponenteve mjedisor dhe ekspertizes ne fushen e mjedisit, Eko-Studio-Projekt eshte e regjistruar ne QKR me numer NIPT-i L03614803Q dhe eshte pajisur nga Ministria e Mjedisit nepermjet QKL me Licence Profesionale LN-265701-2011.

Per kryerjen e matjeve laboratorike Eko-Studio-Projekt eshte e pajisur me nje Laborator te Akredituar sipas standartit S SH ISO/IEC 17025:2017 nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit, konform ligjit Nr. 116/2014 "PER AKREDITIMIN E ORGANEVE TE VLERESIMIT TE KONFORMITETIT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE", me certificate Akreditimi me numer Regjistrimi **LT 070 11 02 22**, per akreditimin e Laboratoreve Testues.

Eko-Studio-Projekt eshte certifikuar per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise sipas EN-ISO 9001:2015 me dt. 16.02.2022, me certificate nr. AQS/Q/138422025 per "Ofrim sherbimesh laboratorike per analiza dhe monitorime mjedisore", si dhe per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit sipas EN-ISO 14001:2015 me date 16.02.2022 me certificate nr AQS/A/138422025 per "Asistence per pajisjen me leje/licence mjedisi."

Certifikuar per monitorim mjedisor dhe hartimin e dokumentacionit perkatese per "Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune" sipas ISO 45001:2018 me certificate nr. AQS/S/138442025 date 16.02.2022 per "Kompetence per monitorimin e kushteve te punes dhe konsulence per sigurine dhe shendetin ne pune. Ofrimi i sherbimeve laboratorike per analiza dhe monitorim mjedisor."

Certifikuar per monitorim dhe hartim i dokumentacionit qe adreson riskun perkatese per "Sistemin e Menaxhimit te Riskut" sipas ISO 31000:2018 me certificate nr. AQS/RM/122622024 date 07.05.2024 per "Kompetence per monitorimin e kushteve te punes dhe konsulence per sigurine dhe shendetin ne pune. Ofrim sherbimesh laboratorike per analiza dhe monitorim mjedisor."

Eko-Studio-Projekt eshte i pajisur me Laborator te Akredituar dhe te kompletuar me instrumente e standarteve bashkekohore dhe efikas, kryen monitorimin permanent dhe me kampione te komponenteve te Ujit, te Tokes, te Ajrit (Pluhurit, Gazrave helmues dhe industrial), te Mikroklimes, te Zhurmave, Radioaktivitetit, Eficences se energjise, Lekure, Plastik, Letres dhe Kartonit.

"Eko-Studio-Projekt" Sh.p.k.

II.40. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe informacionit të autoritetit kontraktor ardhur me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, rezulton se në datën 14.07.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.	"Kristalina KH" SHPK	46,336,920	lekë	kualifikuar
2.	"Marketing & Distribution" SHPK	47,041,415	lekë	kualifikuar
3.	"Dynamicx Group" SHPK	47,717,240	lekë	skualifikuar
4.	BOE "Office Paper" SHPK & "Inpress" SHPK	53,595,760	lekë	kualifikuar
5.	"InfoSoft Office" SHPK	59,699,557	lekë	skualifikuar
6.	"Adel Co" SHPK	64,666,170	lekë	skualifikuar
7.	"Albdesign PSP" SHPK	73,640,790	lekë	skualifikuar

II.41. Në datën 14.07.2025, operatori ekonomik "*Kristalina KH*" SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.42. Në datën 22.07.2025, është publikuar Njoftimi i Fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku fitues rezulton operatori ekonomik "*Kristalina KH*" SHPK

II.43. Në datën 31.07.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar me numër elektronik ankimi A/2025/5625 dhe me nr. 2053/2025 protokolli, datë 31.07.2025 e operatorit ekonomik "*Kristalina KH*" SHPK për procedurën e "*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*", me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt "*Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme*", me fond limit 74,439,074 (*shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër*) lekë pa TVSH, ose 748,658.1

(shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin operatorit ekonomik "Marketing & Distribution" SHPK, dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë "Office Paper" SHPK & "Inpress" SHPK, si më poshtë vijon:

Të nderuar anëtare të KSHA dhe KPP-se, AK me datë 14.07.2025 në faqen e APP-se ka publikuar vlerësimet ,më poshtë po ju paraqesim pretendimet tona në lidhje me vlerësimet e BOE "Office Paper" & "Inpress" dhe "Marketing & Distribution" pjesmarrës në këtë procedure të cilët nuk përmbushin kriteret e kualifikimit.

Se pari, ne piken B te pjeses se II te deklaratave te formularit te vetedeklarimit citojme se:

B: DEKLARATA

Për dorëzimin e Ofertave të Pavarura.

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër.

Në vecanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) cmimet;*
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e cmimit;*
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të vecanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në cdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj. Te verifikohet nese ky BOE e ka plotesuar ne menyren e duhur kete pjese pasi perndryshe kemi te bejme me nje deklarim te rreme dhe duhet te merren masa.

Se dyti, duhet te jene dy formular vetedeklarimi per secilin OE dhe ne formularin e vetedeklarimit te "Office Paper" nje nder pikat kryesore te formularit eshte: Operatori ekonomik eshte i regjistruar ne regjistrin tregtar sipas legjislacionit te vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit te posacme ne rastin e nje organizate jofitimpruese, ka ne

fushen e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Mjafton një kërkim i thjeshtë në faqen e QKB dhe shikon që “Office Paper” importon dhe shet gjithçka që nga letra, kozmetika, makinat, tuba ujësjetëse, por nuk ka në objektin e saj importin dhe pordhimin e kutive dhe dosjeve me përmbajtje celuloze, ndaj kështu kemi të bëjmë dhe me një deklarament të rreme.

Po ashtu në formularin e vetedeklarimit kërkohej: “Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Dhe në të tregojmë që OE “Office Paper” ushtron aktivitetin në 3 vende të ndryshme dhe kërkojmë që të verifikohet nëse është dorëzuar vërtetimi i debise për të 3 kontratat dhe në të njëjtin llogjikë të shikohet nëse janë paguar taksat dhe tarifat vendore për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit.

Se treti për BOE “Office Paper” & “Inpress” në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3 kërkohej si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Sipas pikës së mësipërme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e furnizimeve të mëparshme duhet të përfaqësojë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Vlera e fondit limit është 74,439,074 lekë pa TVSH, që do të thotë se operatori duhet të paraqesë dokumentacion për furnizime të realizuara me vlerë minimale prej 29.775.629.6 lekë, një vlerë e cila jemi të bindur që operatori ekonomik Inpress nuk e plotëson i cili është në një marrëveshje bashkëpunimi me operatorin ekonomik Office Paper. Office Paper është një distributor letre dhe kartoni nderkohe që objekti i procedurës së prokurimit është blerje kuti dhe dosje dhe jo shitje kartoni për prodhimin e tyre. Pra duhet parë në detaje që kjo pikë të plotësohet në proporcion me marrëveshjen e tyre të bashkëpunimit. Po ashtu të shikohen dhe kontratat e paraqitura dhe nga OE Inpress dhe Office Paper pasi kemi bindjen që dhe ky OE nuk plotëson kriterin e kontratave të ngjashme.

Se katerti ne piken 2 te DST Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) punonjës. Nder to duhet te kete te punesuar: 2. Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) punonjës, ku përfshihet edhe stafi teknik si më poshtë:

- 1 (një) dizenjues (ose staf teknik ekuivalent) kërkesa për 1 (një) dizenjues është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit kërkesa për 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse kërkesa për 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) Shofer, i cili mund të jenë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) punëtor shpërndarje

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet për plotësimin e këtij kriteri:

- Listëpagesa e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik.

- Kontrata pune të vlefshme, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme.

- Kontratat e shërbimit të vlefshme për të gjithë periudhën kohore të realizimit të kontratës objekt prokurimi, për specialistët 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent; 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse dhe shoferin, në rast se këta punonjës janë me kontratë shërbimi. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme.

- Diplome që vërteton kualifikim profesional për 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent. Ky dokument do të paraqitet për këtë punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur është marrë me kontratë shërbimi. Për punonjësit 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, duhet të paraqiten dokumentat:

- Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional në drejtimin “poligrafi” të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

ose

- librezë punë apo cdo dokument të barazvlefshëm me të, që vërteton eksperiencën e punës jo më pak se dy vite në këtë profesion.

Dokumentat e kërkuara për 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit dhe 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, do të paraqitet për këta punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur janë marrë me kontratë shërbimi.

Shenim: Kriteri nr. 2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Te shikohen kodet e punonjesve ne baze te marreveshjes se bashkepunimit dhe sidomos punonjesit e OE Office Paper, ne jane sipas kerkesave te DST pasi sic ua kemi perseritur eshte nje distributor letre.

Se pesti, në kriteret e vecanta të kualifikimit si dhe ne shtojcen e ndryshuar në pikën 7 kërkohet që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë prokurimit duhet të disponojë, mjetin e mëposhtme: 7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetin e mëposhtme:

Mjete Sasia Gjendja

Mjet për transportin e mallrave 1 (një) pronësi / Me qera / huapërdorje

a) për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontraten perkatese të qerases, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

Shenim: Kriteri nr.7 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kjo eshte nje marreveshje kuader me afat 4 vjecar, ndaj kerkojme qe te verifikohen kontratat e qerases nese jane per nje afat qe arrin te plotesoje afatin e kontrates per te dy operatoret ekonomik.

Se gjashti, ne kriteret e vecanta te kualifikimit ne piken 3 dhe piken 4 kerkohet qe operatoret ekonomike pjesmarres ne kete procedure prokurimi te paraqesin si me poshte:

3. Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe/ose skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi.

Kemi bindjen që keto kritere nuk permbushen nga keta operatore ekonomik BOE “Inpress” dhe “Office Paper”, se pari autorizimi duhet të jete ne emer te dyve dhe te verifikohet nese kompania prodhon karton 620 dhe 330 gr per ruajtje te perhershme dhe se dyti te shikohet nese analizat jane ne emer te dyve dhe a kane bashkengjitur te njejtin karton sic jane ndertuar kutite dhe dosja. Po ashtu te verifikohet nese kartoni i marre per ndertimin e kutive eshte nga e njejta kompani dhe kjo te vertetohet nepermjet zhdoganimeve te kompanise. Te verifikohet dhe nese eshte paraqitur skede teknike per elementet te cilet jane te paakredituar.

Se shtati, ne kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 6 kërkohet që operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të paraqesin certifikata si me poshte:

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

BOE “Office Paper” & “Inpress” nuk i disponojne te gjitha certifikatat e kerkuara në këtë procedurë si dhe certifikatat e paraqitura jane jashte afatit.

Se teti, ne piken 5. Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

-1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm

-1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm

-1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm

-1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm

-1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim. Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes se tenderit, me adresë: Rr “Rreshit Collaku”,Godina Nr.6/337, tiranë (në krah të gjykatës së lartë).

Kemi bindjen dhe mesa na u tha dhe nga perfaqesuesja jone ne momentin e dorezimit te mostrave, qe kutite e paraqitura nga ky BOE nuk plotesojne kushtin e ngjyres se kerkuar ne DST, nuk plotesojne permasat sipas skicave te kerkuara ne DST dhe nuk plotesojne komponentin e gramatures. Ndaj kerkojme analizen e tyre nga nje laborator i akredituar.

Se fundmi, kerkojme verifikimin e marreveshjes se bashkepunimit midis ketyre dy operatoreve ekonomik dhe verifikimin e te gjitha dokumentave qe lindin si pasoje kesaj marreveshjeje, sigurim oferte, formular vetedeklarimi, bilancet e shoqerive dhe cdo gje tjeter qe mund te jete arsye per skualifikim.

Persa i perket OE "Marketing & Distribution" kundershtojme kualifikimin e ketij operatori per arsyet e meposhtme:

Se pari, ne kriteret e vecanta te kualifikimit ne pikën 2.3.1 kerkohet si me poshte: 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne vleren jo me pak se 40% e vleres se fondit limit. Keto furnizime te meparshme, te ngjashme, duhet te vertetohen me dokumentacionin si me poshte:

a. Kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetimin e leshuar nga enti publik per permbushjen me sukses te kontrates dhe/ose faturat tatimore te shitjes te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet te paraqese faturen perkatese tatimore te shitjes te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

Sipas pikës së mësipërme operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme te kryera gjate tre viteve te fundit, ku vlera e furnizimeve te meparshme duhet te perfaqesojë ne vleren jo me pak se 40% e vleres se fondit limit. Vlera e fondit limit eshte 74,439,074 lekë pa TVSH, qe do te thote se operatori duhet te paraqese dokumentacion per furnizime te realizuara me vlerë minimale prej 29.775.629.6 lekë, një vlerë e cila jemi te bindur qe operatori Marketing & Distribution. Po ashtu te shikohen dhe kontratat e paraqitura dhe nga OE Marketing & Distribution pasi kemi bindjen qe dhe ky OE nuk ploteson kriterin e kontratave te ngjashme.

Se dyti, ne piken 2 te DST Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë minimalisht 5 (pesë) punonjës .Nder to duhet te kete te punesuar: 2. Operatori ekonomik per realizimin e objektit te prokurimi duhet te ketë minimalisht 5 (pesë) punonjës, ku perfshihet edhe stafi teknik si me poshte:

- 1 (një) dizenjues (ose staf teknik ekuivalent) kërkesa për 1 (një) dizenjues është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit kërkesa për 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse kërkesa për 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) Shofer, i cili mund të jenë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) punëtor shpërndarje.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet për plotësimin e këtij kriteri:

- listëpagesa e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik.

- Kontrata pune të vlefshme, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme.

- Kontratat e shërbimit të vlefshme për të gjithë periudhën kohore të realizimit të kontratës objekt prokurimi, për specialistët 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent; 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse dhe shoferin, në rast se këta punonjës janë me kontratë shërbimi. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme.

- Diplome që vërteton kualifikim profesional për 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent. Ky dokument do të paraqitet për këtë punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur është marrë me kontratë shërbimi. Për punonjësit 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, duhet të paraqiten dokumentat:

- Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional në drejtimin “poligrafi” të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

ose

- librezë punë apo cdo dokument të barazvlefshëm me të, që vërteton eksperiencën e punës jo më pak se dy vite në këtë profesion.

Dokumentat e kërkuara për 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit dhe 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, do të paraqitet për këta punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur janë marrë me kontratë shërbimi.

Shenim: Kriteri nr. 2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i

päri, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kerkojme verifikimin nga hetimi tatimor të të gjithë punonjesve të deklaruar dhe atyre të punësuar me kontratë shërbimi nëse janë vertet të punësuar pranë OE Marketing & Distribution nepermjet një hetimi të thelluar të hetimit tatimor. Të shikohet kur janë punësuar, me çfarë page dhe nëse rroga e tyre u ka kaluar në banke.

Se treti, në kriteret e vecanta të kualifikimit si dhe në shtojcën e ndryshuar në pikën 7 kërkohet që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë prokurimit duhet të disponojë, mjetin e mëposhtme: 7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetin e mëposhtme:

Mjete Sasia Gjendja.

Mjet për transportin e mallrave 1 (një) pronësi / Me qera / huapërdorje.

a) për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikatën e pronësisë së mjetit.

b) për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikatën e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

Shënim: Kriteri nr.7 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojcë 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kjo është një marrëveshje kuader me afat 4 vjeçar, ndaj kerkojme që të verifikohen kontratat e qerave nëse janë për një afat që arrijnë të plotësojnë afatin e kontratës për të Marketing & Distribution.

Se katërti, në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 3 dhe pikën 4 kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të paraqesin si më poshtë:

3. Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, ëbësite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë

objekt i kësaj procedure prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe/ose skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi.

Kemi bindjen që keto kritere nuk permbushen nga keta operatore ekonomik Marketing & Distribution. Po ashtu të verifikohet nëse kartoni i marre për ndertimin e kutive është nga e njejta kompani dhe kjo të verifikohet nepermjet zhdoganimeve të kompanise. Të verifikohet dhe nëse është paraqitur skedë teknike për elementet të cilat janë të paakredituar.

Se pesti, në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 6 kërkohet që operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të paraqesin certifikata si më poshte:

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

OE Marketing & Distribution nuk i disponon të gjitha certifikatat e kerkuara në këtë procedurë si dhe certifikatat e paraqitura janë jashtë afatit.

Se gjashti, në pikën 5. Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

-1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm

-1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm

-1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm

-1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm

-1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim. Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të gjykatës së lartë).

Kemi bindjen dhe mesa na u tha dhe nga përfaqësuesja jone në momentin e dorëzimit të mostrave, që kutitë e paraqitura nga ky OE nuk plotesojnë kushtin e ngjyres së kerkuar në DST, nuk plotesojnë permasat sipas skicave të kerkuara në DST dhe nuk plotesojnë komponentin e

gramatures dhe pehashit. Ndaj kerkojme analizen e tyre nga nje laborator i akredituar te te gjithë operatoreve ekonomik te kualifikuar.

II.44. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2053/1 prot., datë 01.08.2025, janë publikuar kriteret e kualifikimit për të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga ana e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK dhe bashkimit të operatorëve ekeonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, i cili i kundërshton me anë të ankesës me nr. 2053/2025 prot., datë 31.07.2025.

II.45. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se më datë 04.08.2025 bashkimi i operatorëve ekonomikë të interesuar “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK ka paraqitur formularin e argumentave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me nr. 2053/2 prot, datë 04.08.2025, dhe nr. 2053/3 prot, datë 05.08.2025 sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.46. Me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “ Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2053/4 prot., datë 12.08.2025, ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike si dhe shkresës nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “ Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2052/5 prot., datë 13.08.2025, ardhur nëpërmjetë shërbimit postar autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Kristalina KH” SHPK, ku me vendimin nr. 78/2025, datë 11.08.2025, ka vendosur mospranimin e pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “ Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK”.

II.47. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe informacionit të autoritetit kontraktor ardhur me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, rezulton se në datën 14.07.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.	“Kristalina KH” SHPK	46,336,920	lekë	kualifikuar
----	----------------------	------------	------	-------------

2.	“Marketing & Distribution” SHPK	47,041,415	lekë	kualifikuar
3.	“Dynamicx Group” SHPK	47,717,240	lekë	skualifikuar
4.	BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK	53,595,760	lekë	kualifikuar
5.	“InfoSoft Office” SHPK	59,699,557	lekë	skualifikuar
6.	“Adel Co” SHPK	64,666,170	lekë	skualifikuar
7.	“Albdesign PSP” SHPK	73,640,790	lekë	skualifikuar

II.48. Në datën 14.07.2025, operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.49. Në datën 22.07.2025, është publikuar Njoftimi i Fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku fitues rezulton operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK

II.50. Në datën 31.07.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar me numër elektronik ankimi A/2025/5627 dhe me nr. 2064/2025 protokollin, datë 01.08.2025 e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për procedurën e “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, si më poshtë vijon:

Ne pretendojmë se ofertuesit, OE i kristalina kh dhe i office Paperë janë kualifikuar në mënyrë të padrejtë pasi nuk kanë përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara nga vetë AK në dokumentet standarte të tenderit.

Së pari, në dokumentet standarte të tenderit është kërkuar shtojca 8:

Në lidhje me shtojcën e mësipërme konkretisht “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, A: Deklarata për përmbushjen e Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit” pretendojmë që ofertuesit, OE “Kristalina KH” dhe “Office Paper” nuk kanë mbushur në mënyrë të saktë të gjithë, komplet deklaratën e lartpërmendur duke mospërcaktuar në mënyrë të saktë cdo dokument që do të dorëzohet në përmblyshje të rubrikave të kësaj deklarate si dhe institucionin që do lëshojë dokumentin përkatës. Mosmbushja në mënyrë të saktë e deklaratës së mësipërme nga ana e ofertuesit të lartpërmendur është kusht për skualifikimin e tij nga procedura. Në lidhje me pretendimin tonë bazohemi në vendimin e KPP-së nr 135/2023 datë 23.02.2023 ku në faqen nr. 24 të tij citohet se “Komisioni gjykon se operatori ekonomik nuk e ka plotësuar formularin përmbledhës të vetdeklarimit në pikën ku citon “Operatori ekonomik nuk është në listën e

operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së....”, për të cilën duhet të përcaktonte se adresa e ueb-it është [ëëë.app.gov.al](http://eeë.app.gov.al) dhe Autoriteti ose organi lëshues që është Buletini i Agjensisë së Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP cdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e vecanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithëkoha në funksion të realizimit me sukses të kontratës”.

Për sa më sipër gjykojmë se ofertuesit OE “Kristalina KH” dhe “Office Paper” duhet të skualifikohen dhe oferta e tyre të mos meret parasysh.

Së dyti, në DST është kërkuar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në lidhje me kriterin e lartpërmenduar pretendojmë që ofertuesit, OE “Kristalina KH”, “Office Paper” si dhe “Dynamics Group” nuk kanë arritur të paraqesin vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, ofertuesit e lartpërmendur nuk kanë arritur të paraqesin

faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Nga praktika e pjesëmarrjes nëpër procedura të ndryshme, është konstatuar që OE “Kristalina KH” dhe BOE “Office Paper” SHPK nuk kanë fatura ose kontrata të ngjashme në vlerën 30.000.000 lekë pa tvsh.

Për sa më sipër gjykojmë se ofertuesit OE “Kristalina KH” dhe “Office Paper” duhet të skualifikohen dhe oferta e tyre të mos meret parasysh, ndërsa ofertuesit “Dynamics Group” ti shtohet si arsye skualifikimi edhe mospërbushja e kriterit të lartpërmendur.

Së treti, në DST është kërkuar:

2. Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) punonjës, ku përfshihet edhe stafi teknik si më poshtë:

- 1 (një) dizenjues (ose staf teknik ekuivalent) kërkesa për 1 (një) dizenjues është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit kërkesa për 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse kërkesa për 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

1 (një) shofer, i cili mund të jenë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) punëtor shpërndarje

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet për plotësimin e këtij kriteri:

- listëpagesa e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik.

- Kontrata pune të vlefshme, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme.

- Kontratat e shërbimit të vlefshme për të gjithë periudhën kohore të realizimit të kontratës objekt prokurimi, për specialistët 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent; 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse dhe shoferin, në

rast se këta punonjës janë me kontratë shërbimi. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme.

- Diplome që vërteton kualifikim profesional për 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent. Ky dokument do të paraqitet për këtë punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur është marrë me kontratë shërbimi. Për punonjësit 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, duhet të paraqiten dokumentat:

- Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional në drejtimin “poligrafi” të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

ose

- librezë punë apo cdo dokument të barazvlefshëm me të, që vërteton eksperiencën e punës jo më pak se dy vite në këtë profesion.

Dokumentat e kërkuara për 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit dhe 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, do të paraqitet për këta punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur janë marrë me kontratë shërbimi.

Në lidhje me kriterin e lartpërmenduar pretendojmë që ofertuesit, OE “Kristalina KH”, “Office Paper” si dhe “Dynamics Group” nuk kanë në stafin e tyre punëtorinë e kërkuar. Në procedurat e tjera ku kemi qënë pjesëmarrës/konkurent, ofertuesit e lartpërmendur nuk kanë në stafin e tyre punëtorin që AK ka kërkuar në DST.

Për sa më sipër gjykojmë se ofertuesit OE “Kristalina KH”, “Dynamics Group” dhe Office Paper” duhet të skualifikohen dhe oferta e tyre të mos meret parasysh.

Së katëti, në DST është kërkuar:

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe/ose skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi. 5. Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm*
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm*
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm*
- 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm*
- 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).*

Në lidhje me kriteret e lartpërmendura pretendojmë që ofertuesit, OE “Kristalina KH”, “Office Paper” si dhe “Dynamics Group” nuk kanë arritur të paraqesin ditën e hapjes së procedurës fletëanalizat ose skedat teknike për artikujt përkatës. Ofertuesi “Office Paper” në lidhje me fletëanalizën/skedën teknike të lëndës së parë për kartonin, pretendojmë që kjo skedë teknike/fletëanalizë nuk përmbush të gjithë parametrat e kërkuar.

Gjithashtu në lidhje me mostrat e dorëzuara ditën e hapjes së procedurës, ofertuesit e lartpërmendur nuk kanë paraqitur mostra të cilat plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Sa më sipër kërkojmë që për ofertuesit e lartpërmendur, për cdo moster të paraqitur nga ana e tyre të bëhet ekspertizë të posacme.

Për sa më sipër gjykojmë se ofertuesit OE “Kristalina KH”, “Dynamics Group” dhe “Office Paper” duhet të skualifikohen dhe oferta e tyre të mos meret parasysh.

Veprimet e mësipërme të kryera nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave duke na skualifikuar kompaninë tonë Marketing & Distribution shpk si dhe renditur si ofertues të parë kompaninë e mesiperme pavaresisht këtyre mangësive që ne pretendojmë se egzistojne bie ne kundërshtim me Nenin 2, 3 dhe nenin 92/4 të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 82 të VKM-në nr. 285 date 19.05.2021.

Për të gjitha sa u parashtruan mësipër kërkojmë nga ana Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik të vendosë:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga shoqeria “Marketing & Distribution” shpk.
2. Të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertuesve “Kristalina KH” dhe “Office Paper” dhe kualifikimin në vend të parë të ofertës së dhënë nga ana e kompanisë tonë ne procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – Mallra” zhvilluar në datë 23.06.2025 nga Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, me objekt Blerje materiale kancelarie për drejtorinë dhe QKT me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.
3. Shpalljen e ofertes tonë si ofertë e suksesshme.

II.51. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2064/1 prot., datë 04.08.2025, janë publikuar kriteret e kualifikimit për të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga ana e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, “Dynamicx Group” SHPK si dhe bashkimit të

operatorëve ekeonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, i cili i kundërshton me anë të ankesës me nr. 2064/2025 prot., datë 01.08.2025.

II.52. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se më datë 06.08.2025 bashkimi i operatorëve ekonomikë të interesuar “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK ka paraqitur formularin e argumentave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me nr. 2064/2 prot, datë 06.08.2025, sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.53. Me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “ Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2064/3 prot., datë 12.08.2025, ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike si dhe shkresës nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “ Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2064/4 prot., datë 13.08.2025, ardhur nëpërmjetë shërbimit postar, autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, ku me vendimin nr. 78/2025, datë 11.08.2025, ka vendosur mospranimin e pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “ Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK”.

II.54. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe informacionit të autoritetit kontraktor ardhur me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, rezulton se në datën 14.07.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.	“Kristalina KH” SHPK	46,336,920	lekë	kualifikuar
2.	“Marketing & Distribution” SHPK	47,041,415	lekë	kualifikuar
3.	“Dynamicx Group” SHPK	47,717,240	lekë	skualifikuar
4.	BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK	53,595,760	lekë	kualifikuar
5.	“InfoSoft Office” SHPK	59,699,557	lekë	skualifikuar
6.	“Adel Co” SHPK	64,666,170	lekë	skualifikuar
7.	“Albdesign PSP” SHPK	73,640,790	lekë	skualifikuar

II.55. Në datën 14.07.2025, operatori ekonomik “Adel Co” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.56. Në datën 22.07.2025, është publikuar Njoftimi i Fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku fitues rezulton operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK

II.57. Në datën 08.08.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar me numër elektronik ankimi A/2025/5656 dhe me nr. 2157/2025 protokolli, datë 11.08.2025 e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK për procedurën e “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ankimuesit “Adel Co” SHPK, si dhe kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, si dhe bashkimin e operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, si më poshtë vijon:

Pretendimet për skualifikimin e Adel CO Neni 76 i LPP-se parashikon kriteret e skualifikimit të OE pjesmarres në procedurat e prokurimit: Kriteret detyruese për skualifikim.

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

Ne DST ne Kriteret e Pergjithshme parashikohet nder te tjera se ne formularin e vetedeklarimit OE duhet te deklaroje nese eshte përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe nese eshte në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës sic specifikohet në njoftimin e kontratës. Ne shtojcen 8 te DST parashikohet se: “OE duhet te deklaroje se nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi”.

Me shkresen nr. 1092/23 prot date 21.7.2025, marre ne dorezim nga ana jone me dt 30.7.2025, AK na ka njoftuar se jemi s'kualifikuar per shkak se ne baze te ligjit 162/2020, OE Adel Co, nuk mund te jete perfitues i kontratave publike persa kohe rezulton, ne momentin e vleresimit te procedures, i perjashtuar nga APP”.

Lidhur me kete vendimarrje te AK kundërshtojme procesin e vendimarrjes se ndjekur nga AK ne kundërshtim me LPP-ne lidhur me:

I. Skualifikimi është bërë pa bazë në një vendim të formës së prerë të APP-së, në kundërshtim me Nenin 76/1 dhe 76/3/g të LPP-së. Sipas Neni 76 pika 1 dhe 3/g të Ligjit nr. 162/2020, një OE mund të përjashtohet nga procedurat e prokurimit vetëm nëse ekziston një vendim i formës së prerë i Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), për përjashtim nga e drejta për të përfituar fonde publike. Nga njoftimi i AK-së nuk rezulton që OE “Adel Co” të jetë i përjashtuar me vendim përfundimtar (të formës së prerë) nga APP, sic kërkohet shprehimisht nga ligji. Nëse ekziston një vendim i përkohshëm apo një proces në shqyrtim, ai nuk përbën fakt juridik të qëndrueshëm mbi të cilin mund të mbështetet skualifikimi, për aq kohë sa nuk është bërë i ekzekutueshëm me vendim përfundimtar.

II. AK ka skualifikuar OE-në në mungesë të parashikimeve përkatëse në DST dhe njoftimin e kontratës, në kundërshtim me Nenin 76/5 të LPP-së. Sipas Neni 76 pika 5 dhe praktikës standarde të prokurimit, autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë një operator për një arsye e cila nuk është e parashikuar qartë në dokumentet e tenderit (DST) dhe në njoftimin e kontratës.

Në DST, vecanërisht në shtojcën 8 dhe kriteret e përgjithshme, kërkohet që OE të vetëdeklarojë nëse është subjekt i përjashtimit me vendim të APP-së në fuqi, jo që vetë AK të bëjë interpretim të faktit juridik në mungesë të një vendimi të prerë (pra pas hapjes se ofertave). AK ka tejkaluar kompetencën, duke vendosur vetë për një çështje që i takon vetëm APP-së, nëse duhet të ketë përjashtim të OE-së dhe nëse vendimi është përfundimtar apo jo. LPP ne asnjë dispozite nuk parashikon mjetin e skualifikimit pas hapjes se ofertave. AK duhet të perfundojë procedurën administrative bazuar në faktet dhe rrethanat në datën e dorëzimit të ofertave. Çdo referim në vendimarrje apo instrumente juridik jo përfundimtar pas këtij afati (pra datës së dorëzimit të ofertave) nuk mund të ndryshojë statusin juridik apo faktet juridike për procedurën dhe OE pjesëmarrës në këtë procedurë.

III. Vlerësimi i ofertave duhet të bazohet në gjendjen juridike të OE në momentin e dorëzimit të ofertës dhe jo në ndryshime të mëvonshme jo përfundimtare. Në përputhje me parimin e barazisë së trajtimit të operatorëve ekonomikë, vlerësimi i ofertave duhet të bazohet në dokumentacionin dhe statusin ligjor të OE në momentin e dorëzimit të ofertës, ashtu siç u kërkuar nga DST.

Cdo ndryshim juridik jo përfundimtar i statusit të OE pas datës së dorëzimit të ofertës, nuk mund të përbëjë bazë për skualifikim, për aq kohë sa:

Nuk është pjesë e vetëdeklarimeve të pavarëta nga OE;

Nuk është përmendur si kriter skualifikues në DST apo në njoftimin e kontratës;

Nuk është shoqëruar me vendim përfundimtar të organit kompetent (APP).

Për më tepër, Neni 76 pika 6 i LPP-së i jep të drejtë OE-së që të paraqesë prova të rrethanave zbutëse dhe masa korrigjuese nëse ka ndonjë shkak skualifikues në drejtë që nuk rezulton t'i jetë dhënë ose vlerësuar nga AK.

IV. AK nuk ka respektuar parimet bazë të ligjit për prokurimin publik: transparenca, proporcionaliteti dhe siguria juridike. Parimi i transparencës kërkon që cdo arsye për s'kualifikim të jetë e parashikueshme, e qartë dhe e dokumentuar në DST. Në këtë rast, nuk është përmendur si shkak s'kualifikimi ndonjë "Vendim i mundshëm në shqyrtim nga APP. Parimi i proporcionalitetit dhe sigurisë juridike ndalon marrjen e një mase penalizuese (skualifikimi) ndaj një OE pa një vendim të formës së prerë, cka dëmton seriozisht të drejtën e pjesëmarrjes dhe garës së ndershme.

1. Ligji për Prokurimin Publik (LPP) parashikon qartë se vendimi i APP-së duhet të jetë përfundimtar për të prodhuar pasoja juridike përjashtuese. Neni 76, pika 3/g i Ligjit nr. 162/2020 nuk lejon interpretim të zgjeruar, por kërkon ekzistencën e një vendimi të APP-së që është në fuqi, pra vendim i formës së prerë, në kohën kur bëhet vlerësimi i OE-së. Ligji përdor termin me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi, që nënkupton një vendim të ekzekutueshëm, të formës së prerë. Derisa një vendim administrativ i APP-së nuk është përfundimtar dhe i formës së prerë, ai nuk prodhon efekte përjashtuese në mënyrë të detyrueshme për AK-në. Në të kundërt, AK do të merrte kompetenca që ligji ua ka rezervuar vetëm institucioneve me juridiksion përfundimtar, si APP ose Gjykata.

2. Cdo vendim administrativ është subjekt i shqyrtimit gjyqësor parimi i sigurisë juridike dhe i mbrojtjes së interesave të ligjshme. Në përputhje me nenin 43 të kushtetutës dhe ligjin për Gjykatat Administrative (Ligji nr. 49/2012), cdo vendim administrativ i një organi publik është i apeluarshëm dhe nuk është i ekzekutueshëm përfundimisht deri në ezaurimin e mjeteve juridike (kur parashikohet pezullim ose kur nuk është titull ekzekutiv sipas ligjit të vecantë). Për pasojë, vendimi i APP-së nuk mund të përdoret si bazë për përjashtim ligjor derisa ai të mos marrë formën e prerë, pasi mbi të rëndon prezumimi i pafajësisë administrative, derisa të konfirmohet nga gjykata ose të mos ankimohet.

3. LPP kërkon që skualifikimi për shkelje të ligjeve të tjera të bazohet vetëm në vendime të formës së prerë. Vetë struktura e nenit 76 të LPP-së tregon qartë që cdo s'kualifikim për shkelje ligjore kërkon ekzistencën e një vendimi të formës së prerë, si p.sh. Në: Neni 76/1 kërkohet vendim gjyqësor i formës së prerë për veprat penale; Neni 76/3/c për shkelje të rëndë profesionale kërkohet vendim gjyqësor të formës së prerë; Neni 76/2 për mospagimin e taksave kërkohet vendim administrativ i formës së prerë, përjashtuar rastet e borxheve të vogla. Ky model ligjor i përsëritur në nenin 76 vërteton se një fakt juridik, për të prodhuar efekt përjashtues, duhet të jetë i vërtetuar përfundimisht.

4. Vendimi i APP-së, marrë pas dorëzimit të ofertave dhe gjatë vlerësimit, nuk mund të zbatohet në mënyrë prapavepruese. OE ka dorëzuar ofertën në momentin kur nuk ishte subjekt i ndonjë përjashtimi të ekzekutueshëm, dhe për këtë arsye ka marrë pjesë në mënyrë të ligjshme në procedurën e tenderit. Nëse AK lejohet të aplikojë një vendim të ndërmjetëm administrativ, të nxjerrë pas dorëzimit të ofertës, kjo do të krijonte pasiguri juridike, duke e ekspozuar cdo OE ndaj përjashtimit të mundshëm për arsye të paparashikueshme gjatë procesit të vlerësimit, gjë që cenon seriozisht garën dhe barazinë në trajtim.

5. Parimi i barazisë dhe proporcionalitetit ndalon penalizimin për një situatë jo të faktuar përfundimisht. LPP kërkon që gjendja juridike e operatorit të vlerësohet në mënyrë të njëjtë dhe të drejtë për të gjithë pjesëmarrësit, në kohën e dorëzimit të ofertës. Përderisa vendimi i APP-së nuk është i formës së prerë, penalizimi i OE-së përfaqëson një vlerësim të njëanshëm dhe të nxituar nga ana e AK-së, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, të sanksionuar në nenin 2 të LPP-së dhe në jurisprudencën e gjykatave administrative.

Argumenti kyc: Diskrecioni i AK-së aktivizohet vetëm pas përfundimit të fazës së vlerësimit dhe njoftimit të fituesit në fazën e lidhjes së kontratës.

1. LPP nuk i jep AK-së kompetencë diskreionare për s'kualifikim gjatë vlerësimit, për fakte jo të konsoliduara juridikisht. Neni 76 i LPP-së është shumë i qartë në parashikimet e veta: s'kualifikimi gjatë vlerësimit mund të bëhet vetëm mbi fakte të verifikuara dhe të dokumentuara, me vendime të formës së prerë.

Deri në momentin e njoftimit të fituesit, AK nuk ka diskrecion, por ka vetëm detyrimin për të ndjekur kriteret e kualifikimit dhe përjashtimit të përcaktuara në DST dhe ligj.

2. Vetëm në fazën e lidhjes së kontratës aktivizohet diskrecioni i kufizuar i AK-së për të mos e lidhur kontratën. Sipas LPP-së dhe RRPP-së (neni 83 pika 6), parashikohet ushtrimi i diskrecionit për të mos lidhur kontratën me OE fitues nëse ky i fundit:

Refuzon të lidhë kontratën;

Nuk dorëzon dokumentet e kërkuara pas njoftimit të fituesit (si sigurimi i kontratës, vërtetime të tjera, etj.);

Ose pas shpalljes së fituesit rezulton se ndodhet në kushte që pengojnë lidhjen e kontratës (p.sh. Vendim përfundimtar i APP-së për përjashtim),

Atëherë AK mund të mos lidhë kontratën dhe të vazhdojë me OE-në e radhës.

Kjo është e vetmja fazë kur AK ka diskrecion të kufizuar dhe të ligjshëm, bazuar mbi rrethana të reja të verifikuara pas përfundimit të vlerësimit dhe shpalljes së fituesit.

3. Cdo vendim për të ndërprerë procesin para kësaj faze, pa mbështetje në vendim të formës së prerë, është i paligjshëm.

Nëse AK s'kualifikon një OE vetëm mbi bazën e një vendimi administrativ jo të formës së prerë dhe para shpalljes së fituesit, atëherë:

Cenon garantinë e pjesëmarrjes së ndershme në garë;

Tejkalon kompetencën e vet ligjore;

Përfshihet në arbitraritet administrativ, duke vepruar si gjykatë ose organ kontrollues, gjë që ligji nuk e autorizon.

Ne rast se gjatë procesit të vlerësimit të ofertave gjykata vlerëson pezullimin apo shfuqizimin e vendimit dhe ky vendim i AK i bazuar në një vendim jo përfundimtar prek interesat e drejtëprejste të Adel CO duke cenuar rëndë interesat ligjore dhe ekonomike të tij.

Konkluzione:

Autoriteti Kontraktor nuk mund të s'kualifikojë një operator ekonomik për shkak të një vendimi të APP-së i marrë pas dorëzimit të ofertave dhe që nuk ka marrë formën e prerë, për këto arsye: Ligji për prokurimin publik nuk i njeh AK-së kompetencën për të zbatuar vendime të ndërmjetme të APP-së, për sa kohë ato nuk janë të ekzekutueshme ligjërisht. Skualifikimi, në këto rrethana, nuk është në përputhje me ligjin, me DST-në dhe me parimet e sigurisë juridike. AK nuk ka tagër të gjykojë vlefshmërinë apo forcën ekzekutive të një vendimi administrativ, pasi kjo i takon vetëm gjykatës. Një veprim i tillë cenon të drejtën për pjesëmarrje në mënyrë të barabartë dhe të drejtë në prokurim publik, dhe përbën tejkalim të kompetencave të parashikuara nga LPP.

Në përmbledhje, vendimi i AK për s'kualifikimin e OE "Adel Co":

1. Nuk bazohet në një vendim përfundimtar të APP-së, sic kërkohet shprehimisht nga neni 76/3/g dhe 76/7 i LPP-së.
2. Nuk është në përputhje me DST-në dhe njoftimin e kontratës, ku nuk parashikohet si shkak s'kualifikimi një vendim i papërfunduar ose në shqyrtim nga APP.
3. Përbën tejkalim kompetencash nga ana e AK, në interpretimin dhe aplikimin e një mase që është në juridiksionin e APP-së dhe që kërkon vendimmarrje përfundimtare.
4. Shkel parimet e barazisë në trajtim, transparencës dhe proporcionalitetit, duke s'kualifikuar një OE në kushte të paqarta ligjore dhe jashtë parashikimeve të dokumenteve të tenderit.
5. Në bazë të sa më sipër, kërkohet shfuqizimi i vendimit për s'kualifikimin dhe rivlerësimi i ofertës së OE "Adel Co" në përputhje me ligjin dhe dokumentet e tenderit.

Shoqeria "Adel Co" kundërshton kualifikimin e firmave "Kristalina KH", "Marketing & Distribution" dhe BOE "Office Paper" & "Inpress".

Per firmen Kristalina

1) 1. Ne kriteret e përgjithshme të perzgjedhjes/kualifikimit, pika "a" ku thuhet se ofertuesi deklaron se: është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçme rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; Ne regjistrin tregtar të firmës Kristalina citohet adresa: Tirane Lord Bajroni Laprake dhe në të gjithë dokumentet e kerkuara, NIPT, ISO dhe në të gjitha dokumentet e tjera, kjo firmë duhet të kishte ndryshuar adresën e veprimtarisë pasi firma Kristalina në vitin 2020, objektin ku ushtron aktivitetin e saj e ka dhënë për ndërtim pallati. Shoqeria ndërtuese Belhaus, e cila ka marrë përsipër ndërtimin, ka nisur shitjet e apartamenteve në truallin të cilin ka deklaruar si adrese të veprimtarisë së saj në këtë procedurë prokurimi firma Kristalina KH. Kontrata noteriale për dënimin për ndërtim të truallit është bërë pranë zyres së noterit M. SH. Trualli i deklaruar si vend i ushtrimit të aktivitetit nga shoqeria Kristalina është bllokuar pranë zyrave të Kadastrës në interes të shoqërisë Belhaus me qëllim ndërtimi. Vendi i ushtrimit të aktivitetit të deklaruar nga shoqeria Kristalina KH në këtë procedurë prokurimi është i deklarim i rreme, pasi në adresën Tirane Lord Bajroni Laprake, e deklaruar nga ky i fundit është bërë bllokimi i pasurisë për llogari të

shoqerise ndertuese, per rrjedhoje dhe trualli ne adresen e deklaruar nuk eshte me prone ne disponim te shoqerise Kristalina KH. Kontrata e qirasë, e lidhur ndërmjet bashkëshortëve H per ushtrimin e aktivitetit te shtypshkronjes Kristalina KH, nuk është e regjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme (ASHK), cka do të thotë se ajo ka vetëm efekt obligativ ndërmjet palëve dhe nuk prodhon efekte ndaj palëve të treta, në këtë rast firmës ndërtuese “Belhause” që ka kontratë të regjistruar për zhvillimin e pasurisë mbi objektin dhe token ku ushtron aktivitetin shtypshkronja Kristalina. Pra, ia ka dhene firmes Kristalina per ushtrimin e aktivitetit dhe me pas e ka dhene per ndertim. Te dy palët e përfshira në marrëveshjen e qirasë K dhe H H kanë firmosur bashkërisht kontratën me firmën “Belhaus”, ku shprehin vullnetin e qartë për të vënë pasurinë në dispozicion për ndërtim të ri. Me këtë akt, ata kanë hequr dorë në mënyrë të heshtur nga zbatimi i cdo marrëdhënje të mëparshme që bie ndesh me kontratën e re, ne kete rast te kontrates se qirase me firmen Kristalina. Në kontratën e ndërtimit është përfshirë klauzola ligjore që përcakton se: “Cdo akt ose marrëveshje e lidhur më parë me këtë pasuri nuk ka fuqi ligjore”. Kjo klauzolë është një deklaram i qartë ligjor për heqjen dorë nga cdo kontratë e mëparshme, përfshirë kontratën e qirasë me firmen Kristalina. Duke qenë se ajo është firmosur nga vetë qiramarrësi K. H, kjo përbën një akt vetë-anulimi të marrëdhënies ekzistuese të qirasë. Në lejen e ndërtimit dhe projektin e zhvillimit parashikohet prishja e objektit ekzistues dhe ndërtimi i një objekti të ri. Në këto kushte, bazuar në Kodin Civil, kontrata e qirasë pushon automatikisht, pasi objekti i marrë me qira nuk ekziston më si objekt fizik dhe juridik mbi të cilin të ushtrohet qiraja. Kriteret per kualifikim vendosen nga Autoriteti Kontraktor qe te krijoje bindjen se operatoret ekonomike ofertues të kenë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën. Ne kete rast firma Kristalina nuk ka vend per ushtrimin e aktivitetit pasi vendi i deklaruar nga kjo firme per ushtrimin e aktivitetit, krahas arsyetimit ligjor, eshte e rrethuar nga firma gati per prishje. Persa me siper, ne Formularin Permbledhesi te Vetedeklarimit. Pjesa I: Informacion ne lidhje me Operatorin Ekonomik, percaktohet detyrimi i cdo operatori ekonomik per deklarimin e te dhenave qe lidhen me identifikimin e tij. Referuar ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 3, germa ë) parashikon se “çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit”;

Ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit percaktohet gjithashtu permbushja e detyrimit per:

- Cdo vetedeklarim i pavertete/pasakte nga ana e operatoreve ekonomike jo vetem qe perben shkak per skualifikimin nga procedura konkrete, por perben shkak edhe per perjashtimin e tyre nga e drejta per te fituar kontrata publike deri ne 3 vjet sipas parashikimeve te ligjit per prokurimin publik”.

- Operatoret ekonomike qe ofertojne ne procedurat e prokurimit te vetdeklarojne ne cdo rast informacionin e sakte qe i korrespondon gjendjes se tyre faktike.

- Ne cdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka te drejte ti kryeje verifikimet e nevojshme per vertetisine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik per sa me siper.

Gjithashtu në piken 2 te nenit 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Ne piken A, te Formularit te Vetdeklarimit, Deklarate per permbushjen e Kriterëve te Pergjithshme te Kualifikimit percaktohet detyrimi per te deklaruar adresen e sakte te ushtrimit te aktivitetit konkretisht, “Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit te posacme ne rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktivë. Kontrata e qirasë ndërmjet firmes Kristalina dhe K e H H ka pushuar efektet ligjore si pasojë e lidhjes së një kontrate zhvillimi ndërtimor me firmën “Belhaus” sh.p.k, e cila është e regjistruar në ASHK dhe është firmosur nga të njëjtat palë. Në përmbajtjen e kontratës së ndërtimit është shprehur heqje dorë nga cdo marrëveshje e mëparshme dhe meqenëse objekti do të priset për ndërtim të ri, është objektivisht e pamundur vijimi i kontratës së qirasë. Për rrjedhojë, cdo pretendim për ekzistencën apo vazhdimin e kontratës së qirasë është i pambështetur ligjërisht dhe bie ndesh me aktin të nënshkruar nga vetë palët.

Persa me siper, firma Kristalina nuk disponon ambient ku ushtron aktivitetin sepse kontrata e qirase ka pushuar efektet ligjore, si pasojë e lidhjes së një kontrate zhvillimi ndërtimor me firmën “Belhaus” sh.p.k, e cila është e regjistruar në ASHK, dhe është firmosur nga të njëjtat pale.

Në përmbajtjen e kontratës së ndërtimit është shprehur heqje dorë nga cdo marrëveshje e mëparshme dhe ne cdo moment firma Belhaus qe e ka marre per ndertim truallin ku gjendet shtypshkronja Kristalina kundrejt tagrit qe i jep ligja mund ta nxjerri jashte per fillimin e aktivitetit te ndertimit dhe eshte e pamundur vijimi i kontrates se qirase dhe ushtrimi i aktivitetit.

Si perfundim, firma Kristalina nuk ka nje ambient per ushtrimin e aktivitetit dhe duke iu referuar ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Neni 76, “Kriteret

detyruese për skualifikim”, pika 3, germa ë) parashikon se “cdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;ë kjo firmë ka bere deklarim te rreme te adreses ku ushtron aktivitetin, ne Formularin Permbledhes te Vetdeklarimit dhe duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

2. Ne piken “c” dhe “ç” te Kriterëve te Pergjithshme te Perzgjedhjes/Kualifikimit kerkohet:

Duke qene se firma Kristalina ka marre pjese edhe ne disa procedura te meparshme me te njejtin objekt prokurimi, kjo firme ka mashtruar dhe ka paraqitur makineri jo te sakta per te fituar kontraten. Kjo firme ka bere deklarim te rreme dhe ka mashtruar dhe per kete arsye eshte marre e pandehur me procedim penal Nr. 3325 date 11.10.2024 me vendim nga Prokuroria për veprën penale të “falsifikimi i vulave, i stampave ose i formulareve” si firma Kristalina edhe Administratori i saj K H të parashikuara ne nenin 190 të Kodit Penal.

Per kete arsye firma Kristalina nuk ka mundesi te marre vertetim nga Prokuroria qe nuk eshte ne ndjekje penale. Cdo vertetim i paraqitur prane jush eshte fallco. Kjo firme ka bere deklarim te rreme ne Formularin Permbledhes te Vetdeklarimit dhe per kete arsye kerkojme verifikimin prane Prokurorise se Tiranes te gjendjes penale qe ndodhet firma Kristalina dhe Administratori i saj.

Persa me larte, firma Kristalina ka bere nje deklarim te rreme per gjendjen penale ne Formularin Permbledhes te Vetdeklarimit dhe duhet te perjashtohet nga kjo procedure prokurimi.

Këto vepra penale janë të lidhura drejtpërdrejt me paraqitjen e dokumenteve të falsifikuara në kuadër të ushtrimit të aktivitetit tregtar dhe përfshijnë elemente që përbëjnë rrezik serioz për ligjshmërinë dhe etikën në procedurat e prokurimit publik. Në përputhje me nenin 76 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: Cdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjecare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënua me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij. Falsifikimi i dokumenteve, vulave apo formularëve sidomos në procedura tenderimi përbën:

Cenim të etikës profesionale së kërkuar në përputhje me nenin 77 të ligjit të prokurimit,

Kërcënim real për administrimin korrekt të fondeve publike, dhe

Shkelje të barazisë së pjesëmarrësve, duke i vendosur operatorët në një pozitë të padrejtë konkurrimi.

Autoriteti Kontraktor ka lejuar pjesëmarrjen dhe kualifikimin e këtij operatori në procedurën e prokurimit, duke shkelur detyrimet ligjore për verifikimin e integritetit dhe gjendjes ligjore të pjesëmarrësve.

Sipas Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Autoriteti kontraktor përjashton nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit cdo operator ekonomik që është në ndjekje penale ose ndaj të cilit ka filluar procedimi penal për vepra të tilla si mashtrimi, falsifikimi, korrupsioni, pastrimi i parave, ose vepra të tjera të parashikuara nga Kodi Penal. Përjashtimi zbatohet nga momenti i fillimit të ndjekjes penale deri në përfundimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kjo parashikon që autoriteti kontraktor duhet të përjashtojë operatorin ekonomik që nga momenti kur prokurori ka marrë vendim për fillimin e ndjekjes penale, pa pritur një vendim gjyqësor përfundimtar. Qëllimi i ligjvënësit është të parandalojë përfshirjen në tendera të subjekteve ndaj të cilëve ekzistojnë dyshime të bazuara për vepra penale që cenojnë integritetin e procedurës, sic është mashtrimi dhe falsifikimi. Vetë vendimi i prokurorit përbën fakt të mjaftueshëm për përjashtim.

Persa me sipër, firma Kristalina KH duhet të përjashtohet nga kjo procedure prokurimi.

3) Ne piken 3 të Kapacitetit Teknik është kërkuar:

Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi. Persa me sipër, AK ka kërkuar një Autorizim Prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Duke qene se kemi qene ne nje proces gjyqesor me firmen Kristalina dhe posedojme disa dokumenta si Autorizimi i Prodhuesit, te cilin mendojme se edhe ne kete procedure kjo firme e ka marre nga firma gjermane Schempp. Ju me te drejte keni perjashtuar firma qe Autorizimi i Prodhuesit nuk ka qene i sakte por ju bejme me dije se po te futeni ne faqen e internetit te kesaj firme do te shikoni se kjo firme eshte distributor i materialeve te ndryshme per arkivat, produkt i gatshem dhe per bibliotekat. Ne faqen e tij te internetit gjithashtu kjo firme tregon kuti dhe dosje arkivi ku eshte e shkruar dhe ku e merr kartonin per prodhimin e kutive e te dosjeve.

Firma Kristalina ka paraqitur një autorizim prodhuesi të lëshuar nga kompania gjermane Schempp duke e paraqitur atë si prodhues të kartonit të vëltuar dhe dosjeve arkivore. Pas një analize të kujdesshme dhe verifikimit në faqen zyrtare të kompanisë <https://schempp.de>, rezultoi se:

a) Schempp nuk është prodhues i kartonit si lëndë e parë

Kjo kompani deklaron se përdor materiale të përzgjedhura me cilësi të lartë, me të cilat prodhon kuti dhe dosje arkivore. Në asnjë moment nuk deklaron se ka kapacitete industriale për prodhimin e kartonit (përpunimi i celulozës, fibrave, procesi i vëltimit).

b) Fokusi i kompanisë është përpunimi dhe konservimi, jo prodhimi i lëndës së parë

Schempp ofron shërbime konservimi dhe restaurimi të objekteve arkivore, si dhe përpunon materiale të gatshme në kuti arkive, dosje dhe mbështjellje mbrojtëse. Në kataloget e saj, produkte si schempp box janë të ndërtuara me materiale të gatshme, dhe jo të prodhuara nga vetë kompania si lëndë e parë.

c) Autorizimi i lëshuar është nga një distributor dhe jo nga një prodhues real

Megjithatë Schempp nuk e prodhon vetë kartonin e përdorur në kutitë dhe dosjet arkivore, atëherë autorizimi i prodhuesit të firmës Kristalina nuk e përmbush këtë pikë, sepse firma Schempp është distributor dhe jo prodhues i kartonit të kutive e dosjeve. Në bazë të sa më sipër, kërkojmë që Komisioni të analizojë me kujdes vlefshmërinë e autorizimit të paraqitur nga operatori në fjalë dhe të vendosë për shtetifikimin e tij, për shkak se autorizimi është lëshuar nga një kompani që nuk është prodhues i kartonit, por thjesht distributor i tij. Përsa me sipër firma Kristalina nuk e plotëson pikën 3 të kriterëve të kualifikimit dhe duhet të përjashtohet nga kjo procedurë.

4) Në pikën 4 të ndryshuar është kërkuar:

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe/ose skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi.

a) Duke qenë se firma Kristalina është si edhe në tenderat e mëparshme ka paraqitur një fletë analize për kartonin e kutisë dhe të dosjes nga një laborator që nuk është i akredituar nga organizma kombëtar dhe ndërkombëtar dhe gjithashtu nuk është i akredituar për analizën e parametrave të kërkuar. Cdo analize e bërë nga ky laborator nuk është e saktë. Njëkohësisht edhe parametrat nuk plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara nga ana juaj.

Po te shohesh me kujdes parametrat qe ka dhene i ashtuquajtur laborator nuk perputhen me parametrat e dhena ne specifikimet teknike. Gjithashtu a e ka verifikuar AK se laboratori ku ka bere analizat firma Kristalina eshte i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit.

b) Duke marre shkas nga ky laborator agjenti jone ne Kroaci iu drejtua firmes Schempp per te blere disa kuti ne gramaturen 620 gr dhe nga firma Schempp na u be me dije se kjo kompani nuk disponon dhe nuk ka blere ndonjehere karton 620 gr, por tregtojne kuti kartoni ondulat 570 gr me valem. Prandaj nuk e dime ku e ka marre kartonin qe e ka cuar per analize. Kerkojme te kontrolloji korrespondencen qe ka pasur firma Kristalina me firmen Schempp dhe ku e ka marre kartonin 620 gr (per te gjitha sa thame me larte zyra jone e avokatise eshte duke paraqitur nje material per mashtrim nga ana e firmes Kristalina per perfitim te shumave te medha ne SPAK). Persa me siper kerkojme te verifikohet nese firma Kristalina eshte pajisur ndonjehere me karton 620 gr nga firma Schempp per kryerjen e ketyre analizave dhe a disponon karton 620 gr kjo kompani.

Persa thame me siper, duke qene se kjo firme nuk ploteson piken 4 te Kriteret e Kualifikimit kerkojme perjashtimin e firmes Kristalina nga kjo procedure.

5) Ne piken te 6 te Kriteret e Kualifikimit kerkohet:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Sipas pikes se mesiperme shoqeria Kristalina KH duhet te kete certifikata ISO, por keto certifikata jane leshuar per adresen ne rrugen Lord Bajron, Tirane. Duke u bazuar ne kontraten e qerese qe ka paraqitur Kristalina me znj. H H, sipas se ciles kjo firme ka te drejte qe te ushtroje aktivitetin ne kete ambient deri ne vitin 2025, por kjo kontrate eshte nul sepse znj. H H kete ambient ne 17.12.2020 me notere M Sh ia ka dhene per ndertim shoqerise Belhaus SHPK per te ndertuar pallat, ne kete adrese ku firma Kristalina po ushtron aktivitetin. Ne dokumentet e paraqitura nga firma Kristalina thuhet qe ushtron aktivitetin ne rrugen Lord Bajron, ku ne fakt aty po punohet per te ndertuar pallat. Me te drejte na lind pyetja se ku po e ushtron aktivitetin firma Kristalina KH?

Per kete arsye te gjitha certifikatat ISO jane nul per arsye se kjo adrese nuk figuron me pasi godina ku ushtronte aktivitetin kjo firme eshte prishur dhe nuk e ushtron me aktivitetin ne kete

adrese. Per kete arsye kerkojme verifikimin ne vend te adreses, ISO-ve dhe makinerive te firmes Kristalina.

6) Ne piken 1 te Kapacitetit Teknik eshte kerkuar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Persa i perket pikes se mesiperme oe pjesemarres duhet te plotesojne vleren prej 40% te fondit limit per kontrata te ngjashme te realizuara gjate 3 viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates. Jemi te bindur se firma Kristalina nuk e ploteson kete vlere sepse nuk ka kontrata te ngjashme per kuti dhe dosje gjate 3 viteve te fundit por ka realizuar kontrata vetem per shtypshkrime te ndryshme. Edhe pse kjo firme mund te kete realizuar artikuj kuti dhe dosje qe mund te kene qene pjese e kontratave te shtypshkrimeve por jemi te bindur se nuk e ploteson vleren qe kerkohet ne kete pike.

Persa thame me larte, firma Kristalina nuk e ploteson piken 1 te Kapacitetit Teknik dhe duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

7) Ne piken 5 te Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit kerkohet:

Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm
- 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm
- 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim. Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, tiranë (në krah të gjykatës së lartë).

Sipas pikes me larte, te gjitha firmat ne daten dhe oren e hapjes se procedures do te paraqesin nga nje model per artikujt e mesiperm. Duke qene se firma Schempp nuk ka karton 620 gr dhe duke u bazuar edhe te tenderat e meparshem per arkiven ku firma Kristalina ka marre pjese dhe ne te gjitha testimet e kryera kartoni i kesaj firme nuk ka dale me shume se 570 gr/m2.

Persa me siper kerkojme te behet analiza e kutive dhe te dosjes per gramaturen, ph, dhe kerkojme qe te maten edhe permasat e tre kutive, dosjes dhe etiketave, gjithashtu dhe percaktimin e bojes se kutive dhe dosjes, se firmes Kristalina ne nje laborator te akredituar dhe te njohur nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit. Duke qene se dosja dhe etiketa ka ndryshuar nga modeli i meparshem kerkojme qe te behet verifikimi i specifikimeve te dosjes dhe te etiketes si lloji i shkrimit, hapesirat ndermjet rreshtave, vijezimet etj, ju garantojme se firma Kristalina si dosjen dhe etiketen nuk i ka sipas parametrave te kerkuara ne specifikimet teknike, jemi te bindur se ka dorezuar modelin e meparshem te dosjes dhe te etiketes.

Kerkojme qe te perjashtohet Laboratori Qendror i Restaurimit ne Drejtorine e Pergjithshme te Arkivave, duke qene se jemi ne konflikt interesi sepse mbas lidhjes se kontrates do te jete DPA qe do te beje verifikimin e te gjitha kutive dhe dosjeve, por te behet ne nje laborator tjeter qe eshte i akredituar per gramaturen dhe ph nga DPA.

Si perfundim, kjo firme nuk e ploteson piken e mesiperme per modelet dhe duhet te perjashtohet nga kjo procedure.

Per firmen Marketing & Distribution.

1) Ne piken 1 te Kapacitetit Teknik eshte kerkuar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Marketing & Distribution nuk është shtypshkronje por është kancelari dhe merret me blerjen dhe shitjen e materialeve kancelarike dhe të letres. Jemi të bindur se kjo firmë nuk ka kontratë të ngjashme me objektin e prokurimit, por ka paraqitur kontratë vetëm për leter dhe materiale kancelarike. Edhe nëse kjo firmë mund të ketë ndonjë faturë apo kontratë në përputhje me objektin e prokurimit, ne kemi bindjen që nuk e plotësojnë vlerën prej 40% të fondit limit që kërkohej në këtë tender për kuti dhe dosje. Ju e kemi të qartë se firma Marketing & Distribution nuk është shtypshkronje prandaj edhe kontratat që ajo ka paraqitur janë për leter dhe jo kontratë që ka prodhuar kuti dhe dosje.

Përsa me sipër, Marketing & Distribution nuk e plotësojnë pikën e mesipërme për kontratat e ngjashme dhe duhet të s'kualifikohen nga kjo procedurë.

2) Në pikën 3 të Kapacitetit Teknik është kërkuar:

3. Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, ëbësite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi. Sipas pikës më lartë, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Ne mendojmë se autorizimi i paraqitur nga kjo firmë nuk është i saktë sepse firma që ka leshuar autorizimin nuk është prodhuese e kartonit të kutisë dhe dosjes, por tregton materiale të ndryshme që kanë të bëjnë kryesisht me restaurimin e objekteve arkivore. Duke e njohur shumë mirë tregun e kartonit të përdorur në këtë tender dhe kartonit të vërzuar, gjithashtu njohim edhe firmat që operojnë në prodhimin e këtij kartoni, ne kontrollojmë në faqen e internetit të firmës që ka paraqitur M&D nuk ka në asnjë vend të saj prodhimin e kartonit të vërzuar. Ju më të drejtë kemi s'kualifikuar firmën Dynamicx se nuk ka autorizim prodhuesi por nuk kemi kontrolluar firmën që ka dorëzuar autorizimin M & D. Agjenti jone u lidh me fabrikën që furnizon me leter firmën Marketing & Distribution dhe iu tha që nuk prodhon karton të vërzuar për kuti dhe karton për dosje. Kjo është lehtësisht e verifikueshme në faqen e internetit të kësaj firme. Autorizimin e prodhuesit e ka leshuar vetëm se ia ka kërkuar firma Marketing & Distribution dhe jo sepse është prodhues i këtij kartoni, pra firma që ka leshuar autorizimin e prodhuesit nuk është prodhues por distributor.

Përsa më lartë, kjo firmë nuk e plotëson këtë pikë dhe duhet të s'kualifikohet nga kjo procedurë prokurimi.

3) Në pikën 4 të ndryshuar të kapacitetit teknik është kërkuar:

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të

njohur nga Republika e Shqipërisë dhe/ose skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi.

Sipas pikes se mesiperme OE pjesemarres duhet te paraqesin flete analizen per kartonin e kutise dhe dosjes ose skedat teknike te prodhuesit te kartonit. Ne mendojme se analiza e paraqitur nga firma M & D eshte bere ne nje laborator qe nuk eshte i akredituar per te gjitha parametrat ne specifikimet teknike. Gjithashtu jemi te bindur se parametrat nuk jane sipas specifikimeve teknike.

Persa me siper, kjo firme nuk e ploteson piken e mesiperme dhe duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

4) Ne piken 5 te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit kerkohet:

Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40 x 28 x 18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40 x 55 x 18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40 x 70 x 9) cm
- 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36 x 24) cm
- 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim. Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të gjykatës së lartë).

Sipas pikes me larte, te gjitha firmat ne daten dhe oren e hapjes se procedures do te paraqisnin nga nje model per artikujt e mesiperm. Ne mendojme se Marketing & Distribution nuk i ka modelet sipas specifikimeve teknike. Ne specifikimet teknike eshte e shprehur qarte sesi duhet te jete dosja dhe etiketa si lloji i shkrimit, hapesirat ndermjet rreshtave, vijeziomet etj, ju garantojme se kjo firme si dosjen dhe etiketen nuk i ka sipas parametrave te kerkuara ne specifikimet teknike.

Modelet e paraqitura nga kjo firme nuk e plotesojne kodin e kerkuar ne specifikimet teknike, por modelet ishin nje ngjyre tjetere dhe kartoni ishte me i holle dhe prerja nuk ishte bere sic duhej.

Persa me siper kerkojme te behet analiza e kutive dhe te dosjes per gramaturen, ph, dhe matjen e permasave e tre kutive, dosjes dhe etiketave ne nje laborator te akredituar dhe te njohur nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit. Gjithashtu kerkojme te maten hapesirat nga rreshti ne rresht, vijeziomet, te percaktohet lloji i shkrimit, matja e kornizimit nga border line ne limitin e

etiketes dhe te dosjes, ju garantojme se firma M & D si dosjen dhe etiketen nuk i ka sipas parametrave te kerkuara ne specifikimet teknike.

Gjithashtu te behet verifikimi i ngjyres se kutive dhe te dosjes nese perfshihet ne kodin e percaktuar ne DST. Kerkojme qe te perjashtohet laborator Laboratori Qendror i Restaurimit ne Drejtorine e Pergjithshme te Arkivave, duke qene se jemi ne konflikt interesi sepse mbas lidhjes se kontrates do te jete DPA qe do te beje verifikimin e te gjitha kutive dhe dosjeve, por te behet ne nje laborator tjetër qe eshte i akredituar per leter e karton nga DPA.

Persa me siper kjo firme, nuk e ploteson piken e mesiperme dhe duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

Per Office Paper & Inpress.

1) Ne kriteret e Pergjithshme te Perzgjedhjes/Kualifikimit thuhet: nëse oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Ne procedurat e mëparshme Office Paper eshte futur se bashku me firmen Inpress te ndare ne 70 % me 30%, ku nga informacionet qe ne kemi jane po te njejtat pune. Po te besh nje analize kosto shtypi te dosjeve prerja dhe kartoni zene 10% - 15% te punes ne vlere leku. Ne bashkimin e ketyre dy operatoreve firma Inpress ka vetem shtypin dhe prerjen dhe Office Paper ka sigurimin e letres dhe kartonin, magazinimin dhe shperndarjen. Por dogana ne emer te kujt do behej dhe kush do e paguante doganen per materialin produkt te gatshem qe eshte shume thelbesore. Dogana do te ndahej 70 x 30 apo do te paguhej nga Office Paper. Njekohesisht ne kontraten e bashkepunimit nuk eshte permendur fare etiketa se nga cila firme do te sigurohej adezivi qe duhet per etiketen. Gjithashtu ne kontraten e bashkepunimit nuk eshte e percaktuar qarte se cila firme do te beje shperndarjen e mallit ne institucionet perkatese.

Persa me siper, kontrata e bashkepunimit ka mangesi te theksuara sepse nuk i ka te gjitha elementet qe duhet te realizoje secili prej anetareve te bashkimit dhe BOE Inpress & Office Paper duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

2) Ne piken 1 te Kapacitetit Teknik eshte kerkuar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

BOE në kontratën e bashkëpunimit ka përcaktuar se secili anëtar i bashkimit do të përmbush kushtin e përcaktuar në paragrafin 2 pikë 3 të nenit 88 të VKM Nr. 285. Kur oferta e paraqitur nga një bashkim operatorësh kushti për përmbushjen e kontratave të ngjashme plotësohet nga operatori që ka % me të madhe dhe anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me % e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Nga informacionet që ne kemi firmë Office Paper dhe Inpress nuk e plotësojnë këtë pikë. Office Paper nuk e plotëson 70% të 40% të fondit limit për kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, pra për kuti dhe dosje dhe jo për materiale kancelarie apo shtypshkrime të thjeshta. Te dy këta operatorë nuk kanë paraqitur kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, firma Office Paper është firmë që tregton produkte kancelarie dhe nuk është prodhuese e shtypshkrimeve apo të kutive të ndryshme ndërsa firma Inpress nuk ka kontrata të ngjashme për kuti e dosje por vetëm për shtypshkrime të ndryshme.

Përsa me siper, BOE Office Paper & Inpress nuk e plotësojnë pikën për kontratat e ngjashme dhe duhet të s'kualifikohen nga kjo procedurë.

3) Në pikën 6 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit është kërkuar:

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Nga informacionet që ne kemi në certifikatat ISO të paraqitura në këtë tender nga firma Office Paper nuk është shënuar objekti i prokurimit sepse kjo firmë nuk është certifikuar për kuti dhe dosje arkivore. Pra, kjo firmë certifikatat ISO nuk i ka në përputhje me objektin e prokurimit dhe duhet të përjashtohet nga kjo procedurë prokurimi.

4) Ne piken 3 te Kapacitetit Teknik eshte kerkuar:

3. Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi. Persa i perket pikes me larte ne mendojme se firma Office Paper & Inpress kane paraqitur dokumenta te njejta me tenderat e meparshem dhe shohim se firma XCD por per cudine tone pas hulumtimit te bere ne internet, kjo e zbuluar edhe ne tenderat e meparshem, shohim qe firma CXD nuk eshte prodhuese e ketyre produkteve. Po te shikoni ne faqen ne internet rezulton qe tregton materiale arkivore kryesisht per restaurimin e objekteve arkivore dhe nuk eshte prodhuese per kuti/dosje por eshte distributor i ketyre materialeve. Po te futeni ne faqen e internetit te kesaj firme do te shikoni se kjo firme eshte distributor i materialeve te ndryshme per arkivat dhe jo prodhuese e kartonit si lende e pare.

Persa me larte, kjo firme duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

5) Ne piken 4 te ndryshuar te kapacitetit teknik eshte kerkuar:

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e shqipërisë dhe/ose skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi.

Sipas pikes se mesiperme OE pjesemarres duhet te paraqesin flete analizen per kartonin e kutise dhe dosjes ose skedat teknike te prodhuesit te kartonit. Ne mendojme se analiza e paraqitur nga BOE eshte bere ne nje laborator qe nuk eshte i akredituar per te gjitha parametrat ne specifikimet teknike. Gjithashtu jemi te bindur se parametrat nuk jane sipas specifikimeve teknike. Persa me siper, kjo firme nuk e ploteson piken e mesiperme dhe duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

6) Ne piken 5 te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit kerkohet:

Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm
- 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm

- 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim. Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Rreshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të gjykatës së lartë).

Sipas pikes me larte, te gjitha firmat pjesemarrese ne daten dhe oren e hapjes se procedures do te paraqesin nga nje model per artikujt e mesiperm. Ne mendojme se BOE Office Paper & Inpress nuk i ka modelet sipas specifikimeve teknike. Ne specifikimet teknike jane te shprehura qarte te gjitha parametrat sesi duhet te jete dosja dhe etiketa si lloji i shkrimit, hapesirat, vijeziomet etj, dhe ju garantojme se kjo firme si dosjen dhe etiketen nuk i ka sipas parametrave te kerkuara ne specifikimet teknike. Gjithashtu dhe ngjyra nuk ishte sipas kodit te kerkuar ne DST.

Persa me siper kerkojme te behet analiza e kutive dhe te dosjes per gramaturen, ph, dhe te behet matja e permasave te tre kutive, dosjes dhe etiketave ne nje laborator te akredituar dhe te njohur nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit. Gjithashtu kerkojme te maten hapesirat nga rreshti ne rresht, vijeziomet, te percaktohet lloji i shkrimit, matja e kornizimit nga border line ne limitin e etiketes dhe te dosjes. Te percaktohet ngjyra e modeleve te dorezuara.

Kerkojme qe te perjashtohet laboratori Laboratori Qendror i Restaurimit ne Drejtorine e Pergjithshme te Arkivave, duke qene se jemi ne konflikt interesi sepse mbas lidhjes se kontrates do te jete DPA qe do te beje verifikimin e te gjitha kutive dhe dosjeve, por te behet ne nje laborator tjeter qe eshte i akredituar per leter e karton nga DPA.

Persa me siper kjo firme, nuk e ploteson piken e mesiperme dhe duhet te s'kualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

Kerkojme te behet analiza e gramatures dhe te ph per 4 kampionet e dorezuara, pra 3 kuti dhe 1 dosje te dorezuara nga firma “Kristalina”, firma “Marketing & Distribution” dhe BOE “Office Paper” & “Inpress” ne kete tender ne nje laborator te akredituar per gramaturen dhe ph.

Te behet matja e permasave te tre kutive, te dosjes dhe etiketes dhe gjithashtu te maten hapesirat nga rreshti ne rresht, vijeziomet, te percaktohet lloji i shkrimit, matja e kornizimit nga border line ne limitin e etiketes dhe te dosjes per firmen “Kristalina”, firmen “Marketing & Distribution” dhe BOE “Office Paper” & “Inpress”.

Te behet percaktimi i ngjyres te modeleve nga nje laborator i licensuar per leter dhe karton per firmen “Kristalina”, firmen “Marketing & Distribution” dhe firmen BOE “Office Paper” & “Inpress” praktike kjo e ndjekur edhe me pare nga KPP.

II.58. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2157/1 prot., datë 11.08.2025, janë

publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK, si dhe kriteret e kualifikimit për të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga ana e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK si dhe bashkimit të operatorëve ekeonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, i cili i kundërshton me anë të ankesës me nr. 2157/2025 prot., datë 11.08.2025.

II.59. Me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “ Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2157/2 prot., datë 12.08.2025, ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike si dhe shkresës nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “ Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2157/4 prot., datë 13.08.2025, ardhur nëpërmjetë shërbimit postar, autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, ku me vendimin nr. 78/2025, datë 11.08.2025, ka vendosur mospranimin e pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “ Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK”.

II.60. Me shkresën nr. 114 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Shtesë për ankesën me nr aplikimi A/2025/5656 datë 08.08.2025”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2157/3 prot, datë 13.08.2025 operatori ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK ka paraqitur shtesë ankese për ankimin nr. A/2025/5656, datë 08.08.2025.

II.61. Me shkresën nr. 120 prot, datë 15.08.2025, me objekt “Shkresë për vendimin e KSHA nr. 78/2025 në lidhje me ankesën e shoqërisë “Adel Co” SHPK me nr. aplikimi A/2025/5656”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2157/5 prot, datë 18.08.2025 operatori ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK ka paraqitur argumenta kundër vendimit të KSHA të autoritetit kontraktor.

II.62. Me shkresën nr. 10 prot, datë 22.01.2026, me objekt “Shtesë ankese për ankesën e shoqërisë “Adel Co” shpk me nr aplikimi A/2025/5656 datë 08.08.2025 me objekt Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme me Ref-43560-04-03-2025 zhvilluar nga autoriteti kontraktor Operatori Blerjeve të Përqendruara”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2157/6 prot, datë 26.01.2026 operatori ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK ka paraqitur shtesë ankese për ankimin nr. A/2025/5656, datë 08.08.2025.

II.63. Me shkresën nr. 12 prot, datë 29.01.2026, me objekt “Shtesë ankese për ankesën e shoqërisë “Adel Co” shpk me nr aplikimi A/2025/5656 datë 08.08.2025 me objekt Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme me Ref-43560-04-03-2025 zhvilluar nga autoriteti kontraktor Operatori Blerjeve të Përqendruara”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit

Publik me nr. 2157/7 prot, datë 02.02.2026 operatori ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK ka paraqitur shtesë ankese për ankimin nr. A/2025/5656, datë 08.08.2025.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me pretendimin se: “Operatori Ekonomik s’kualifikohet për arsye se rezulton i përjashtuar në buletinin e faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik. (Buletini Nr. 36 datë 14 Korrik 2025, faqe 5-6) sipas vendimit nr. 51 dt. 11.07.2025 të APP-së”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 04.04.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

III.1.2. Në datën 23.06.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.3. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe informacionit të autoritetit kontraktor ardhur me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, rezulton se në datën 14.07.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.	“Kristalina KH” SHPK	46,336,920	lekë	kualifikuar
2.	“Marketing & Distribution” SHPK	47,041,415	lekë	kualifikuar
3.	“Dynamicx Group” SHPK	47,717,240	lekë	skualifikuar
4.	BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK	53,595,760	lekë	kualifikuar
5.	“InfoSoft Office” SHPK	59,699,557	lekë	skualifikuar
6.	“Adel Co” SHPK	64,666,170	lekë	skualifikuar
7.	“Albdesign PSP” SHPK	73,640,790	lekë	skualifikuar

III.1.4. Në datën 14.07.2025, operatori ekonomik “Adel Co” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

III.1.5. Në datën 22.07.2025, është publikuar Njoftimi i Fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku fitues rezulton operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK

III.1.6. Në datën 08.08.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar me numër elektronik ankimi A/2025/5656 dhe me nr. 2157/2025 protokoli, datë 11.08.2025 e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK për procedurën e “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ankimuesit “Adel Co” SHPK, si dhe kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, si dhe bashkimin e operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, si më sipërcituar.

III.1.7. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2157/1 prot., datë 11.08.2025, janë publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK, si dhe kriteret e kualifikimit për të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga ana e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK si dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, i cili i kundërshton me anë të ankesës me nr. 2157/2025 prot., datë 11.08.2025.

III.1.8. Me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2157/2 prot., datë 12.08.2025, ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike si dhe shkresës nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2157/4 prot., datë 13.08.2025, ardhur nëpërmjetë shërbimit postar, autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, ku me vendimin nr. 78/2025, datë 11.08.2025, ka vendosur mospranimin e pretendimeve të

operatorëve ekonomikë ankimues *“Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK*.

III.1.9. Me shkresën nr. 114 prot, datë 12.08.2025, me objekt *“Shtesë për ankesën me nr aplikimi A/2025/5656 datë 08.08.2025”*, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2157/3 prot, datë 13.08.2025 operatori ekonomik ankimues *“Adel Co” SHPK* ka paraqitur shtesë ankese për ankimin nr. A/2025/5656, datë 08.08.2025.

III.1.10. Me shkresën nr. 120 prot, datë 15.08.2025, me objekt *“Shkresë për vendimin e KSHA nr. 78/2025 në lidhje me ankesën e shoqërisë “Adel Co” SHPK me nr. aplikimi A/2025/5656”*, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2157/5 prot, datë 18.08.2025 operatori ekonomik ankimues *“Adel Co” SHPK* ka paraqitur argumenta kundër vendimit të KSHA të autoritetit kontraktor.

III.1.11. Me shkresën nr. 10 prot, datë 22.01.2026, me objekt *“Shtesë ankese për ankesën e shoqërisë “Adel Co” shpk me nr aplikimi A/2025/5656 datë 08.08.2025 me objekt Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme me Ref-43560-04-03-2025 zhvilluar nga autoriteti kontraktor Operatori Blerjeve të Përqendruara”*, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2157/6 prot, datë 26.01.2026 operatori ekonomik ankimues *“Adel Co” SHPK* ka paraqitur shtesë ankese për ankimin nr. A/2025/5656, datë 08.08.2025.

III.1.12. Me shkresën nr. 12 prot, datë 29.01.2026, me objekt *“Shtesë ankese për ankesën e shoqërisë “Adel Co” shpk me nr aplikimi A/2025/5656 datë 08.08.2025 me objekt Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme me Ref-43560-04-03-2025 zhvilluar nga autoriteti kontraktor Operatori Blerjeve të Përqendruara”*, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2157/7 prot, datë 02.02.2026 operatori ekonomik ankimues *“Adel Co” SHPK* ka paraqitur shtesë ankese për ankimin nr. A/2025/5656, datë 08.08.2025.

III.1.13. Neni 24, pika 1, *“Komisioni i prokurimit Publik”* i ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, ndryshuar, parashikon se: *“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.”*.

III.1.14. Neni 30, pika 1, *“Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik”* i ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, parashikon se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e*

prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.15. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. **Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.**

III.1.16. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”

III.1.17. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”.

III.1.18. Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion

të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. “4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës. 5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni. 6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik”.

III.1.19. Në nenin 115 pika 1, “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.”.

III.1.20. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: “a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;”

III.1.21. Në nenin 97 pika 1 dhe 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se:

“1.Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor: a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.”

III.1.22. Në vlerësim të Vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 të Gjykatës Administrative të Apelit,, **Pika III. Vlerësimi i Gjykatës, 31.** Për kushtin tjetër formal të padisë, respektimin e afatit ligjor.....; “... Praktika gjyqësore e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. (00-2017-927) 670, datë 30.05.2017, konfirmon të njëjtin qëndrim: “... Gjykata Administrative e Shkallës së Parë të Tiranës e ka zbatuar gabim ligjin për përlllogaritjen e afatit të prerë të ankimit administrativ. Në këtë pjesë të çështjes, Kolegji konfirmon plotësisht bazueshmërinë në ligj të qëndrimit të Gjykatës Administrative të Apelit, se... edhe afatet e parashikuara nga neni 63 i Ligji për prokurimin publik duhet të interpretohet sikur rregullojnë të gjithë ligjet procedurale, sikur neni 62 i Kodit të Procedurave Administrative apo neni 148, 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile. **Sipas gjykatës së apelit, afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit...**”, si dhe duke u mbështetur në nenin 97 pika 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar siç është procedura e prokurimit objekt ankimi, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 10 ditë nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të fituesit ose njoftimit të anulimit dhe në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në pikën 5 të aktit rregullator të sipërcituar nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.

III.1.23. Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se njoftimi fituesi i procedurës së prokurimit objekt ankimi është publikuar me datë 22.07.2025. KPP vëren, se me datë 08.08.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/5656, dhe me Nr. 2157/2025 Prot., datë 11.08.2025 e operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, është 10 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në

autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit (22.07.2025), ka qenë data 01.08.2025. Në këtë kuadër, ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik është paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike në datë 08.08.2025, pra jashtë afateve të ankimit, kur ndërkohë duhet të ishte dorëzuar jo më vonë se në datën 01.08.2025, si pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, sjell në vëmendje të ankimesit nenin 111, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *“Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike”*. Në rastin konkret, ankesa e operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110, pika 1 e LPP i cili parashikon, se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*. Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis të nesërmen e publikimit të njoftimit të fituesit 23.07.2025 dhe përfundon në ditën e 10-të. Në rastin konkret e nesërmja e publikimit të njoftimit të fituesit është 23.07.2025 ndërkohë ankesa e paraqitur nga ankimesi në autoritetin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, është data 08.08.2025, jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar racione temporis. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji stricto sensu ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Në rastin konkret vërtetohet, se ankesa është paraqitur pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afateve të parashikuara ligjore të ankimit. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor përmes sistemit të ankesave elektronike jashtë afatit të parashikuar nga neni 97 pika 5 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin parashikohet se: *“5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.”* por edhe nga vlerësimi që Gjykata Administrative e Apelit përmes vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 i ka bërë nisjes së llogaritjes së afatit të ankimit administrativ. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka filluar më datë 23.07.2025 dhe përfundonte më datë

01.08.2025, për sa kohë sipas parashikimeve më sipër dita e publikimit të njoftimit fituesit është (data 22.07.2025). Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e depozituar me datë 08.08.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, konsiderohet e paraqitur jashtë afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit në autoritet kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” sh.p.k, mbi kualifikimin e shoqërisë “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, dhe bashkimin e operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1.23., gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Adel CO” sh.p.k. do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Dynamicx Group” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij me pretendimin se: “OE “Dynamicx Group”, nuk përmbush kriteret e vecanta të kualifikimit, piken 1, pasi nuk arrin të kete realizuar per nje nga vitet 22-23-24 nje vlere sa fondi limit 74,439,074 leke, pasi: • Xhiro e realizuar nga operatori per vitin 22 eshte 23,165,932; • Xhiro e realizuar nga operatori per vitin 23 eshte 22,199,583; • Xhiro e realizuar nga operatori per vitin 24 eshte 23,165,932. Gjithashtu, DT nuk ka kufizuar operatorët ekonomikë ofertues që të mbështeten në kapacitetet e subketeve të tjera ne lidhje me xhiron vjetore. Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë se: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;” Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcaktuar që: “4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Dynamicx Group” Shpk, në rastin konkret kemi një kontratë angazhimi, të nënshkruar midis palëve, për

mbështetjen e shoqërisë “Dynamicx Group” sh.p.k mbi kapacitetet e shoqërisë “Europaper” sha, ku do të angazhohet që të mbështesë shoqërinë “Dynamicx Group” sh.p.k sipas pikës në DST 2.2/1 për Xhiron 22-23-24 Në rastin konkret, duke gjykuar se, operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” si subjekt mbështetës operatorin ekonomik “Europaper” sha, lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.2/1 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, KVO gjykon t’i drejtohet urdhërimeve të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku është përcaktuar qartë se: “4.Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”. Referuar parashikimeve më sipër duhet që operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK, si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera të plotësojë 50% të kërkesës së përcaktuar në pikën 2.2/1 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë ndërkohë ky operator rezulton të jetë mbështetur me shume se 50% te subjekti mbështetës “Europaper” sha i deklaruar si subjekt mbështetës në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit çfarë bie ndesh edhe me parashikimet e dispozitës më sipër. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. KVO gjykon se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo gjykohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve financiare, teknike dhe profesionale si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik është përcaktuar që jo vetëm duhet të deklarohet në dokumentet e ofertës mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera por janë përcaktuar edhe kriteret për këtë mbështetje, njëri prej të cilëve është që në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, dispozitë e cila në rastin konkret me dokumentacionin e paraqitur nuk plotësohet nga “Dynamicx Group” SHPK pasi ky OE është mbështetur mbi 50% te xhiros vjetore 2022-2023-2024 te operatori ekonomik “Europaper” sha, lidhur me Kapacitetin ekonomik dhe financiar pika 2.2/1 e DT. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me

kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KVO thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente dhe kërkesat ligjore duhet të refuzohen si të papranueshme. Per kete arsye, operatori ekonomik skualifikohet.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Deklaratë angazhimi si subjekt mbështetës nga operatori ekonomik “Europaper” SHA;
- Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik “Europaper” SHA;
- Vërtetim Nr. T13183411, datë, 09.05.2025 Vërtetim (Për xhiron e tre viteve të fundit) të operatorit ekonomik “Europaper” SHA;
- Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK;
- Vërtetim Nr. T13270335, datë, 22.05.2025 Vërtetim (Për xhiron e tre viteve të fundit) të operatorit ekonomik “Dynamicx Group” SHPK;

III.3.3. Në neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. P

ër këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.

Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

III.3.6. Neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:
- a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
 - b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;
 - c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.
3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

III.3.7. Neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.
2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:
 - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
 - t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
 - t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.
 - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.3.8. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit “Dynamicx Group” SHPK, KPP vëren se në rastin konkret, ankimuesi ofertues ka deklaruar si subjekt mbështetës operatorin ekonomik “Europaper” SHA, për plotësimin e kriterit 2.2.1 në lidhje me xhiron e tre viteve të fundit. Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri kualifikimi konkretisht për xhiron, ankimuesi, operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK ka ngarkuar në sistem (referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar në KPP me shkresën nr. 1092/32 prot., datë 12.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/5 prot., datë 13.08.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Dynamicx Group” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, “Marketing & Distribution” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress”

SHPK dhe “Adel Co” SHPK dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes (Vendim 78/2025 KSHA), gjithashtu referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik konkretisht vërtetimin Nr. T13270335, datë, 22.05.2025 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës për xhiron e tre viteve të fundit, Formular Përmbledhës së Vetdeklarimit, Deklaratë mbi subjektin mbështetës të operatorit ekonomik “*Europaper*” SHA, shoqëruar me vërtetimin Nr. T13183411, datë, 09.05.2025 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë për xhiron e tre viteve të fundit. Koncretisht, operatori ekonomik “*Dynamicx Group*” SHPK, ka deklaruar subjekt mbështetës operatorin ekonomik “*Europaper*” SHA për përmbushjen e kriterit 2.2.1 financiar, për xhiron e tre viteve të fundit, gjithashtu ka deklaruar Vërtetim Nr. T13270335, datë, 22.05.2025, për xhiron e tre viteve të fundit (2022, 2023, 2024) por vlera e xhiros së deklaruar nga ky operator ekonomik nuk është në masën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor për kriterin financiar të xhiros së tre viteve të fundit, referuar pikës 2 të nenit 90 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar. KPP konstaton se, vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet nga autoriteti kontraktor, është 74,439,074 lekë pa TVSH. Mbështetur në vërtetimet e xhirove të 3 viteve të fundit për subjektin “*Dynamicx Group*” SHPK: 23,165,932 lekë < 74,439,074 (xhiro për vitin 2022); 22,199,583 lekë < 74,439,074 lekë (xhiro për vitin 2023); 18,305,045 lekë < 74,439,074 lekë (xhiro për vitin 2024); Nga sa më sipër përlllogaritur, KPP konstaton se, asnjëra vlerë e secilit vit (2022, 2023, 2024) të deklaruar nga operatori ekonomik “*Dynamicx Group*” SHPK nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor që ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fundit limit të kontratës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik “*Dynamicx Group*” SHPK ka deklaruar subjekt mbështetës operatorin ekonomik “*Europaper*” SHA, në përmbushje të kriterit 2.2.1 Xhiron e tre viteve të fundit. Subjekti Mbështetës “*Europaper*” SHA ka dorëzuar vërtetim xhiro e tre viteve të fundit me Nr. Nr. T13183411, datë, 09.05.2025, ku (xhiro për vitin 2022) = 92,906,668 lekë > 74,439,074; ku (xhiro për vitin 2023) 63,667,358 lekë < 74,439,074 lekë; ku (xhiro për vitin 2024) 62,581,823 lekë < 74,439,074 lekë, Deklaratë e subjektit mbështetës.

Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar është përcaktuar qartë se: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;” Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcaktuar që: “4. Në çdo rast, **operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.**” Në rastin konkret duke gjykuar se operatori ekonomik “*Dynamicx Group*” SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, “*Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik*” si subjekt mbështetës operatorin ekonomik “*Europaper*” SHA, lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, KPP gjykon t’i drejtohet urdhërimeve të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar ku është përcaktuar qartë se: “**4.Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve**

të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.” Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri kualifikimi, operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK ka ngarkuar në sistem vërtetimet Vërtetim Nr. Nr. T13183411, datë, 09.05.2025, për xhiron e tre viteve të fundit për operatorin ekonomik “Europaper” SHA si dhe Vërtetim Nr. T13270335, datë, 22.05.2025 për xhiron e tre viteve të fundit për operatorin ekonomik “Dynamicx Group” SHPK. Vlera e xhiros së deklaruar nga operatori ekonomik “Europaper” SHA për tre vitet e fundit e përmbush kriterin e sipërcituar ndërsa vlera e xhiros së operatorit ekonomik “Dynamicx Group” SHPK si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera nuk provon se plotëson 50% të kërkesës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar. KPP konstaton se, vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet nga autoriteti kontraktor, është 74,439,074 lekë. Referuar parashikimit të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285, datë 19.01.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit pubik” i ndryshuar duhet që “Dynamicx Group” SHPK si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera të plotësojë 50% të kërkesës më sipër pra kemi $74,439,074 * 50\% = 37,219,537$ lekë. Mbështetur në vërtetimet e xhirove të 3 viteve të fundit për operatorin ekonomik “Dynamicx Group” SHPK kemi:

37,219,537 lekë > 23,165,932 lekë (xhiro për vitin 2022);

37,219,537 lekë > 22,199,583 lekë (xhiro për vitin 2023);

37,219,537 lekë > 18,305,045 lekë (xhiro për vitin 2024);

Nga sa më sipër përlllogaritur, KPP konstaton se, asnjëra vlerë e secilit vit (2022, 2023, 2024) të deklaruar nga operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera i cili duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor për pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar. Në këtë kuadër, referuar të dhënave të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK si subjekt që mbështetet në kapacitetin e operatorit ekonomik “Europaper” SHA si edhe kërkesave për kualifikim, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.1, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK në këtë procedurë prokurimi nuk është në përputhje me kriteret për kualifikim, pasi asnjëra vlerë e secilit vit (2022, 2023, 2024) të deklaruar nga ai si subjekt që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera ku duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor të përcaktuar në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pavarësisht se operatori ekonomik “Europaper” SHA si subjekt mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “Dynamicx Group”

SHPK e përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, ky kriter do të koniderohet i papërmbushur nga ofruesi “*Dynamicx Group*” SHPK si subjekt që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera në këtë procedurë prokurimi sipas arsyetimit më sipër të KPP.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Dynamicx Group*” SHPK, nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “*Dynamicx Group*” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit mësipër në pikën III.3.8., gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Dynamicx Group*” sh.p.k, mbi kualifikimin e shoqërisë “*Kristalina KH*” SHPK, “*Marketing & Distribution*” SHPK, dhe bashkimin e operatorëve ekonomikë “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.3.8, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “*Dynamicx Group*” sh.p.k. do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin.

III.6. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “*Së Pari, Operatori ekonomik “Marketinga & Distribution”, ka paraqitur një ofertë ekonomike tërësisht dhe anomalisht të ulët. Fondi limit i përcaktuar në DST për këtë procedurë prokurimi është 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketinga & Distribution” është në vlerën e 47,041,415 (dyzet e shtatë milion e dyzet e një mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH. Thënë ndryshe kjo ofertë është më shumë se 37% (tridhjetë e shtatë përqind) më e ulët se vlera e fondit limit. Duke qenë se, në këtë procedurë prokuruese janë paraqitur vetëm 3 (tre) oferta ekonomike të vlefshme nga operatorë ekonomikë pjesëmarrës, si dhe duke pasur bindjen se oferta ekonomike e paraqitur nga OE Kristalina KH shpk është e pavlefshme, dhe si rrjedhojë do të duhet të skualifikohet,....rrjedhimisht, në zbatim të në zbatim të nenit 93, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; dhe nenit 82, pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke iu referuar procedurës prokuruese të lartpërmendur, kjo ofertë do të duhej të konsiderohej i) anomalisht e ulët, dhe si rrjedhojë të konsiderohej ii) e papranueshme nga KVO e AK. Më poshtë ju parashtrojmë në mënyrë të detajuar se ky operator ekonomik, bazuar në cmimet për njësi të ofertuara, dhe vlerës totale të ofertuar nuk arrin të realizojë pjesën dërrmuese të artikujve/mallrave të kërkuara nga*

DST për këtë procedurë të prokurimit publik. Në nenin 93, pika 1 dhe 2, të LPP që përcakton se: 1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. 2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93, pika 1, të LPP, bazuar në sasi të dhe specifikimet teknike të mallrave, nisur edhe nga eksperiencia dhe ekspertiza e padiskutueshme e stafit teknik të specializuar të BOE Office Paper shpk dhe Inpress shpk., të cilat janë ndër shoqëritë tregtare më të mëdha, që operojnë në tregun shqiptar për prodhimin dhe tregtimin e materialeve të arkivës, do të donim t'ju theksonim se OE "Marketing & Distribution" shpk e ka të pamundur teknikisht të furnizojë autoritetin kontraktor me mallrat e kërkuara (sipas specifikimeve, cilësisë dhe sasive të përcaktuara në DST) në vlerën e ofertuar prej tij, dhe rrjedhimisht e ka të pamundur të realizojë me sukses kontratën e prokuruar, për arsye të mëposhtme: Fillimisht do të donim t'ju informonim se OE Marketing & Distribution shpk nuk është prodhues i mallrave të kërkuara në DST. Ky operator ekonomik është tregtues i tyre, nëpërmjet importimit të mallrave të gatshëm përfundimtarë. Rrjedhimisht, kostot për furnizimin e këtyre mallrave është më i lartë në raport me operatorët ekonomikë pjesëmarrës të cilët përpunimin / prodhimin përfundimtarë të tyre e realizojnë vetë në shqipëri. Bazuar në elementët teknikë të lartpërmendur, bazuar gjithashtu në sasi të dhe specifikimet teknike të mallrave të kërkuara në DST, nga përlllogaritja e bërë nga stafi teknik i specializuar i BOE Office Paper shpk dhe Inpress shpk., vetëm KOSTO e importimit të këtyre mallrave është më e lartë se vetë oferta ekonomike e paraqitur nga OE "Marketing & Distribution" shpk., e cila është në vlerën e 47,041,415 lekë pa TVSH. Nuk kuptohet se si ky OE do të mund të realizojë këtë kontratë prokurore, dhe pa e rrezikuar atë, ku vetëm Kosto e Importimit është më e lartë se Oferta Ekonomike e paraqitur...???. Sic mund të vërehet lehtësisht, produktet / mallrat e kërkuara nga DST, nuk mund të prodhohen / realizohen nga OE "Marketing & Distribution" shpk., duke marrë për bazë vetëm koston e importimit të tyre. Këtu do të donim të theksonim gjithashtu, që në këtë analizë, nuk është marrë parasysh asnjë marzh fitimi (pra marzhi i fitimit është konsideruar "0"). Rrjedhimisht, OE "Marketing & Distribution" shpk., NUK jep asnjë garanci teorike, praktikë / teknike dhe ligjore, që do të mund të realizojë me sukses furnizimin me mallrat e kërkuara në procedurën prokurore, objekt ankese. Përsa mësipër, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore të lartpërmendura KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik "Marketing & Distribution" shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik" Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në nenin 2 "Qëllimi i ligjit" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.6.2. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.6.3. Në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”.

III.6.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “.....**Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme**.....Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$

$PR = 85 \% MO$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”.

III.6.5. Referuar pretendimeve në ankesën e paraqitur nga ankimuesi, informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën nr. 1092/32 prot., datë 12.08.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2052/4 prot., datë 13.08.2025, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara

sh.a, kanë ofertuar 7 (shtatë) operatorë ekonomikë nga të cilët 3 (tre) prej tyre rezultojnë se përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme në respektim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Mbi bazën e këtij kualifikimi Komisioni ka aplikuar formulën për ofertën/ofertat anomalisht të ulët/ulta mbështetur në përcaktimet ligjore të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe DST. Në rastin në fjalë janë të vlefshme 3 (tre) oferta (përfshirë këtu ofertën e shoqërisë “Marketing & Distribution” SHPK për të cilën ankimuesi pretendon se është ofertë anomalisht të ultë) dhe në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nga përlogaritjet e kryera nga KPP, konstatohet, se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK në vlerën prej 47.041.415 lekë pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, nuk rezulton anomalisht e ulët, pasi vlera e saj është më e madhe se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme (41.642.660 lekë) pra ofertave të 3 (tre) ofertuesve të kualifikuar të cilët **përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme** në respektim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK nuk qëndron qëndron, pasi në këtë procedurë prokurimi, e cila referuar fondit limit të përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe përcaktimeve të Kreut II “Kufijtë Monetar në Sektorin Klasik” pika 1 të VKM-së nr. 291, datë 15.05.2024 “Për Përcaktimin e Kufijve Monetarë në Procedurat e Prokurimit Publik” kjo procedurë prokurimi është nën kufirin e lartë monetar, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të bëra në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), në datën 14.07.2025 janë kualifikuar ofertat e 3 (tre) operatorëve ekonomikë, ku referuar përcaktimeve të nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4, të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, oferta ekonomike e operatorit ekonomik ofertuesë të kualifikuar “Marketing & Distribution” SHPK nuk rezulton anomalisht e ulët dhe si rrjedhim nuk është në kushtet e përcaktimeve të nenit 93 pika 5 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ndaj nuk mund të skualifikohet.

Për sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “[...]Së Pesti, Ne kemi bindjen, që OE Marketing & Distribution KH shpk., në kundërshtim me pikën 2.3.5 kapacitetet teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, nuk ka paraqitur mostrat në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Në pikën 2.3.5 kapaciteti teknikë, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST përcaktohet se: “Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të

procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6. - 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm; -1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm; -1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm; - 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm; - 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së). Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim. Në shtojcën 6, “Specifikimet teknike”, të dst përcaktohet se: “Formulari i specifikimeve teknike” Specifikimet teknike - vendim nr. 7, datë 9.9.2024 “Për miratimin e standardeve të kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre – shtojca 1 standardet e kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre. Në lidhje me këtë kriter kualifikues, ne kemi bindjen që mostrat e paraqitura nga OE Marketing & Distribution shpk., NUK janë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara dhe të kërkuara në shtojcën 8 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit - kapaciteti teknik, pika 2.3.5, të DST. Testimin e të gjitha mostrave të dorëzuara nga OE Marketing & Distribution shpk. Nga Labororë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpueshmërisë së mostrave të paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5, të DST, pasi kemi bindjen që mostrat e paraqitur nga ky operator ekonomik nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 7, të DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm
- 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm
- 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim.

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

III.7.2. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Specifikimet teknike vendim nr. 7, datë 9.9.2024 “Për miratimin e standardeve të kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre”.
Shtojca 1 Standardet e kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre

Lloji	Përmasat	Specifikimet teknike
Kuti për ruajtje të përhershme	40x28x18	<u>Kutia:</u> - Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramaturë së paku 615 g/m ² që të lejojë valëzueshmërinë, duke mos cenuar përmasat e kutisë.
Kuti për ruajtje të përhershme për amza	40x55x18	- Faqet anësore të jenë me dy shtresa kartoni (fortësi të dyfishtë), ndërsa faqet e tjera me një shtresë kartoni. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5.
Kuti për ruajtje të përhershme për regjistra	40x70x9	- Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin. - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar).
Dosje për ruajtje të përhershme	36x24	- Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. - Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c - Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm. <u>Dosja:</u> - Kartoni të jetë së paku me gramaturë 325 gr/m ² , duke mos cenuar përmasat e dosjes, me 2 krahë të brendashkruar të palosur, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. - Ngjyra e dosjes duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kutisë. - Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm

III.7.3. Nga verifikimet e kryera për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, ka dorëzuar mostrat si më poshtë:

- kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm)
- kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
- kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
- dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).

III.7.4. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020, “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.7.5. Në nenin 40, pika 6, germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës,

me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.7.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.7.7. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit konkretisht pikës 2.3.5 të kapacitetit teknik rezulton, se është kërkuar shprehimisht, që në datën dhe orën e zhvillimit të tenderit, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin artikull objekt - prokurimi sipas specifikimeve teknike (shtojca 6); - kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - etiketa me format 15 x 10 cm. Mostrat do të paraqiten pranë AK, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave me adresë: Rruga “Jordan Misja” 8303, Tiranë. **Mosparaqitja e mostrave në datën dhe orën e hapjes së ofertave përbën shkak për skualifikim.**

III.7.8. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 2577/3 prot, datë 24.09.2025, rezulton se operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor mostrat - kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).

III.7.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionit dhe mostrave të dorëzuara nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 2577/3 prot, datë 24.09.2025 me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të ankimuesit bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, KPP gjykoi të

domosdoshme kryerjen e testimit të mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK, me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të mostrave të dorëzuara. Pavarësisht se ky veprim procedural është kryer nga ana e autoritetit kontraktor vërtetuar kjo me shkresën nr. 2577/3 prot, datë 24.09.2025, si rrjedhojë e ankesës nr. 2052/2025 prot, datë 31.07.2025, të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK, ku Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me Vendimin nr. 78/2025 ka vendosur mospranimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK, me arsyetimin se nga analizat e mostrave janë konfirmon me parametrat e kërkuara në DST.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor, me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të ankimuesit, KPP gjykoi të domosdoshme kryerjen e testimit të mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK, me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të mostrave të dorëzuara. Në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2049/8 prot., datë 16.10.2025, me objekt: “*Kërkesë për informacion*”, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit me shkresën nr. 463/1 prot., datë 20.10.2025 informon KPP-në se: “[...]Në lidhje me testet e pH, barshësisë/ngjyrës, dhe gramaturës DPA ka akredituar 2 laboratorë testues si më poshtë: 1- Laboratorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave LT 129, për pH dhe gramaturën, por jo për bardhësinë/ngjyrën. 2- Laboratorin Eko-Studio Projekt SHPK LT 070 për pH, gramaturën dhe bardhësinë/ngjyrën”. Në këto kushte Komisioni Prokurimit me shkresën nr. 2049/10 prot., datë 04.11.2022 iu drejtua laboratorit testues “*Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave*” SHPK, duke i kërkuar informacion “*nëse Subjekti juaj mund të kryej analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet pH dhe gramaturë ?*. Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifat e analizave për secilin komponentë të sipërcituar”. Me shkresën nr. 11844/1 prot., datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/12, datë 11.11.2023 me objekt “*Kthim-përgjigje kërkesës për informacionnr. 2049/10 prot, datë 04.11.2025*”, laboratorit testues “*Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave*”, informon se “*Në lidhje me çfarë parashtroni në shkresën tuaj, për të kryer analizat e materialeve kuti dhe dosje për analizat pH dhe gramaturë, ju informojmë se, ne si institucion e ofrojmë shërbimin e matjes së pH dhe gramaturës për letër/karton. Gjithashtu, për sa i përketë tarifës së analizave për pH është 1,500 (një mijë e pesëqindë) lekë, për gramaturën është 1,500 një mijë e pesëqindë) lekë. Afati i përgjigjes për secilën analizë është 4 (katër) ditë pune*”. Me shkresën nr. 2049/11 prot., datë 04.11.2022, Komisioni iu drejtua laboratorit testues “*Eko-Studio-Projekt*” SHPK, duke i kërkuar informacion “*nëse Subjekti juaj mund të kryej analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet pH, bardhësi/ngjyrë, dhe gramaturë ?*. Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifat e analizave për secilin komponentë të sipërcituar” . Me shkresën nr. 1061 prot., datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/13, datë 11.11.2025 me objekt “*Kthim-përgjigje shkresës me nr. 2049/11 prot, datë 04.11.2025*”, laboratorit testues “*Eko-Studio-Projekt*” SHPK, informon se: “*Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 2049/11 prot., datë 04.11.2025, me lëndë “Kërkesë për Informacion”, drejtuar pranë zyrës sonë, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Eko-Studio-Projekt ShPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikas dhe kryhet testime pëmanente te kapineve të ujit, tokës, ajrit,*

mikroklimes, zhurmave, radioaktivitetit, letrës dhe kartonit. Oferta ekonomike është si më poshtë vijon:

Nr.	Shërbim	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSh	Vlera pa TVSH
1	Analiza gramaturës	Copë	4	6600	26400
2	Analiza e Bardhësisë	Copë	4	5500	22000
3	Analiza e pH	Copë	4	7400	29600

Me shkresën nr. 2049/15 prot., datë 11.12.2025 me objekt “Kërkesë për Informacioni” Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit duke i kërkuar informacion si vijon: “1- A është i akredituar laborator i privat ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing nga institucioni juaj për kryerjen e analizave për komponentët e mëposhtëm: - Gramaturë; - pH; - Rezervë alkaline; - Lignin; - Ngjyrën e kutisë. - Matjen e përmasave të kutive dhe dosjeve për arkiv”. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit me shkresën 547/1 prot., datë 15.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/16, datë 18.12.2025, informon se “Në përgjigje të shkresës suaj, Nr. 2049/15, datë 11.12.2025, drejtuar DPA për kërkesë informacionin lidhje me fushën e akreditimit të laboratorit testues ECCAT SHPK, ju informojmë se ky laborator është akredituar së fundmi më datë 09.10.2025, për analizat e mëposhtme në matricat letër/karton: - Gramaturë; - pH; - ngjyra/bardhësia. Laboratori ECCAT nuk është i akredituar për kryerjen e testeve të Rezervës alkaliane, Lignit dhe matjes së përmasave të kutive dhe dosjeve për arkivë në matricat letër/karton. Për këto teste, ashtu sic jeni informuar edhe më parë, nëpërmjet shkresës nr. 463/1 prot, datë 20.10.2025 DPA nuk ka akredituar asnjë laborator testues, të vendit apo të huaj që ti kryejë ato. Përveç dhënies së këtij informacioni, DPA ndjen detyrimin dhe përgjegjësinë të sqarojë se në kërkesën për informacion të drejtuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, në shkresën e sipërpërmendur (nr. 463/1 prot, datë 20.10.2025), është dhënë pa dashje një informacion jo i përditësuar duke përjashtuar nga lista e laboratorëve që kryejnë testet e kërkuara në shkresë, laboratorin ECCAT SHPK i cili në atë periudhë sapo i është zgjeruar fusha e akreditimit për një pjesë të testeve të përmendura shkresë. Kjo ka ndodhur si rezultat i një gabimi njerëzor për shkak të cështjeve teknike dhe ngarkesës së lartë të punës gjatë periudhës përkatëse. Duke ju kërkuar ndjesë për krijimin e kësaj situate, jemi të gatshëm që të ridërgojmë cdo informacion tjetër që i nevojitet Institucionit tuaj në lidhje me verifikimet e fushave të akreditimit të subjekteve të akredituara që ju merrni në shqyrtim”. Komisioni me shkresën nr. 2049/17 prot., datë 22.12.2025 me objekt “Kërkesë për Informacion” ju drejtua laboratorit testues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK duke i kërkuar informacion si vijon “nëse Subjekti juaj mund të kryej analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet Gramaturë, pH, ngjyrë/bardhësi, dhe Matje të përmasave të kutive dhe dosjeve për arkivën ?. Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifat e analizave për secilin komponent të sipërcituar”. Laboratori testues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, me shkresën nr. 364 prot., datë 24.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/18, datë 29.12.2025 me objekt “Kthim-përgjigje”, informon se “Shoqëria ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing është e akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) me Numër Akreditimi LT 128, për kryerjen e analizave laboratorike për materialet letër/karton/pulpë, sipas parametrave dhe metodave të mëposhtme: -Trashësia; -

Vëllimi specifik; - Densiteti; - Gramatura; - pH; - Përcaktimi i bardhësisë. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se oferta jonë për analizimin e parametrave të kërkuar nga ana juaj është bashkangjitur kësaj shkrese, sipas kërkesës suaj.

Nr.	Testi/Parametri	Çmimi ALL pa TVSH/Parametër	Numri i mostrave	Cmimi total ALL pa TVSH
1	Gramatura	6200	4	24800
2	pH	6900	4	27600
3	Ngjyra/Bardhësia	4800	4	19200
Cmimi total ALL pa TVSH				71.600
Cmimi total ALL me TVSH				85.920

Në datën 04.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 1798/2025, për kryerjen e ekspertizës së analizimit të komponentëve 1- Gramaturë; 2- pH; 3- Bardhësi/ngjyrë për operatorët ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK dhe “Kristalina – KH” për mostrat - kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), nga laborator i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostrat e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Në datën 11.12.2023, ora 12:15, në prani të përfaqësuesve të shoqërisë “Marketing & Distribution” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, të autoritetit kontraktor, dhe të Komisionit të Prokurimit Publik, në ambientet e KPP-së u mbajt seancë dëgjimore me regjistrim audio të seancës. Në këtë seancë përfaqësuesja e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK pasi u pyet për mostrat e nëse ka pretendime për to, u pohua se nuk ka asnjë pretendim dhe se mostrat janë të tyre, gjithashtu përfaqësuesja e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK shprehu dakortësin për analizimin e mostrave në laboratorin “Eko Studio Projekt”, dhe përfaqësuesit e autoritetit kontraktor nuk patën pretendime dhe kërkesa paraprake, ndërsa përfaqësuesi i operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, nuk pati edhe ai pretendime për mostrat e dorëzuara pohoi se janë mostrat e tij, por në seancë pati një kërkesë paraprake, kërkesë të cilën e ka dërguar edhe me rrugë postare, ku konteston laboratorin e përzgjedhur nga ana e Komisionit Prokurimit Publik për kryerjen e analizimit të mostrave, i cili nuk ishte dakort që mostrat e tij të analizoheshin nga laborator i “Eko Studio Projekt” me pretendimin se ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me këtë laborator. Në lidhje me këtë kërkesë paraprake Komisioni gjykon të merret në konsideratë dhe do të kryejë verifikimet edhe njëherë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në lidhje me laboratorët e akredituar. Në përfundim kërkesa e operatorit ekonomik ekonomik “Kristalina KH” SHPK lidhet me rishimin e vendimit në lidhje me veprimet proceduriale të testimit të mostrave. Në përfundim të saj kjo seancë dëgjimore deklarohet e mbyllur.

Në datën 08.12.2025, përmes shkresës nr. 90 prot, datë 08.12.2025 protokolluar me tonën me nr. 2052/8 prot., datë 09.12.2025 është paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH”

SHPK kërkesa me lëndë “Kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 1798/2025, datë 04.12.2025”. Nëpërmjetë së cilës ngren pretendime që mostrat e dorzuara prej tij të mos analizohen nga laborator i Eko Studio Projekt pasi ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, por të përzgjidhet një laborator tjetër. Si rrejdhojë e pretendimeve të operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik në datën 06.01.2026, mori vendimin nr. 19/2026, për kryerjen e ekspertizës së analizimit të komponentëve 1- Gramaturë; 2- pH; 3- Bardhësi/ngjyrë për opërorin ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për mostrat - kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), nga laborator i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, dhe për opërorin ekonomik “Kristalina KH” SHPK për mostrat - kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), nga laborator i akredituar i shoqërisë “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, nëse mostrat e paraqitura janë në përputhje me specififikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Në datën 12.01.2024, në prezencë të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, Komisioni procedoi me dorëzimin e mostrave në laboratorin testues “Eko – Studio – Projekt” SHPK, po më datë 12.01.2024, në prezencë të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, Komisioni procedoi me dorëzimin e mostrave në laboratorin testues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK.

Me shkresën nr. 42 prot., datë 19.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 2052/15, datë 21.01.2026, me objekt “Kthim-përgjigje shkresës me Nr. 2052/12 Prot, datë 06.01.2026”, laborator i testues “Eko-Studio-Projekt” SHPK, ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik Raport - Testimin në zbatim të vendimit nr. 19/2026, datë 06.01.2026, ndër të tjera me përmbajtje edhe si vijon:

Eko-Studio-Projekt
Eko - Studio - Projekt Sh.p.k.
NIFIT-11036148030 - Lëvizje Profesionale OKEL EN-2682-01-2011
Referencë Gjyqësive, Nr. 48 Tiranë

Nr. 42 Prot. Tiranë, më 19 / 01 / 2026

Lënda: Kthim Përgjigje shkresës me Nr.2052/12 Prot., datë 06.01.2026

Drejtuar: Komisionit të Prokurimit Publik
Adresa: Biv. "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Kati I, Tiranë.

Në përgjigje të shkresës Suaj me Nr. 2052/12 Prot., datë 06.01.2026, me lëndë "Dërgim Testimi nr. 19/2025", drejtuar pranë zyrës sonë, ju bëjmë me dije si vijon:

Pranë laboratorit "Eko - Studio-Projekt" sh.p.k. janë paraqitur, me datë 12.01.2026, disa kampionë të tipologjisë kuti kartoni në formate të ndryshme, si dhe dosje kartoni, për të cilët janë kryer analiza laboratorike për përcaktimin e parametrevë të gramaturës, pH-së dhe bardhësisë, për secilin kampion përkatës. Bashkëlidhur këtyre shkresë gjoni raportin e testimit, i cili përmban rezultatet e matjeve për parametrat e sipërcituar.

Gjithashtu, në përgjigje të pikës 3 të Vendimit nr. 19/2025, të regjistruar me Nr. 2052/11 Prot., datë 06.01.2026, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Nga pikëpamja metrologjike, çdo pasaktësi dimensionale kontribuon në pasigurinë e përgjithshme të matjes, në përputhje me parimet e përcaktuara në ISO/IEC Guide 98-3 (GUM). Në rastet kur testimi lidhet me parametra që varen nga përmasat gjeometrike të mostrës (si p.sh. vëllimi specifik, dendësia, rezistenca mekanike, përthithja, përqeshmëria termike apo parametra të tjera të normalizuara ndaj sipërfaqes ose vëllimit), një devijim prej ± 3 mm mund të sjellë ndryshime të ndjeshme në vlerat e përllogaritura, veçanërisht kur përmasat nominale të mostrës janë të vogla ose kur kërkohet një nivel i lartë saktësie. Në testet ku përmasat e mostrës nuk përbëjnë parametra kritike (p.sh. analiza kimike cilësore ose teste që nuk varen nga gjeometria e mostrës), marzhi ± 3 mm mund të konsiderohet i papërfllshëm, për sa kohë që mostrat mbeten brenda kufijve të pranueshëm të përcaktuar nga standardi i metodës së provës. Për rrjedhojë, ndikimi i marzhit të gabimit ± 3 mm në rezultatet e testimit nuk mund të përgjithësohet, por duhet të vlerësohet rast pas rasti, në varësi të:

- llojit të testimit dhe standardit të aplikuar;
- ndjeshmërisë së parametrevë ndaj ndryshimeve dimensionale;
- madhësisë nominale të mostrës;
- nivelit të pasigurisë së pranueshme për rezultatit përfundimtar.

Duke ju fjalenderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të marjes në konsiderim të shkresës tonë.

Per Eko - Studio - Projekt Sh.p.k.

Nr. 20 Prot.

Tiranë, më 19/01/2026

Raport Testimi

Për institucionin:

"Komisioni i Prokurimeve Publike"

Adresa:

Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Pallati i Kongreseve, Kati i I, Tirane.

Te dhenat e kontaktit:

Perfaqesuesi i komisionit te KPP: Ergys Streza

Adrese e-mail : kpp_info@kpp.gov.al

Nr. Kontakti: +355 4 2281 851

Monitorues:

"Eko-Studio-Projekt" sh.p.k. me laborator testues te Akredituar nga DPA sipas standartit S SH ISO/IEC 17025:2017, me Nr. LT 070 per kryerjen e analizave te komponenteve mjedisor. Eshte certifikuar per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise sipas EN-ISO 9001:2015, per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit sipas EN-ISO 14001:2015, per monitorim mjedisor dhe hartim i dokumentacionit perkates dhe per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune sipas ISO 45001:2018.

Pergatiti Raportin :

Shtepi "Eko-Studio-Projekt" Sh.p.k. regjistruar me NIPT: L03614803Q dhe me Licensë Profesionale LN-2652-01-2011.

Administrator

"Eko-Studio-Projekt" Sh.p.k.

EKO STUDIO PROJEKT					
NIPT-i L03614803Q - Licencë Profesionale QKL LN-2652-01-2011 Bulevardi Gjergj Fishta, Nr. 48, Tiranë, Albania.					
Raport - Testimi			Nr. <u>20</u>		
Data e marrjes se kampionit		<u>12/01/2026</u>		Data e analizimit te kampionit <u>19/01/2026</u>	
Nr. <u>20</u> Prot.		Data <u>19/01/2026</u>			
Subjekti i Monitoruar		Komisioni i Prokurimeve Publike			
Vendndodhja e Subjektit		Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Pallati i Kongreseve, Kati i I, Tirane			
Vendodhja e kryerjes se matjes	☒	Ne mjediset e laboratorit	☐	Jashte mjedisve te Laboratorit	
Tipi i kampionit	☒	SPS - Kampion letre i ngurte	☐	OS- Tip tjetër Kampioni	
Lloji i kampionit	☐	PS- Kampion Letre	☒	CBS - Kampion Kartoni	
	☐	PPS - Kampion Pulpe Letre			
Kodi i mostres:	SPS-CBS-20		Plani i kampionimit	-	
Amballazhi i Mostres	Karton		Sasija e Mostres	Kuti kartoni	
Nr.	Komponentët e matur	Metoda	Të dhënat e matjes	Pasig. e matjes	Njesia
1.	Gramatura	ISO 536:2019	576.919	± 1.41	g/m ²
2.	Bardhesia	SSH ISO 11475:2017	67.8	± 0.5	CIE
3.	pH	SSH ISO 6588-1:2021	8.31	± 0.32	
Analizat u kryen nga:			Aprovuar nga:		
Ing:			Shefi i Laboratorit		
Ky raport testimi kryhet nga kampionit te marre ose sjelle nga klienti i kontraktuar, nuk lejohet e premtja e riprodhimit te tij pa dijenine e laboratorit testues te Eko-Studio-Projekt. Çdo reklamim i tij behet me shkrim ne nje periudhe jo me shume se 5 dite nga data e dorezimit te këtij raporti testimi duke marre parasysh kushtet ambientale ne te cilat eshte kryer testimi (lagështi, presion, temp etj.)					
Pikat ku u kryen matjet dhe kampionimet.					
Përshkrimi		Shënimi			
Pika I-	Analiza e kartonit u realizua per kampionin me kod SPS-CBS-20-I i cili i perket kutise se kartonit me permasa 40 cm * 70 cm * 9 cm. Nga kampioni u perzgjodh nje sipërfaqe e padëmtuar e kutise e cila u pre ne permasa 15cm * 15 cm.		Prane laboratorit te ESP jane paraqitur disa kampion te tipologjise 3 (tre) kuti kartoni te formateve te ndryshme dhe 1 (nje) dosje kartoni nga ku u rregjistrua me: 1. nr. I kutia per ruajtjen e perhershme me permasa 40*70*9 cm e perbere nga karton i forte me mes te vazezuar 2. nr. II kutia per ruajtjen e perhershme me permasa 40*28*18 cm e perbere nga karton i forte me mes te vazezuar 3. nr. III kutia per ruajtjen e perhershme me permasa 40*55*18 cm e perbere nga karton i forte me mes te vazezuar. 4. nr. IV dosje per ruajtjen e perhershme me permasa 36*24 cm e perbere nga karton te njetrajtshem.		

**Parametrat e shënuar me * kane pjese te fushes se Akreditimit

 EKO STUDIO PROJEKT					
NIPT-i L03614803Q - Licencë Profesionale QKI LN-2652-01-2011					
Bulevardi Gjegj Fishta, Nr. 48, Tiranë, Albania.					
Raport - Testimi			Nr. 20/1		
Data e marrjes se kampionit		12/01/2026		Data e analizimit te kampionit	
Nr. 20		Prot.		Data 18/01/2026	
Subjekti i Monitoruar		Komisioni i Prokurimeve Publike			
Vendndodhja e Subjektit		Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Pallati i Kongreseve, Kati i I, Tirane			
Vendndodhja e kryerjes se matjes		☒ Ne mjediset e laboratorit		☐ Jashte mjedisese te Laboratorit	
Tipi i kampionit		☒ SPS - Kampion letre i ngurte		☐ OS- Tip tjetër Kampioni	
Lloji i kampionit		☐ PS- Kampion Letre		☒ CBS - Kampion Kartoni	
Lloji i kampionit		☐ PPS - Kampion Pulpe Letre			
Kodi i mostres:		SPS-CBS-20		Plani i kampionimit	
Amballazhi i Mostres		Karton		Sasija e Mostres	
				Kuti kartoni	
Nr.	Komponentët e matur	Metoda	Të dhënat e matjes	Pasig. e matjes	Njesia
1.	Gramatura	ISO 536:2019	Pika II 567.960	± 1.41	g/m ²
2.	Bardhesia	SSH ISO 11475:2017	68.5	± 0.5	CIE
3.	pH	SSH ISO 6588-1:2021	8.26	± 1.32	

Analizat u kryen nga:		Aprovuar nga:	
Ing:		Shefi i Laboratorit	
Ky raport testimi i kampionit te marre ose sjelle nga klienti i kontraktuar, nuk lejohet e drejta e riprodhimit shprehur se tij pa detyrime e laboratorit testues te Eko-Studio-Projekt. Çdo reklamim i tij behet me shkrim ne nje periudhe jo me shume se 5 dite nga data e dorezimit te ketij raportit testimi duke marre parasysh kushtet ambientale ne te cilat eshte kryer testimi (lageshti, prestion, temp etj.)			
Pikat ku u kryen matjet dhe kampionimet.			
Përshkrimi		Shënim	
Analiza e kartonit u realizua per kampionin me kod SPS-CBS-20-II i cili i perket kutise se kartonit me permasa 40 cm * 28 cm * 18 cm. Nga kampioni u perzgjodh nje sipërfaqe e pademtuar e kutise e cila u pre ne permasa 15cm * 15 cm.		Prane laboratorit te ESP jane paraqitur disa kampion te tipologjise 3 (tre) kuti kartoni te formateve te ndryshme dhe 1(nje) dosje kartoni nga ku u rregjistrua me: 1. nr. I kutia per ruajtjen e perhershme me permasa 40*70*9 cm e perbere nga karton i forte me mes te vazezuar 2. nr. II kutia per ruajtjen e perhershme me permasa 40*28*18 cm e perbere nga karton i forte me mes te vazezuar 3. nr. III kutia per ruajtjen e perhershme me permasa 40*55*18 cm e perbere nga karton i forte me mes te vazezuar 4. nr. IV dosje per ruajtjen e perhershme me permasa 36*24 cm e perbere nga karton te njetratjshem.	

**Parametrat e shënuar me * nuk jane pjese e fushes se Akreditimit

 EKO STUDIO PROJEKT					
NIPT-i L03614803Q - Licencë Profesionale QKI LN-2652-01-2011					
Bulevardi Gjegj Fishta, Nr. 48, Tiranë, Albania.					
Raport - Testimi			Nr. 20/2		
Data e marrjes se kampionit		12/01/2026		Data e analizimit te kampionit	
Nr. 20		Prot.		Data 18/01/2026	
Subjekti i Monitoruar		Komisioni i Prokurimeve Publike			
Vendndodhja e Subjektit		Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Pallati i Kongreseve, Kati i I, Tirane			
Vendndodhja e kryerjes se matjes		☒ Ne mjediset e laboratorit		☐ Jashte mjedisese te Laboratorit	
Tipi i kampionit		☒ SPS - Kampion letre i ngurte		☐ OS- Tip tjetër Kampioni	
Lloji i kampionit		☐ PS- Kampion Letre		☒ CBS - Kampion Kartoni	
Lloji i kampionit		☐ PPS - Kampion Pulpe Letre			
Kodi i mostres:		SPS-CBS-20		Plani i kampionimit	
Amballazhi i Mostres		Karton		Sasija e Mostres	
				Kuti kartoni	
Nr.	Komponentët e matur	Metoda	Të dhënat e matjes	Pasig. e matjes	Njesia
1.	Gramatura	ISO 536:2019	Pika III 576.262	± 1.41	g/m ²
2.	Bardhesia	SSH ISO 11475:2017	66.7	± 0.5	CIE
3.	pH	SSH ISO 6588-1:2021	8.25	± 1.32	

Analizat u kryen nga:		Aprovuar nga:	
Ing:		Shefi i Laboratorit	
Ky raport testimi i kampionit te marre ose sjelle nga klienti i kontraktuar, nuk lejohet e drejta e riprodhimit shprehur se tij pa detyrime e laboratorit testues te Eko-Studio-Projekt. Çdo reklamim i tij behet me shkrim ne nje periudhe jo me shume se 5 dite nga data e dorezimit te ketij raportit testimi duke marre parasysh kushtet ambientale ne te cilat eshte kryer testimi (lageshti, prestion, temp etj.)			
Pikat ku u kryen matjet dhe kampionimet.			
Përshkrimi		Shënim	
Analiza e kartonit u realizua per kampionin me kod SPS-CBS-20-III i cili i perket kutise se kartonit me permasa 40 cm * 55 cm * 18 cm. Nga kampioni u perzgjodh nje sipërfaqe e pademtuar e kutise e cila u pre ne permasa 15cm * 15 cm.		Prane laboratorit te ESP jane paraqitur disa kampion te tipologjise 3 (tre) kuti kartoni te formateve te ndryshme dhe 1(nje) dosje kartoni nga ku u rregjistrua me: 1. nr. I kutia per ruajtjen e perhershme me permasa 40*70*9 cm e perbere nga karton i forte me mes te vazezuar 2. nr. II kutia per ruajtjen e perhershme me permasa 40*28*18 cm e perbere nga karton i forte me mes te vazezuar 3. nr. III kutia per ruajtjen e perhershme me permasa 40*55*18 cm e perbere nga karton i forte me mes te vazezuar 4. nr. IV dosje per ruajtjen e perhershme me permasa 36*24 cm e perbere nga karton te njetratjshem.	

**Parametrat e shënuar me * nuk jane pjese e fushes se Akreditimit

11.01.2026
 11.01.2026


EKO STUDIO PROJEKT


NIPT-I L03614803Q - Licencë Profesionale QKL LN-2652-01-2011
 Bulevardi Gjegj Fisha, Nr. 48, Tiranë, Albania.

Raport - Testimi

Nr. 20/3

Data e marrjes së kampionit	12/01/2026	Data e analizimit të kampionit	14/01/2026
Nr. 20 Prot.		Data 19/01/2026	
Subjekti i Monitoruar		Komisioni i Prokurimeve Publike	
Vendndodhja e Subjektit		Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Pallati i Kongreseve, Kati i I, Tirane	
Vendndodhja e kryerjes së matjes	☒ Ne mjediset e laboratorit	☐ Jashtë mjedisëve të Laboratorit	
Tipi i kampionit	☒ SPS – Kampion letre i ngurte	☐ OS- Tip tjetër Kampioni	
Lloji i kampionit	☐ PS- Kampion Letre	☒ CBS – Kampion Kartoni	
	☐ PPS – Kampion Pulpe Letre		
Kodi i mostres:	SPS-CBS-20	Plani i kampionimit	-
Amballazhi i Mostres	Karton	Sasija e Mostres	Dosje kartoni

Nr.	Komponentët e matur	Metoda	Të dhënat e matjes	Pasig. e matjes	Njesia
1.	Gramatura	ISO 536:2019	Pika IV 304.050	±1.41	g/m ²
2.	Bardhesia	SSH ISO 11475:2017	64.8	±0.5	CIE
3.	pH	SSH ISO 6588-1:2021	8.43	±1.32	

Analizat u kryen nga:	Aprovuar nga:
Ing: 	Shefi i Laboratorit 

Ky raport testimi i peshës së kampionit të marrë ose sjellë nga klienti i kontraktuar, nuk lejohet të drejtohet në publik dhe të përdoret për qëllime tjera pa detyrueshëm e laboratorit testues të Eko-Studio-Projekt. Çdo reklamim i tij behet me shkrim në një periudhë 30 ditësh nga data e dorëzimit të këtij raporti testimi duke marrë parasysh kushtet ambientale në të cilat është kryer testimi dhe kushtet mjedisore të punës.

Pikat ku u kryen matjet dhe kampionimet.	
Përshkrimi	Shënim
Pika III- Analiza e kartonit u realizua për kampionin me kod SPS-CBS-20-IV i cili i përket dosjes së kartonit me përmasa 36 cm * 24 cm. Nga kampioni u përzgjodh një sipërfaqe e padëmtuar e dosjes e cila u pre në përmasa 15cm * 15 cm.	Prane laboratorit të ESP janë paraqitur disa kampion të tipologjisë 3 (tre) kuti kartoni të formave të ndryshme dhe 1 (një) dosje kartoni nga ku u rregjistrua me: 1. nr. I kutia për ruajtjen e perhershme me përmasa 40*70*9 cm e perbere nga karton i forte me mes të vëzhguar 2. nr. II kutia për ruajtjen e perhershme me përmasa 40*28*18 cm e perbere nga karton i forte me mes të vëzhguar 3. nr. III kutia për ruajtjen e perhershme me përmasa 40*55*18 cm e perbere nga karton i forte me mes të vëzhguar 4. nr. IV dosje për ruajtjen e perhershme me përmasa 36*24 cm e perbere nga karton të njëtrajtshëm.

** Parametrat e shënuar me * nuk janë pjesë e fushës së Akreditimit

Peshimi u krye me peshoren analitike elektronike KREN e tipit ABT 120-SDM e klasit të I. Kjo peshore është e kalibruar me ane të standardit ISO 45501 dhe në përputhje me rekomandimet e OIML, dhe R76-1 nga Laboratori i Mases së Drejtorisë së Përgjithshme të Meteorologjisë. Marzhi i gabimit të vete aparatit është 0.1 g, gabim i pranueshëm. Kushtet e mjedisit gjatë kryerjes së peshimit janë normale, me temperaturë 21.8 °C, lagështi relative 55.8 % dhe presion atmosferik 14.413 psi.

Mostra e parë e peshuar është e tipit Karton i vëzhguar me përmasa: gjatësi 15 cm dhe gjerësi 15cm. Sipërfaqja totale e kartonit së peshuar është 225 cm². Pësja mesatare e kartonit për sipërfaqen e peshuar është 12.98067. Për gjetjen e masës së kartonit të te njëjtit tip për sipërfaqen 1 m² na shërben formula si mëposhtje:

$$\text{masa në m}^2 = \frac{M}{S} \times 10000$$

Ku:

M → është masa e peshuar e letres në g (12.98067 g)
 S → është sipërfaqja e kartonit së peshuar në cm² (225cm²)

Bazuar në formulën e sipër permendur masa e letres është 576.919 g/m².

Mostra e dytë e peshuar është e tipit Karton i vëzhguar me përmasa: gjatësi 15 cm dhe gjerësi 15cm. Sipërfaqja totale e kartonit së peshuar është 225 cm². Pësja mesatare e kartonit për sipërfaqen e peshuar është 12.77910. Për gjetjen e masës së kartonit të te njëjtit tip për sipërfaqen 1 m² na shërben formula si mëposhtje:

$$\text{masa në m}^2 = \frac{M}{S} \times 10000$$

Ku:

M → është masa e peshuar e letres në g (12.77910 g)
 S → është sipërfaqja e kartonit së peshuar në cm² (225cm²)

Bazuar në formulën e sipër permendur masa e letres është 567.960 g/m².

Mostra e tretë e peshuar është e tipit Karton i vëzhguar me përmasa: gjatësi 15 cm dhe gjerësi 15cm. Sipërfaqja totale e kartonit së peshuar është 225 cm². Pësja mesatare e kartonit për sipërfaqen e peshuar është 12.96590 g. Për gjetjen e masës së kartonit të te njëjtit tip për sipërfaqen 1 m² na shërben formula si mëposhtje:

$$\text{masa në m}^2 = \frac{M}{S} \times 10000$$

Ku:

M → është masa e peshuar e letres në g (12.96590 g)
 S → është sipërfaqja e kartonit së peshuar në cm² (225cm²)

Bazuar në formulën e sipër permendur masa e letres është 576.262 g/m².

Mostra e katërt e peshuar është e tipit Karton me përmasa: gjatësi 15 cm dhe gjerësi 15cm. Sipërfaqja totale e kartonit së peshuar është 225 cm². Pësja mesatare e kartonit për sipërfaqen e peshuar është 6.84112 g. Për gjetjen e masës së kartonit të te njëjtit tip për sipërfaqen 1 m² na shërben formula si mëposhtje:

$$\text{masa ne } m^2 = \frac{M}{S} \times 10000$$

Ku:

M → është masa e peshuar e letres ne g (6.84112 g)
S → është sipërfaqja e kartonit se peshuar ne cm² (225cm²)

Bazuar ne formulen e sipër permendur masa e letres është 304.050 g/m².

Foto gjate analizimit te kampionit SPS-CBS-20.



❖ Konkluzione dhe perfundime

Nga ana metrologjike, çdo pasaktesi dimensionale kontribuon ne pasigurine e pergjithshme te matjes, sipas parimeve te perkufizuara ne ISO/IEC Guide 98-3 (GUM). Ne rastet kur testimi lidhet me parametra te varur nga permasat gjeometrike te mostres (si p.sh. volumi specifik, dendesia, rezistenca mekanike, perthithja, perqeshmeria termike ose parametra te tjere te normalizuar ndaj sipërfaqes apo vëllimit), nje devijim prej ±3 mm mund te sjelle ndryshim te ndjeshem ne vlerat e perlllogaritura, vecanerisht kur permasat nominale te mostres jane te vogla ose kur kerkohet saktesi e larte. Ne testet ku permasat e mostres nuk jane parametra kritike (p.sh. analiza kimike cilesore ose teste qe nuk varen nga gjeometria e mostres), marzhi ±3 mm mund te konsiderohet i paperfillshem, per sa kohe qe mostrat mbeten brenda kufijve te pranueshem te standardit te metodes se proves. Per sa është shkruar me sipër ndikimi i marzhit te gabimit ±3 mm ne rezultatet e testimit nuk mund te pergjithesohet, por duhet te vleresohet rast pas rasti, ne funksion te:

- llojit te testimit dhe standardit te aplikuar,
- ndjeshmerise se parametrave ndaj ndryshimeve dimensionale,
 - madhesis se nominale te mostres,
 - dhe nivelit te pasigurise se pranueshme per rezultatin perfundimtar.

Laboratori Eko - Studio - Projekt Sh.p.k

Për fiksimin e rezultateve u perdoren instrumente dhe aparaturat si me posht:

Nº	Materiali/ Produkti/ Matrica të testuar	Emërtimi i provës/ vetia e matur	Teknika e provës (2)	Standardi / Metoda e proves (3)
1.	Ajer ne mjediset e punes (te Jashteme dhe te brendeshme)	Temperatura ne ajer	Metoda sensoriale elektrokimike	SSH EN ISO 7730:2025
2.	Ajer ne mjediset e punes (te Jashteme dhe te brendeshme)	Shpejtësi e Eres ne ajer	Metoda sensoriale elektrokimike	SSH EN ISO 7730:2025
3.	Ajer mjedis i jashtem	Lageshtia	Sensor	SSH EN ISO 7726:2025
4.	Ajer mjedis i jashtem	Presioni atmosferik	Sensor	SSH EN ISO 7726:2025
5.	Ajer mjedis i jashtem	Temperatura e ajrit	Sensor	SSH EN ISO 7726:2025
6.	Leter / Karton	Densiteti	Llogaritje	SSH EN ISO 534:2011
7.	Leter / Karton	Trashësia	Matje	SSH EN ISO 534:2011
8.	Leter / Karton	Volumi specifik	Llogaritje	SSH EN ISO 534:2011
9.	Leter / Karton	Gramatura	Gravimetri	SSH EN ISO 536:2019
10.	Leter / Karton	Bardhesia	D65 Illumination	SSH ISO 11475:2017
11.	Leter / Karton	pH	Potenciometrik	SSH ISO 6588-1:2021
12.	Leter / Karton	Lageshtia	pH-Meter Dixhital	SSH EN ISO 287:2017
13.	Leter / Karton	Opaciteti	Gravimetri	SSH EN ISO 2471:2008



➤ Sistemi IEQ portabel me multi-matje dhe multi-point.

Sistemi i lëvizshëm modular i perbere nga dataloggeri M-log për matjen e njëkohshme të:

- Sasi të termo-hidrometrike: temperatura e ajrit, temperatura rrezatuese dhe lagështia relative
- Ventilimi: matja e shpejtësisë së ajrit dhe llogaritja e rrjedhave të ajrit dhe ndryshimi i ajrit
- Llogaritja lokale e indeksit TO

(Temperatura Operative)% e pakënaqur nga temperatura e dyshemesë, flukset e ajrit dhe asimetria rrezatuese

- Llogaritja në PC (pas përpunimit) e indekseve të komoditetit termik PMV-PPD
- Cilësia e ajrit (CO, CO₂, VOC)
- Ndriçim

Prezantimi i Studios qe kreu Monitorimin

Ne funksion e kryerjes se monitorimit te komponenteve mjedisore dhe ekspertizes ne fushen e mjedisit, Eko-Studio-Projekt eshte e regjistruar ne QKR me numer NIPT-i L03614803Q dhe eshte pajisur nga Ministria e Mjedisit nepermjet QKL me Licencë Profesionale LN-2658-01-2011.

Per kryerjen e matjeve laboratorike Eko-Studio-Projekt eshte e pajisur me nje Laborator te Akredituar sipas standartit S SH ISO/IEC 17025:2017 nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit, konform ligjit Nr. 116/2014 "PËR AKREDITIMIN E ORGANEVE TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", me certifikate Akreditimi me numer Regjistrimi **LT 070 11 02 22**, per akreditimin e Laboratoreve Testues.

Eko-Studio-Projekt eshte certifikuar per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise sipas EN-ISO 9001:2015 me dt. 16.02.2022, me certifikate nr. AQS/Q/138422025 per "Ofrim sherbimesh laboratorike per analiza dhe monitorime mjedisore", si dhe per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit sipas EN-ISO 14001:2015 me date 16.02.2022 me certifikate nr AQS/A/138422025 per "Asistence per pajisjen me leje/licence mjedisi."

Certifikuar per monitorim mjedisor dhe hartimin e dokumentacionit perkatese per "Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune" sipas ISO 45001:2018 me certifikate nr. AQS/S/138442025date 16.02.2022 per "Kompetence per monitorimin e kushteve te punes dhe konsulence per sigurine dhe shendetin ne pune. Ofrimi i sherbimeve laboratorike per analiza dhe monitorim mjedisor."

Certifikuar per monitorim dhe hartim i dokumentacionit qe adreson riskun perkatese per "Sistemin e Menaxhimit te Riskut" sipas ISO 31000:2018 me certifikate nr. AQS/RM/122622024 date 07.05.2024 per "Kompetence per monitorimin e kushteve te punes dhe konsulence per sigurine dhe shendetin ne pune. Ofrim sherbimesh laboratorike per analiza dhe monitorim mjedisor."

Eko-Studio-Projekt eshte i pajisur me Laborator te Akredituar dhe te kompletuar me instrumente te standarteve bashkekohore dhe efikas, kryen monitorimin permanent dhe me kampione te komponenteve te Ujit, te Tokes, te Ajrit (Pluhurit, Gazrave helmues dhe industrial), te Mikroklimes, te Zhurmave, Radioaktivitetit, Eficences se energjiise, Lekure, Plastik, Letres dhe Kartanit.

"Eko-Studio-Projekt" SHPK

III.7.10. KPP referuar Raportit të Testimit të mostrave, me nr. 20 Prot. datë 19.01.2026, dërguar në KPP me anë të shkresës nr. 42 prot., datë 19.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 2052/15 prot., datë 21.01.2026, nga Laboratori "Eko – Studio – Projekt" SHPK, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave të sipërpërmendura, konstaton, se mostrat për kutitë e kartonit dhe dosjes, të operatorit ekonomik "Marketing & Distribution" SHPK të paraqitura për testim, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, për sa i përket gramaturës së tyre, konkretisht nga ana e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike **1- Për kutinë për ruajtje të përhershme** është kërkuar që kutia të ketë këto përmasa (40 x 28 x 18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), si dhe gramatura të jetë së paku 615 g/m². Sipas raportit të testimit të laboratorit "Eko – Studio – Projekt" SHPK rezulton, se gramatura për këtë kuti është 567.960 g/m² pra është nën minimumin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike duke llogaritur edhe pasigurinë e matjes së laboratorit. **2- Për kutinë për ruajtje të përhershme për amza** është kërkuar që kutia të ketë këto përmasa (40 x 55 x 18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), si dhe gramatura të jetë së paku 615 g/m². Sipas raportit të testimit të laboratorit "Eko – Studio – Projekt" SHPK rezulton, se gramatura për këtë kuti është 576.262 g/m² pra është nën minimumin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike duke llogaritur edhe pasigurinë e matjes së laboratorit. **3- Për kutinë për ruajtje të përhershme regjistra** është kërkuar që kutia të ketë këto përmasa (40 x 70 x 9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), si dhe gramatura të jetë së paku 615 g/m². Sipas raportit të testimit të laboratorit "Eko – Studio – Projekt" SHPK rezulton se gramatura për këtë kuti është 576.919 g/m² pra është nën minimumin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike duke llogaritur edhe pasigurinë e matjes së laboratorit. **4- Për dosjen për ruajtje të përhershme** është kërkuar që dosja të ketë këto përmasa (36 x 24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), si dhe gramatura të jetë së paku 325 g/m². Sipas raportit të testimit të laboratorit "Eko – Studio –

Projekt” SHPK rezulton, se gramatura për këtë dosje është 304.050 g/m² pra është nën minimumin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike duke llogaritur edhe pasigurinë e matjes së laboratorit.

Në përfundim, sa më sipër analizuar, nga verifikimi i dokumentacionit dhe Raporteve të Testimit të mostrave me nr. 20, 20/1, 20/2, 20/3 prot., datë 19.01.2026, dërguar në KPP, me anë të shkresës nr. 42 prot., datë 19.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 2052/15 prot., datë 21.01.2026, të Laboratorit të akredituar “*Eko – Studio – Projekt*” SHPK, konstatohet, se komponenti gramaturë për mostrat kuti dhe dosje, nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor, për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, sipas treguesve të raporteve të testimit të kryer nga laboratorit “*Eko-Studio-Projekt*” SHPK rezulton, se gramatura e mostrave të operatorit ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK, nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për komponentet të cilat iu nënshtruan testimit (gramatura), ku për testimin e të cilave, referuar faqes zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit rezulton, se është i akredituar laboratorit testues “*Eko-Studio Projekt*” SHPK, me numër akreditimi LT 070, datë 12.02.2022 dhe me vlefshmëri deri në datën 10.02.2026.

Për sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “*Së Pari, Operatori ekonomik “Kristalina KH”, ka paraqitur një ofertë ekonomike tërësisht dhe anomalisht të ulët. Fondi limit i përcaktuar në DST për këtë procedurë prokurimi është 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” është në vlerën e 46,336,920 (dyzet e gjashtë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Thënë ndryshe kjo ofertë është më shumë se 38% (tridhjetë e tetë përqind) më e ulët se vlera e fondit limit. Duke qenë se, në këtë procedurë prokuruese janë paraqitur vetëm 3 (tre) oferta ekonomike të vlefshme nga operatorë ekonomikë pjesëmarrës, si dhe duke pasur bindjen se oferta ekonomike e paraqitur nga OE Marketing & Distribution shpk është e pavlefshme, dhe si rrjedhojë do të duhet të skualifikohet,... rrjedhimisht, në zbatim të nenit 93, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 82, pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke iu referuar procedurës prokuruese të lartpërmendur, kjo ofertë do të duhej të konsiderohej i) anomalisht e ulët, dhe si rrjedhojë të konsiderohej ii) e papranueshme nga KVO e AK. Në nenin 93, pika 1 dhe 2, të LPP që përcakton se: 1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve*

pune shpjegime për cmimin ose kostot e propozuara në ofertë. 2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen vecanërisht për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore. Vetëm pasi, OE të ketë dhënë në mënyrë të detajuar shpjegimet për secilën prej shtyllave të lartpërmendura, duke sqaruar në mënyrë shteruese arsyet teknike dhe mundësinë e realizueshmërinë së kontratës (duke mos rrezikuar kështu realizimin e kontratës), bazuar në vlerën e ofertuar prej tij, atëherë AK do të mund të vlerësonte nëse kjo ofertë ekonomike mund të konsiderohej ose jo e pranueshme, duke mos rrezikuar kështu për asnjë moment realizimin e kontratës. Referuar nenit 93, pika 1, të LPP, bazuar në sasitë dhe specifikimet teknike të mallrave, nisur edhe nga eksperiencia dhe ekspertiza e padiskutueshme e stafit teknik të specializuar të BOE Office Paper shpk dhe Inpress shpk., të cilat janë ndër shoqëritë tregtare më të mëdha, që operon në tregun shqiptar për prodhimin dhe tregtimin e materialeve të arkivës, do të donim t’ju theksonim se OE “Kristalina KH” shpk e ka të pamundur teknikisht të prodhojë mallrat e kërkuara (sipas specifikimeve, cilësisë dhe sasive të përcaktuara në DST) në vlerën e ofertuar prej tij, dhe rrjedhimisht e ka të pamundur të realizojë me sukses kontratën e prokuruar, për arsyet e mëposhtme: Fillimisht do të donim t’ju informonim se procesi i prodhimit të produkteve / artikujve të arkivës është kompleks, ku ekzistojnë një sërë faktorësh, të cilët diktojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë koston e prodhimit, dhe si rrjedhojë cmimet e ofruara. Zërat kryesorë të kostove që ndikojnë drejtëpërdrejtë në procesin e prodhimit janë: i) Kosto e lëndëve dhe materialeve të para (letër + karton, lastra, format, tonerat, bojrat, etj.); ii) Kosto e punës (orët punës) e stafit teknik dhe administrativ; iii) Shpenzimet e përgjithshme administrative, etj. Bazuar në elementët teknikë të lartpërmendur, bazuar gjithashtu në sasitë dhe specifikimet teknike të mallrave të kërkuara në DST, nga përlllogaritja e bërë nga stafi teknik i specializuar i BOE Office Paper shpk. Dhe Inpress shpk., vetëm KOSTO e prodhimit të këtyre mallrave është më e lartë se vetë oferta ekonomike e paraqitur nga OE “Kristalina KH” shpk., e cila është në vlerën e 46,336,920 lekë pa TVSH. Nuk kuptohet se si ky OE do të mund të realizojë këtë kontratë prokurore, dhe pa e rrezikuar atë, ku vetëm Kosto e Prodhimit është më e lartë se Oferta Ekonomike e paraqitur...???. Rrjedhimisht, OE “Kristalina KH” shpk., NUK jep asnjë garanci teorike, praktiko / teknike dhe ligjore, që do të mund të realizojë me sukses furnizimin me mallrat e kërkuara në procedurën prokurore, objekt ankese. Përsa mësipër, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore të lartpërmendura... KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.8.2. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.8.3. Në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.
2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:
- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
 - b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
 - c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
 - ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
 - d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.
3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.
4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”.

III.8.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “.....**Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme**.....Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$

$PR = 85 \% MO$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”.

III.8.5. Referuar pretendimeve në ankesën e paraqitur nga ankimuesi, informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën nr. 1092/32 prot., datë 12.08.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2052/4 prot., datë 13.08.2025, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-43560-04-03-2025, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, me fond limit 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara

sh.a, kanë ofertuar 7 (shtatë) operatorë ekonomikë nga të cilët 3 (tre) prej tyre rezultojnë se përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme në respektim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Mbi bazën e këtij kualifikimi Komisioni ka aplikuar formulën për ofertën/ofertat anomalisht të ulët/ulta mbështetur në përcaktimet ligjore të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe DST. Në rastin në fjalë janë të vlefshme 3 (tre) oferta (përfshirë këtu ofertën e shoqërisë “Kristalina KH” SHPK për të cilën ankimuesi pretendon se është ofertë anomalisht të ultë) dhe në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nga përlllogaritjet e kryera nga KPP, konstatohet, se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK në vlerën prej 46.336.920 lekë pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, nuk rezulton anomalisht e ulët, pasi vlera e saj është më e madhe se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme (41.642.660 lekë) pra ofertave të 3 (tre) ofertuesve të kualifikuar të cilët **përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme** në respektim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK nuk qëndron, pasi në këtë procedurë prokurimi, e cila referuar fondit limit të përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe përcaktimeve të Kreut II “Kufijtë Monetar në Sektorin Klasik” pika 1 të VKM-së nr. 291, datë 15.05.2024 “Për Përcaktimin e Kufijve Monetarë në Procedurat e Prokurimit Publik” kjo procedurë prokurimi është nën kufirin e lartë monetar, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të bëra në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), në datën 14.07.2025 janë kualifikuar ofertat e 3 (tre) operatorëve ekonomikë, ku referuar përcaktimeve të nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4, të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, oferta ekonomike e operatorit ekonomik ofertuesë të kualifikuar “Kristalina KH” SHPK nuk rezulton anomalisht e ulët dhe si rrjedhim nuk është në kushtet e përcaktimeve të nenit 93 pika 5 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ndaj nuk mund të skualifikohet.

Për sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK nuk qëndron.

III.9. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK me pretendimin se: “Së Dyti, Ne kemi bindjen, që në kundërshtim me pikën 2.2.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar, të DST, OE Kristalina KH shpk. Nuk ka paraqitur raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore (për vitet 2022, 2023 dhe 2024), të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Është detyrim i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore (për vitet 2022, 2023 dhe 2024), të kryera, nga

auditues ligjorë ose shoqëri audituese, me përjsahtim të rasteve kur operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009. Në dijeninë tonë OE Kristalina KH shpk. Nuk është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009. Rrjedhimisht, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore të lartpërmendura... ..KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik ëkppì, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik ëkristalina khì shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1 Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve për vitet financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

III.9.2 Në përmbushje të kriterit të sipërcituar operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK ka dorëzuar në SPE:

- Raport Auditimi për pasqyrat financiare të shoqërisë “Kristalina KH” SHPK për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2022.

- Shkresën me nr. 346 prot., datë 06.04.2023 me lëndë “Kthim përgjigje”, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me numër çështje E00010782928 datë 04.04.2023, ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj, në sistemin informatik tatimor, për vitin 2022 të dorëzuara elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me datë 28.03.2023”. Bashkëlidhur kopje e pasqyrave financiare.

- Raport Auditimi për pasqyrat financiare të shoqërisë “Kristalina KH” SHPK për periudhën nga 1 janari 2023 deri më 31 dhjetor 2023.

- Shkresën me nr. 6089 prot., datë 04.04.2024 me lëndë “Kthim përgjigje”, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me numër çështje E0001229727 datë 03.04.2024, po ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj, në sistemin informatik tatimor, për vitin 2023 të dorëzuara elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me datë 27.03.2024”. Bashkëlidhur kopje e pasqyrave financiare.

- Raport Auditimi për pasqyrat financiare të shoqërisë “Kristalina KH” SHPK për periudhën nga 1 janari 2024 deri më 31 dhjetor 2024.

- Shkresën me nr. 7345 prot., datë 14.04.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me numër çështje E0001413689 datë 09.04.2025, po ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj, në sistemin informatik tatimor, për vitin 2024 të dorëzuara elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me datë 31.03.2025”. Bashkëlidhur kopje e pasqyrave financiare.

III.9.3. Në nenin 2 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.9.4. Neni 3 Parime të përgjithshme “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.9.5. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare . 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. 3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. 4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.9.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Nisur nga pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, si dhe nga verifikimi i dokumentave të tenderit Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në pikën 2.2.2 të shtojcës nr. 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon: “2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve për vitet financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si vijon: “1- Raport Auditimi për pasqyrat financiare të shoqërisë “Kristalina KH” SHPK për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2022. 2- Shkresën me nr. 346 prot., datë 06.04.2023 me lëndë “Kthim përgjigje”, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me numër çështje E00010782928 datë 04.04.2023, ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj, në sistemin informatik tatimor, për vitin 2022 të dorëzuara elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me datë 28.03.2023”. Bashkëlidhur kopje e pasqyrave financiare. 3- Raport Auditimi për pasqyrat financiare të shoqërisë “Kristalina KH” SHPK për periudhën nga 1 janari 2023 deri më 31 dhjetor 2023. 4- Shkresën me nr. 6089 prot., datë 04.04.2024 me lëndë “Kthim përgjigje”, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me numër çështje E0001229727 datë 03.04.2024, po ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj, në sistemin informatik tatimor, për vitin 2023 të dorëzuara elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me datë 27.03.2024”. Bashkëlidhur kopje e pasqyrave financiare. 5- Raport

Auditimi për pasqyrat financiare të shoqërisë “Kristalina KH” SHPK për periudhën nga 1 janari 2024 deri më 31 dhjetor 2024. 6- Shkresën me nr. 7345 prot., datë 14.04.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me numër çështje E0001413689 datë 09.04.2025, po ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj, në sistemin informatik tatimor, për vitin 2024 të dorëzuara elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me datë 31.03.2025”. Pra nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ka dorëzuar kopje të bilanceve për vitin 2022, 2023, 2024 të shoqëruar nga shkresa e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë, se bashku me raport auditet përkatëse për secilin vit. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se pretendimi i ankimuesit për skualifikimi e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK për mospërmbushje të kriterit 2.2.2 nuk qëndron. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Për sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK nuk qëndron.

III.10. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK me pretendimin se: “Së Treti, Ne kemi bindjen, që në zbatim të pikës 2.3.3 kapaciteti teknik, të DST, OE Kristalina KH shpk. Nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, pasi NUK ka paraqitur autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt / lëndët e para të Kartonit për kutitë, kartonit oër Dosjet dhe Letren per Etiketart artikujt objekt i prokurimit. Është e vërtetë që OE Kristalina KH shpk është përpunues përfundimtar për artikujt objekt të kësaj procedure (kuti kartoni, dosje kartoni dhe etiketa letre), por OE Kristalina KH shpk., bazuar ne dokumentat zyrtare dhe ligjore nuk është kurrësesi prodhues i Kartonit per kutitë, Dosjet dhe Letren per Etiketart artikujt objekt i prokurimit. Kriteri kërkon që nëse operatori nuk është vetë prodhues, të paraqesë autorizim nga prodhuesi, të dhëna të plota dhe lidhje të dokumentuar me prodhuesin. Në rastin konkret, nuk është paraqitur autorizim nga prodhues i certifikuar, dhe nuk është paraqitur autorizim nga Distributor te vërtetuar lidhje me prodhues të mirëfilltë, për të gjitha artikujt / lëndët e para të Kartonit për kutitë, kartonit për Dosjet dhe Letren per Etiketart. Ky Kriter kualifikues kërkon autorizim nga një prodhues i artikujve objekt prokurimi (kuti kartoni, dosje kartoni), jo nga një subjekt që vetëm shtyp apo dekoron materialin. Pra, në përputhje me pikën 2.3.3 kapaciteti teknik, të DST

nëse operatori blen karton dhe e printon, ai nuk është prodhues i lëndës së parë dhe as i produktit final, për sa kohë që nuk ka linjë të prodhimit të vetë artikujve të tenderit. Kriteri kërkon një subjekt që e prodhon materialin (dosje, kuti), jo që vetëm i stampojnë apo i shtypin ato. Kriteri kërkon identifikim të qartë të prodhuesit. Nëse nuk je vetë prodhuesi i artikujve, duhet të paraqesësh autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i tij, me të dhëna të plota për prodhuesin. Për më tepër, ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis Kriterit 3.3.3 dhe Kriterit 3.3.4. Kriteri 3.3.4 kërkon paraqitjen e fletë-analizës së lëndës së parë (kartonit) të përdorur për kutitë dhe dosjet, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit. Kjo kërkesë nënkupton qartë se Kriteri 3.3.3 kërkon që operatori të jetë prodhues i kartonit që përdoret për artikujt objekt të prokurimit ose prodhues i plotë i artikujve përfundimtarë (kuti, dosje). Pra, nuk është e mjaftueshme që operatori të kryejë vetëm përpunim printimi apo dekorimi mbi materialet e gatshme, por duhet të ketë kapacitet prodhimi të lëndës bazë dhe/ose të produktit final. Në konkluzion, do të donim të parashtrojmë se OE Kristalina KH sh.p.k. Nuk është prodhues i artikujve (kuti kartoni, dosje kartoni, etiketa letre) por vetëm përpunues printimi dhe shërbimesh mbështetëse. Në lidhje me këtë pikë, KVO e AK ka mbajtur qendrim të drejtë për sa i përket vlerësimit të ofertës ekonomike të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës Infosoft Office shpk dhe Albdesign PSP shpk., duke i skualifikuar këto operator ekonomikë ?. Por në mënyrë të gabuar nuk ka mbajtur të njejtin qendrim dhe nuk e ka vlerësuar në të njejtën mënyrë ofertën e paraqitur nga OE Kristalina KH shpk. Për sa mësipër, në përputhje me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.10.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit” i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi janë përcaktuar artikujt objekt prokurimi dhe sasia e pritshme si më poshtë:

Sasia e pritshme e mallit që kërkohet:

TABELA E PËRGJITHSHME			
Nr	Emërtimi i artikujve	Njësia	Sasia e pritshme
1	Kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18)	Copë	15 845
2	Kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18)	Copë	766
3	Kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9)	Copë	1 434
4	Dosje për ruajtje të përhershme (36x24)	Copë	52 152

Shënim: Per hartimin e shtojces nr.3 “Lista e çmimeve te artikujve” operatorët ekonomikë pjesëmarrës do te bazohen tek sasi të e pritshme sipas tabelës së përgjithshme te mesiperme.

III.10.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik” i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi.

III.10.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Dokumentin “Letër Autorizim” datë 26.05.2025, të lëshuar nga kompania prodhuese Schempp Bestandserhaltung GmbH, me përmbajtje “Ne Schempp Bestandserhaltung GmbH prodhues të materialeve për paketim mbrojtës, asetet kulturore, si për shembull
– karton të valëzuar për kuti: 3,0mm, 620 gr/m², ngjyrë gri e hapur, pH-vlera 9.0, rezerva Alkaliane 7.9 %, lignine 0%;
- karton arkivues për dosje me katër kapakë: 330 gr/m², ngjyrë gri e hapur, pH-vlera 9.1, rezerva Alkaline 7.8 %, lignine 0 %, dhe pronar i markës Schempp, me anë të kësaj shkrese konfirmojmë së “Shtypshkronja Kristalina KH” është e autoizuar të shesë në Shqipëri materialet tona për paketimin mbrojtës, për asetet kulturore. Të gjitha detajet janë të përcaktuara në kontratë, nga data 7 Maj 2021 (akoma e vlefshme sot).

III.10.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.10.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor,

social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.10.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.10.7. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.10.8. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 dhe 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

III.10.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e

gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.10.10. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.3. *Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi.* Referuar kriterit të sipërpërmendur konstatohet se, autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë se, operatorët ekonomikë ofertues për artikujt objekt prokurimi, duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar. Gjithashtu, në rastin kur është paraqitur autorizim nga distributori i autorizuar, ky autorizim duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, KPP konstaton se, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.10.3. të këtij vendimi. Nisur nga pretendimet e ankimuesit si dhe nga shqyrtimi i këtij dokumentacionit të ngakuar në SPE në përmbushje të këtij kriteri, KPP konsaton se, nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, pra autorizimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues është lëshuar nga vetë prodhuesi *Schempp Bestandserhaltung GmbH*, ky i fundit ka paraqitur dokumentin autorizim prodhuesi, në të cilin pasqyrohet kompania prodhuese dhe të dhënat e identifikimit të saj, si dhe kjo e fundit konfirmon se *“Shtypshkronja Kristalina KH”* është e autorizuar të shesë në *Shqipëri materialet tona për paketimin mbrojtës, për asetet kulturore. Të gjitha detajet janë të përcaktuara në kontratë, nga data 7 Maj 2021 (akoma e vlefshme sot).* Në rastin konkret, operatori ekonomik *“Kristalina KH” SHPK*, ashtu siç pranohet nga vetë kompania prodhuese, disponon një dokument të vlefshëm për pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit. Synimi i kërkesës së autoritetit kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose autorizimit nga

distributori për mallrat objekt-prokurimi është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallra objekt-prokurimi, pra autorizimi nga prodhuesi është një dokument nëpërmjet të cilit autoriteti kontraktor sigurohet që subjekti/shoqëria që lëshon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që t'a furnizojë me produktet e tij, duke siguruar garancinë e mallit, gjë e cila nga dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike garantohej dhe vërtetohet përmbushja e kërkesave të autoritetit kontraktor. Pra, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomik ankimes nuk qëndron. KPP gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes, për përmbushjen e kriterit më sipër, është i vlefshëm dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Sa më sipër, Komisioni gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar operatori ekonomik ankimes e plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 të dokumentave të tenderit.

Për sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK nuk qëndron.

III.11. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK me pretendimin se: “*Së katërti, Ne kemi bindjen, që në zbatim të pikës 2.3.4 kapaciteti teknik, të DST, OE Kristalina KH shpk nuk përmbush kriterin e vëçantë të kualifikimit, pasi NUK ka paraqitur: As fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë As (dhe/ose) skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë, që janë objekt i kësaj procedure prokurimi. Në rastin e parqitjes së fletë analizës së lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, fletëanaliza do të duhet të përmbante të dhënat / karakteristikat e mëposhtme: Për kartonin e kutive: Gramatura së paku 615 g/m²; Ph midis 7.0 dhe 9.5; Rezerva alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit; Jo më shumë se 1% lignin; Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c; Për kartonin e dosjeve: Gramatura së paku 325 g/m²; Ph midis 7.0 dhe 9.5; Rezerva alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit; Jo më shumë se 1% lignin; Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c; Për kartonin e dosjeve: Gramatura së paku 325 g/m²; Ph midis 7.0 dhe 9.5; Rezerva alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit; Jo më shumë se 1% lignin; Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c. Referuar sa mësipër, ne kemi bindjen që OE Kristalina KH shpk. NUK ka paraqatur as fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të specifikohen qartazi edhe specifikimet teknike të kërkuara në DST,... ..as skedën teknike të prodhuesit të kartonit që do të përdoret për dosjet dhe kutitë*

objekt prokurimi, e cila të përmbante qartazi të dhënat / specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Gjithashtu, OE Kristalina KH shpk. Nuk ka paraqitur autorizim të vlefshëm nga prodhuesi i kartonit, që të vërtetojë lidhjen midis operatorit ofertues dhe prodhuesit. Ky autorizim është i domosdoshëm për verifikimin e vlefshmërisë së ofertës dhe për të garantuar që operatori ekonomik ka të drejtën ligjore për të ofruar produktin e prodhuesit. Për sa mësipër, në përputhje me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.11.1. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Specifikimet teknike vendim nr. 7, datë 9.9.2024 “Për miratimin e standardeve të kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre”. Shtojca 1 Standardet e kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre

Lloji	Përmasat	Specifikimet teknike
Kuti për ruajtje të përhershme	40x28x18	<u>Kutia:</u> - Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramaturë së paku 615 g/m² që të lejojë valëzueshmërinë, duke mos cenuar përmasat e kutisë. - Faqet anësore të jenë me dy shtresa kartoni (fortësi të dyfishtë), ndërsa faqet e tjera me një shtresë kartoni. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin. - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. - Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c - Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm. <u>Dosja:</u> - Kartoni të jetë së paku me gramaturë 325 gr/m², duke mos cenuar përmasat e dosjes, me 2 krahë të brendashkruar të palosur, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5.
Kuti për ruajtje të përhershme për amza	40x55x18	
Kuti për ruajtje të përhershme për regjistra	40x70x9	
Dosje për ruajtje të përhershme	36x24	

		- Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. - Ngjyra e dosjes duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kutisë. - Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm
--	--	---

III.11.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, ku të ketë bashkëlidhur kartonin e përdorur për dosjet dhe kutitë që janë objekt i kësaj procedure prokurimi, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

III.11.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, për përmbushjen e kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

- Deklaratë paraqitje skedave teknike dhe fletë analiza. PDF. (209.4 kB).
- Raport testimi karton laborator gjerman (PTS) karton 330 gr. PDF (2.06 MB).
- Raport testimi karton laborator gjerman (PTS) karton 620 gr. PDF (1.99 MB).
- Raport testimi nga laborator i akredituar shqiptar karton 330 gr. PDF (311.7 kB).
- Raport testimi nga laborator i akredituar shqiptar karton 620 gr. PDF (312.6 kB).
- Skeda teknike prodhuesit karton 620 gr. PDF (1.14 MB).
- Skeda teknike prodhuesit karton 330 gr. PDF (1.09 MB).

III.11.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.11.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.11.6. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.11.7. Në nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

III.11.8. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.”.

III.11.9. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.11.10. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike..”.

III.11.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “*Për prokurimin publik*” ka për detyrë *d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

III.11.12. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, në rastin konkret fletë analizën e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Autoriteti kontraktor me qëllimin e vlerësimit të specifikimeve teknike të mallit objekt - prokurimi ka kërkuar në DST që operatorët ekonomikëtë paraqesë fletë analizat e lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi që sipas shtojcës 7 janë kuti dhe dosje të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i

akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Operatorët ekonomikë ofertues në përmbushje të specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet dokumentacionit provues (në rastin konkret fletë analizës për produktet që do të ofertojnë) duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit të paraqitur me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që vlerësimi i parametrave të produkteve të ofertuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kryhet në mënyrë të saktë në përputhje me parametrat e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht të realizohet me sukses kontrata objekt prokurimi.

III.11.13. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se në kriterin kualifikues të pikës 2.3.4 të Shtojcës 8/2 të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve ligjore të sipërpërmendura, ka përcaktuar që ofertuesit duhet të paraqesin fletë analizat [për artikujt objekt prokurimit të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

- *Raport testimi karton laborator gjerman (PTS) karton 330 gr. PDF (2.06 MB).*
- *Raport testimi nga laborator i akredituar shqiptar karton 330 gr. PDF (311.7 kB).*
- *Skeda teknike prodhuesit karton 330 gr. PDF (1.09 MB).*
- *Raport testimi karton laborator gjerman (PTS) karton 620 gr. PDF (1.99 MB).*
- *Raport testimi nga laborator i akredituar shqiptar karton 620 gr. PDF (312.6 kB).*
- *Skeda teknike prodhuesit karton 620 gr. PDF (1.14 MB).*

KPP nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm konstaton se, dokumentacionet e mësipërme, janë lëshuar nga laborator të akredituar për të kryer analizat për komponentët gramaturë, pH, rezervë alkaline, lignin, dhe ngjyra Pantone 427c - 429c, nga verifikimi i këtyre tregueseve rezulton se rezultatet në fletat e analizës të dorëzuara në sistemin e prokurimit elektronik janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, referuar vlerave të përcaktuara në DST dhe vlerat e nxjerra nga fletë analizat e paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK konstatohet se parametrat e artikujve objekt prokurimi të ofertuara nga ky operator ekonomik janë brenda marzheve të parametrave të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në DST. Në këtë mënyrë, vlerësojmë, se pretendimet e ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues janë të pabazuara dhe të pa mbështetura në ligj, pasi dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK i përmbush kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor.

III.12. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga

operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “[...]Së Pesti, Ne kemi bindjen, që OE Kristalina KH shpk., në kundërshtim me pikën 2.3.5 kapacitetet teknik, të shtojcës 8, Kriteret e vecanta të Kualifikimit të DST, nuk ka paraqitur mostrat në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Në pikën 2.3.5 kapaciteti Teknik, të shtojcës 8, Kriteret e vecanta të kualifikimit të DST përcaktohet se: Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6. - 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm; -1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm; -1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm; -1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm; - 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së). Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim. Në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST përcaktohet se: “Formulari i specifikimeve teknike” specifikimet teknike - vendim nr. 7, datë 9.9.2024 “Për miratimin e standardeve të kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre - shtojca 1 standardet e kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre. Në lidhje me këtë kriter kualifikues, ne kemi bindjen që mostrat e paraqitura nga OE Kristalina KH shpk., NUK janë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara dhe të kërkuara në shtojcën 8 kriteret e vecanta të kualifikimit - kapaciteti teknik, pika 2.3.5, të DST, sa mëposhtë: Përsa i përket mostrës së paraqitur Kutit për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x28x18 cm: NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket: - Përmasave të kutisë të dorëzuar - 40x28x18 cm (Marzhi i gabimit të përmasave ? 3 mm); - Peshës së Kartonit të kutisë të dorëzuar - me gramaturë së paku 615 g/m²; - ph të Kartonit të kutisë së dorëzuar - ph midis 7.0 dhe 9.5; - Rezervës së alkalines Kartonit të kutisë të dorëzuar - minimalisht prej 2% të karbonatit të kalciumit; - Të përmbajtjes së ligninit të Kartonit të kutisë së dorëzuar - jo më shumë se 1% lignin. - Ngjyrës së të kutisë të dorëzuar - të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c. Sic përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës kuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x28x18 të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST. Përsa i përket mostrës së paraqitur Kutit për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x55x18 cm: NUK është në përputhje me të gjitha

specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket: - Përmasave të kutisë të dorëzuar - 40x55x18 cm (Marzhi i gabimit të përmasave ? 3 mm); - Peshës së Kartonit të kutisë të dorëzuar - me gramaturë së paku 615 g/m²; - ph të Kartonit të kutisë së dorëzuar - ph midis 7.0 dhe 9.5; - Rezervës së alkalines Kartonit të kutisë të dorëzuar - minimalisht prej 2% të karbonatit të kalciumit; - Të përmbajtjes së ligninit të Kartonit të kutisë së dorëzuar - jo më shumë se 1% lignin. - Ngjyrës së të kutisë të dorëzuar - të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c. Sic përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës ekuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x55x18 të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk. Do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST. Përsa i përket mostrës së paraqitur Kuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x70x9 cm: NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket: - Përmasave të kutisë të dorëzuar - 40x70x9 cm (Marzhi i gabimit të përmasave ? 3 mm); - Peshës së Kartonit të kutisë të dorëzuar - me gramaturë së paku 615 g/m²; - ph të Kartonit të kutisë së dorëzuar - ph midis 7.0 dhe 9.5; - Rezervës së alkalines Kartonit të kutisë të dorëzuar - minimalisht prej 2% të karbonatit të kalciumit; - Të përmbajtjes së ligninit të Kartonit të kutisë së dorëzuar - jo më shumë se 1% lignin; - Ngjyrës së të kutisë të dorëzuar - të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c. Siç përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës kuti për ruajtje të përhershme, me përmasa 40x70x9 të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga laboratorë të Akredituar në republikën e shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk. Do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST. Përsa i përket mostrës së paraqitur Dosje për ruajtje të përhershme, me përmasa 36x24 cm: NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket: - Përmasave të

Dosjes së dorëzuar - 40x70x9 cm (Marzhi i gabimit të përmasave ? 3 mm); - Peshës së Kartonit të Dosjes të dorëzuar - me gramaturë së paku 325 g/m²; - ph të Kartonit të Dosjes së dorëzuar - ph midis 7.0 dhe 9.5; - Rezervës së alkalines Kartonit të Dosjes së dorëzuar - minimalisht prej 2% të karbonatit të kalciumit; - Të përmbajtjes së ligninit të Kartonit të Dosjes së dorëzuar - jo më shumë se 1% lignin; - Ngjyrës së Dosjes të dorëzuar - të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c. Siç përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifiimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës së Dosje për ruajtje të përhershme, me përmasa 36x24 cm të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Gjithashtu, mostra e paraqitur nga OE Kristalina KH shpk. Dosje për ruajtje të përhershme, me përmasa 36x24 cm, nuk është në përputhje me specifikimet teknike plotësuese (që nuk janë në vendimin nr. Nr.7, datë 09.09.2024 të KLA) të përcaktuara nga Grupi i punës, sa mëposhtë: Dizajni nuk është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; madhësia / përmasat e Shkrimit dhe vijëzimit nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; Numri i vijëzimeve / dhe distancat ndërmjet vijëzimeve (12 vijëzime të pa ndërprera me distancë 1.5 cm) nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; Distanca e kornizimit të dosjes nga broder line në limitin e dosjes nuk është 2 cm sipas specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; Korniza e Dosjes nuk është me gjerësi 2 mm sipas specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës. Sic përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifiimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të matjes me pajisje të kalibruara dhe certifikuar të mostrës dosje për ruajtje të përhershme, me përmasa 36x24 cm të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga Institucione / laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST. Përsa i përket mostrës së paraqitur Etiketa, me përmasa 15x10 cm: Mostra e paraqitur nga OE Kristalina KH shpk. Etiketa, me përmasa 15x10 cm, nuk është në përputhje me specifikimet teknike plotësuese (që nuk janë në vendimin nr. Nr.7, datë 09.09.2024 të KLA) të

përcaktuara nga Grupi i punës, sa mëposhtë: Përmasat e etiketës së dorëzuar - 15x10 cm, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara; Dizajni nuk është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; madhësia / përmasat e Shkrimit dhe vijëzimit nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; Madhësia / përmasat e Logos (2 cm lartësia dhe 2.5 cm gjerësi) dhe ngjyra e logos (5C (katër ngjyrat bazë plus bojë speciale panton 1505c)+llak) nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; Numri i Rreshtave / dhe distancat (hapësira nga rreshti në rresht) ndërmjet Rreshtave / vijëzimeve (8 vijëzime/rreshta x 0.6 cm = 4.8 cm dhe duke shtuar lartësinë e logos 2.5 cm shkon në 7.2 cm.) Nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; Distanca e kornizimit të etiketës nga broder line në limitin e dosjes nuk është 0.5 cm sipas specifikimet teknike të përcaktuara nga Grupi i punës; siç përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë. Bazuar në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese, në rast se ndonjë prej elementëve të mësipërm, do të ishte minimalisht më e vogël apo më e madhe se specifikimet teknike të përcaktuara në DST, atëherë mostra e paraqitur nuk do të duhet të konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe rrjedhimisht operatori ekonomik pjesëmarrës do të duhet të skualifikohet. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të matjes me pajisje të kalibruara dhe certifikuar të mostrës etiketa, me përmasa 15x10 cm të dorëzuar nga OE Kristalina KH shpk. Nga Institucione / laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, të DST. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.5 kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.12.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për secilin artikull objekt prokurimi, të listuar më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm
- 1 (një) kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm
- 1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm
- 1 (një) etiketë me format 15 x 10 cm. (mostra të jetë me logon e DPA-së).

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim.

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

III.12.2. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Specifikimet teknike vendim nr. 7, datë 9.9.2024 “Për miratimin e standardeve të kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre”. Shtojca 1 Standardet e kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre

Lloji	Përmasat	Specifikimet teknike
Kuti për ruajtje të përhershme	40x28x18	<u>Kutia:</u> - Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramaturë së paku 615 g/m² që të lejojë valëzueshmërinë, duke mos cenuar përmasat e kutisë. - Faqet anësore të jenë me dy shtresa kartoni (fortësi të dyfishtë), ndërsa faqet e tjera me një shtresë kartoni. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin. - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. - Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c - Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm. <u>Dosja:</u> - Kartoni të jetë së paku me gramaturë 325 gr/m², duke mos cenuar përmasat e dosjes, me 2 krahë të brendashkruar të palosur, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.
Kuti për ruajtje të përhershme për amza	40x55x18	
Kuti për ruajtje të përhershme për regjistra	40x70x9	
Dosje për ruajtje të përhershme	36x24	

		- Ngjyra e dosjes duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kutisë. - Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm
--	--	---

III.12.3. Nga verifikimet e kryera për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, ka dorëzuar mostrat si më poshtë:

- kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm)
- kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
- kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
- dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).

III.12.4. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020, “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.12.5. Në nenin 40, pika 6, germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të

trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.12.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.12.7. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit konkretisht pikës 2.3.5 të kapacitetit teknik rezulton, se është kërkuar shprehimisht, që në datën dhe orën e zhvillimit të tenderit, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin artikull objekt - prokurimi sipas specifikimeve teknike (shtojca 6); - kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - etiketa me format 15 x 10 cm. Mostrat do të paraqiten pranë AK, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave me adresë: Rruga “Jordan Misja” 8303, Tiranë. **Mosparaqitja e mostrave në datën dhe orën e hapjes së ofertave përbën shkak për skualifikim.**

III.12.8. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 2577/3 prot, datë 24.09.2025, rezulton se operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor mostrat - kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).

III.12.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionit dhe mostrave të dorëzuara nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 2577/3 prot, datë 24.09.2025 me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të ankimuesit bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, KPP gjykoi të domosdoshme kryerjen e testimit të mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të mostrave të dorëzuara. Pavarësisht se ky veprim procedural është kryer nga ana e autoritetit kontraktor vërtetuar kjo me shkresën nr. 2577/3 prot, datë 24.09.2025, si rrjedhojë e ankesës nr. 2052/2025 prot, datë 31.07.2025, të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, ku Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me Vendimin nr. 78/2025 ka vendosur mospranimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, me arsyetimin se nga analizat e mostrave janë konfirmon me parametrat e kërkuara në DST.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor, me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të ankimuesit, KPP gjykoi të domosdoshme kryerjen e testimit të mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të mostrave të dorëzuara. Në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2049/8 prot., datë 16.10.2025, me objekt: “Kërkesë për informacion”, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit me shkresën nr. 463/1 prot., datë 20.10.2025 informon KPP-në se: “[...]Në lidhje me testet e PH, barshësisë/ngjyrës, dhe gramaturës DPA ka akredituar 2 laboratorë testues si më poshtë: 1- Laboratorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave LT 129, për pH dhe gramaturën, por jo për bardhësinë/ngjyrën. 2- Laboratorin Eko-Studio Projekt SHPK LT 070 për pH, gramaturën dhe bardhësinë/ngjyrën”. Në këto kushte Komisioni Prokurimit me shkresën nr. 2049/10 prot., datë 04.11.2022 iu drejtua laboratorit testues “Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave” SHPK, duke i kërkuar informacion “nëse Subjekti juaj mund të kryej analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet pH dhe gramaturë ?. Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifën e analizave për secilin komponentë të sipërcituar”. Me shkresën nr. 11844/1 prot., datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/12, datë 11.11.2023 me objekt “Kthim-përgjigje kërkesës për informacionnr. 2049/10 prot, datë 04.11.2025”, laboratorit testues “Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave”, informon se “Në lidhje me çfarë parashtroni në shkresën tuaj, për të kryer analizat e materialeve kuti dhe dosje për analizat pH dhe gramaturë, ju informojmë se, ne si institucion e ofrojmë shërbimin e matjes së pH dhe gramaturës për letër/karton. Gjithashtu, për sa i përketë tarifës së analizave për pH është 1,500 (një mijë e pesëqindë) lekë, për gramaturën është 1,500 një mijë e pesëqindë) lekë. Afati i përgjigjes për secilën analizë është 4 (katër) ditë pune”. Me shkresën nr. 2049/11 prot., datë 04.11.2022, Komisioni iu drejtua laboratorit testues “Eko-Studio-Projekt” SHPK, duke i kërkuar informacion “nëse Subjekti juaj mund të kryej analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet pH, bardhësi/ngjyrë, dhe gramaturë ?. Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifën e analizave për secilin komponentë të sipërcituar” . Me shkresën nr. 1061 prot., datë 07.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/13, datë 11.11.2025 me objekt “Kthim-përgjigje shkresës me nr. 2049/11 prot, datë 04.11.2025”, laboratorit testues “Eko-Studio-

Projekt” SHPK, informon se: “Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 2049/11 prot., datë 04.11.2025, me lëndë “Kërkesë për Informacion”, drejtuar pranë zyrës sonë, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Eko-Studio-Projekt ShPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikas dhe kryhet testime permanente të kapineve të ujit, tokës, ajrit, mikroklimës, zhurmave, radioaktivitetit, letrës dhe kartonit. Oferta ekonomike është si më poshtë vijon:

Nr.	Shërbim	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSh	Vlera pa TVSH
1	Analiza gramaturës	Copë	4	6600	26400
2	Analiza e Bardhësisë	Copë	4	5500	22000
3	Analiza e pH	Copë	4	7400	29600

Me shkresën nr. 2049/15 prot., datë 11.12.2025 me objekt “Kërkesë për Informacioni” Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit duke i kërkuar informacion si vijon: “1- A është i akredituar laborator i privat ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing nga institucioni juaj për kryerjen e analizave për komponentët e mëposhtëm: - Gramaturë; - pH; - Rezervë alkaline; - Lignin; - Ngjyrën e kutisë. - Matjen e përmasave të kutive dhe dosjeve për arkiv”. Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit me shkresën 547/1 prot., datë 15.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/16, datë 18.12.2025, informon se “Në përgjigje të shkresës suaj, Nr. 2049/15, datë 11.12.2025, drejtuar DPA për kërkesë informacionin lidhje me fushën e akreditimit të laboratorit testues ECCAT SHPK, ju informojmë se ky laborator është akredituar së fundmi më datë 09.10.2025, për analizat e mëposhtme në matricat letër/karton: - Gramaturë; - pH; - ngjyra/bardhësia. Laboratori ECCAT nuk është i akredituar për kryerjen e testeve të Rezervës alkaliane, Lignit dhe matjes së përmasave të kutive dhe dosjeve për arkivë në matricat letër/karton. Për këto teste, ashtu sic jeni informuar edhe më parë, nëpërmjet shkresës nr. 463/1 prot, datë 20.10.2025 DPA nuk ka akredituar asnjë laborator testues, të vendit apo të huaj që ti kryejë ato. Përveç dhënies së këtij informacioni, DPA ndjen detyrimin dhe përgjegjësinë të sqarojë se në kërkesën për informacion të drejtuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, në shkresën e sipërpërmendur (nr. 463/1 prot, datë 20.10.2025), është dhënë pa dashje një informacion jo i përditësuar duke përjashtuar nga lista e laboratorëve që kryejnë testet e kërkuara në shkresë, laboratorin ECCAT SHPK i cili në atë periudhë sapo i është zgjeruar fusha e akreditimit për një pjesë të testeve të përmendura shkresë. Kjo ka ndodhur si rezultat i një gabimi njerëzor për shkak të çështjeve teknike dhe ngarkesës së lartë të punës gjatë periudhës përkatëse. Duke ju kërkuar ndjesë për krijimin e kësaj situate, jemi të gatshëm që të ridërgojmë cdo informacion tjetër që i nevojitet Institucionit tuaj në lidhje me verifikimet e fushave të akreditimit të subjekteve të akredituara që ju merrni në shqyrtim”. Komisioni me shkresën nr. 2049/17 prot., datë 22.12.2025 me objekt “Kërkesë për Informacion” ju drejtua laboratorit testues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK duke i kërkuar informacion si vijon “nëse Subjekti juaj mund të kryej analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet Gramaturë, pH, ngjyrë/bardhësi, dhe Matje të përmasave të kutive dhe dosjeve për arkivën ?. Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifat e analizave për secilin komponentë të sipërcituar”. Laboratori testues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK,

me shkresën nr. 364 prot., datë 24.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2049/18, datë 29.12.2025 me objekt “Kthim-përgjigje”, informon se “Shoqëria ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing është e akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) me Numër Akreditimi LT 128, për kryerjen e analizave laboratorike për materialet letër/karton/pulpë, sipas parametrave dhe metodave të mëposhtme: -Trashësia; - Vëllimi specifik; - Densiteti; - Gramatura; - pH; - Përcaktimi i bardhësisë. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se oferta jonë për analizimin e parametrave të kërkuar nga ana juaj është bashkangjitur kësaj shkrese, sipas kërkesës suaj.

Nr.	Testi/Parametri	Çmimi ALL pa TVSH/Parametër	Numri i mostrave	Cmimi total ALL pa TVSH
1	Gramatura	6200	4	24800
2	pH	6900	4	27600
3	Ngjyra/Bardhësia	4800	4	19200
Cmimi total ALL pa TVSH				71.600
Cmimi total ALL me TVSH				85.920

Në datën 04.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 1798/2025, për kryerjen e ekspertizës së analizimit të komponentëve 1- Gramaturë; 2- pH; 3- Bardhësi/ngjyrë për operatorët ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK dhe “Kristalina – KH” për mostrat - kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përhershme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), nga laborator i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostrat e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Në datën 11.12.2023, ora 12:15, në prani të përfaqësuesve të shoqërisë “Marketing & Distribution” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, të autoritetit kontraktor, dhe të Komisionit të Prokurimit Publik, në ambientet e KPP-së u mbajt seancë dëgjimore me regjistrim audio të seancës. Në këtë seancë përfaqësuesja e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK pasi u pyet për mostrat e nëse ka pretendime për to, u pohua se nuk ka asnjë pretendim dhe se mostrat janë të tyre, gjithashtu përfaqësuesja e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK shprehu dakortësin për analizimin e mostrave në laboratorin “Eko Studio Projekt”, dhe përfaqësuesit e autoritetit kontraktor nuk patën pretendime dhe kërkesa paraprake, ndërsa përfaqësuesi i operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, nuk pati edhe ai pretendime për mostrat e dorëzuara pohoi se janë mostrat e tij, por në seancë pati një kërkesë paraprake, kërkesë të cilën e ka dërguar edhe me rrugë postare, ku konteston laboratorin e përzgjedhur nga ana e Komisionit Prokurimit Publik për kryerjen e analizimit të mostrave, i cili nuk ishte dakort që mostrat e tij të analizoheshin nga laborator i “Eko Studio Projekt” me pretendimin se ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me këtë laborator. Në lidhje me këtë kërkesë paraprake Komisioni gjykon të merret në konsideratë dhe do të kryejë verifikimet edhe njëherë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në lidhje me laboratorët e akredituar.

Në përfundim kërkesa e operatorit ekonomik ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK lidhet me rishimin e vendimit në lidhje me veprimet proceduriale të testimit të mostrave. Në përfundim të saj kjo seancë dëgjimore deklarohet e mbyllur.


Në datën 08.12.2025, përmes shkresës nr. 90 prot, datë 08.12.2025 protokolluar me tonën me nr. 2052/8 prot., datë 09.12.2025 është paraqitur nga operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK kërkesa me lëndë “*Kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 1798/2025, datë 04.12.2025*”. Nëpërmjetë së cilës ngren pretendime që mostrat e dorzuara prej tij të mos analizohen nga laborator i Eko Studio Projekt pasi ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, por të përzgjidhet një laborator tjetër. Si rrejdhojë e pretendimeve të operatorit ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik në datën 06.01.2026, mori vendimin nr. 19/2026, për kryerjen e ekspertizës së analizimit të komponentëve 1- *Gramaturë*; 2- *pH*; 3- *Bardhësi/ngjyrë* për operatorin ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK për mostrat - kuti për ruajtje të përherëshme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përherëshme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përherëshme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - dosje për ruajtje të përherëshme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), nga laborator i akredituar i shoqërisë “*Eko-Studio Projekt*” SHPK, dhe për operatorin ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK për mostrat - kuti për ruajtje të përherëshme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përherëshme për amza (40x55x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - kuti për ruajtje të përherëshme për regjistra (40x70x9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm); - dosje për ruajtje të përherëshme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), nga laborator i akredituar i shoqërisë “*ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing*” SHPK, nëse mostrat e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Në datën 12.01.2024, në prezencë të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK, Komisioni procedoi me dorëzimin e mostrave në laboratorin testues “*Eko – Studio – Projekt*” SHPK, po më datë 12.01.2024, në prezencë të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK, Komisioni procedoi me dorëzimin e mostrave në laboratorin testues “*ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing*” SHPK.

Me shkresën nr. 369 prot., datë 16.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 2052/14, datë 21.01.2026, me objekt “*Dorëzim i raporteve të analizave laboratorike*”, laborator i testues “*ECCAT*” SHPK, ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik Raport - Testimin në zbatim të vendimit nr. 19/2026, datë 06.01.2026, ndër të tjera me përmbajtje edhe si vijon:



ENVIRONMENTAL CONSULTING, CHEMICAL ANALYSIS & TESTING



Nr. 369 Prot.

Tiranë më: 16/01/2026

Shkresë Përcjellëse

DREJTUAR: Komisionit të Prokurimit Publik (KPP)

LËNDA: Dorëzim i raporteve të analizave laboratorike

Me anë të kësaj shkrese përcjellëse, shoqëria ECCAT sh.p.k. paraqet dhe dorëzon raportet e analizave për katër mostrat e sjella pranë laboratorit më datë 12.01.2026 nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), në zbatim të Vendimit nr. 19/2025, me Nr.Prot. 2052/11, datë 06.01.2026

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

Për ECCAT sh.p.k.
Fatlinda Ballabani



RAPORT ANALIZË MATJA E PARAMETRAVE TË KARTONIT



Data e raportimit: 15.01.2026

Operatori: Komisioni Prokurimit Publik (KPP)

NIPT: -

Klient: Komisioni Prokurimit Publik (KPP)

Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë

Qyteti: Tiranë

Shteti: Shqipëri

Informacioni i Mostrës

Identifikimi:

001/01/2026

Matrica:

Karton

Data e marrjes mostrës:

12/01/2026

Data e pranimit mostrës:

12/01/2026

Data e fillimit të testimit:

12/01/2026

Data e mbarimit të testimit:

14/01/2026

Mostruesi:

Klient

Vendndodhja e kryerjes së testit:

Laborator

Raport Nr.1 – Kuti për ruajtje të përhershme 40x28x18cm

Nr.	Parametri	Njësia	Rezultati	Metoda e Analizës
1.	Gramatura	g/m ²	637.33	ISO 536:2019
2.	pH	-	7.44	ISO 6588-1:2021
3.	Percaktimi i bardhësisë CIE, C/2°	-	70.2	ISO 11476:2016

**Shënim : Rezultati i referohet mostres se sjelle nga Komisioni Prokurimit Publik (KPP) ne daten 12/01/2026 per subjektin Kristalina KH me NIPT K11501002D dhe Adrese: Tiranë, LORD BAJRONI-LAPRAKE.*

INFORMACION MBI MOSTREN

- Përmasat paraqesin një tolerancë prej ± 3 mm.
- Indeksi i bardhësisë i referohet ngjyrës së kutisë, e cila korrespondon me Pantone 427c.

Administrator

Data e raportimit: 15.01.2026

Operatori: Komisioni Prokurimit Publik (KPP)

NIPT: -

Klient: Komisioni Prokurimit Publik (KPP)

Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë

Qyteti: Tiranë

Shteti: Shqipëri

Informacioni i Mostrës

Identifikimi: 002/01/2026

Matrica: Karton

Data e marrjes mostrës: 12/01/2026

Data e pranimit mostrës: 12/01/2026

Data e fillimit të testimit: 12/01/2026

Data e mbarimit të testimit: 14/01/2026

Mostruesi: Klient

Vendndodhja e kryerjes së testit: Laborator

Raport Nr.2 – Kuti per ruajtje te perhershme per amza 40x55x18cm

Nr.	Parametri	Njësia	Rezultati	Metoda e Analizës
1.	Gramatura	g/m ²	625.64	ISO 536:2019
2.	pH		7.20	ISO 6588-1:2021
3.	Percaktimi i bardhësisë CIE, C/2°	-	70.2	ISO 11476:2016

**Shënim : Rezultati i referohet mostres se sjelle nga Komisioni Prokurimit Publik (KPP) ne daten 12/01/2026 per subjektin Kristalina KH me NIPT K11501002D dhe Adrese: Tiranë, LORD BAJRONI-LAPRAKE .*

INFORMACION MBI MOSTREN

- Përmasat paraqesin një tolerancë prej ±3 mm.
- Indeksi i bardhësisë i referohet ngjyrës së dosjes, e cila korrespondon me Pantone 427c.

Administratë
Fatlinda Ballabani

Data e raportimit: 15.01.2026

Operatori: Komisioni Prokurimit Publik (KPP)

NIPT: -

Klient: Komisioni Prokurimit Publik (KPP)

Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë

Qyteti: Tiranë

Shteti: Shqipëri

Informacioni i Mostrës

Identifikimi: 003/01/2026

Matrica: Karton

Data e marrjes mostrës: 12/01/2026

Data e pranimit mostrës: 12/01/2026

Data e fillimit të testimit: 12/01/2026

Data e mbarimit të testimit: 14/01/2026

Mostruesi: Klient

Vendndodhja e kryerjes së testit: Laborator

Raport Nr.3 – Kuti per ruajtje te perhershme per regjistra 40x70x9cm

Nr.	Parametri	Njësia	Rezultati	Metoda e Analizës
1.	Gramatura	g/m ²	617.48	ISO 536:2019
2.	pH		7.29	ISO 6588-1:2021
3.	Percaktimi i bardhësisë CIE, C/2°	-	70.2	ISO 11476:2016

**Shënim : Rezultati i referohet mostres se sjelle nga Komisioni Prokurimit Publik (KPP) ne daten 12/01/2026 per subjektin Kristalina KH me NIPT K11501002D dhe Adrese: Tiranë, LORD BAJRONI-LAPRAKE .*

INFORMACION MBI MOSTREN

- Përmasat paraqesin një tolerancë prej ±3 mm.
- Indeksi i bardhësisë i referohet ngjyrës së kutisë, e cila korrespondon me Pantone 427c.

Administratë
Fatlinda Ballabani

Data e raportimit: 15.01.2026

Operatori:	Komisioni Prokurimit Publik (KPP)	Informacioni i Mostrës	
NIPT:	-	Identifikimi:	004/01/2026
Klient:	Komisioni Prokurimit Publik (KPP)	Matrica:	Karton
Adresa:	Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë	Data e marrjes mostrës:	12/01/2026
Qyteti:	Tiranë	Data e pranimit mostrës:	12/01/2026
Shteti:	Shqipëri	Data e fillimit të testimit:	12/01/2026
		Data e mbarimit të testimit:	14/01/2026
		Mostruesi:	Klient
		Vendndodhja e kryerjes së testit:	Laborator

Raport Nr.4 – Dosje për ruajtje të përhershme 36x24cm

Nr.	Parametri	Njësia	Rezultati	Metoda e Analizës
1.	Gramatura	g/m ²	326.95	ISO 536:2019
2.	pH	-	7.14	ISO 6588-1:2021
3.	Percaktimi i bardhësisë CIE, C/2°	-	70.2	ISO 11476:2016

**Shënim : Rezultati i referohet mostrës së sjellë nga Komisioni Prokurimit Publik (KPP) në datën 12/01/2026 për subjektin Kristalina KH me NIPT K11501002D dhe Adresë: Tiranë, LORD BAJRONI-LAPRAKE.*

INFORMACION MBI MOSTREN

- Përmasat paraqesin një tolerancë prej ±3 mm.
- Indeksi i bardhësisë i referohet ngjyrës së dosjes, e cila korrespondon me Pantone 427c.

Administrator
Fatllinda Ballabani

III.12.10. KPP referuar Raportit të Testimit të mostrave, me nr. 0001, 002, 003, 004, datë 15.01.2026, dërguar në KPP me anë të shkresës nr. 369 prot., datë 16.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 2052/14 prot., datë 16.01.2026, nga Laboratori “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave të sipërpërmendura, konstaton, se mostrat për kutitë e kartonit dhe dosjes, të operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK të paraqitura për testim, janë në përputhje me specifikimet teknike, për sa i përket gramaturës, pH, ngjyrës së tyre, konkretisht nga ana e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike **1- Për kutinë për ruajtje të përhershme** është kërkuar që kutia të ketë këto përmasa (40 x 28 x 18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), gramatura të jetë së paku 615 g/m², pH midis 7.0 dhe 9.5, ngjyra pantone 427c – 429c. Sipas raportit të testimit të laboratorit “ECCAT” SHPK rezulton, se gramatura për këtë kuti është 637.33 g/m² pra është mbi minimumin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, pH për këtë kuti është 7.44 pra ndërmjetë vlerave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, ngjyra korrespondon me kodin pantone 427c të kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, si dhe përmasat paraqesin një tolerancë +/- 3 mm. **2- Për kutinë për ruajtje të përhershme për amza** është kërkuar që kutia të ketë këto përmasa (40 x 55 x 18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), gramatura të jetë së paku 615 g/m², pH midis 7.0 dhe 9.5, ngjyra pantone 427c – 429c. Sipas raportit të testimit të laboratorit “ECCAT” SHPK rezulton, se gramatura për këtë kuti është 625.64 g/m² pra është mbi minimumin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, pH për këtë kuti është 7.20 pra ndërmjetë vlerave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, ngjyra korrespondon me kodin pantone 427c të kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike si dhe përmasat paraqesin një tolerancë +/- 3 mm. **3- Për**

kutinë për ruajtje të përhershme regjistra është kërkuar që kutia të ketë këto përmasa (40 x 70 x 9) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), gramatura të jetë së paku 615 g/m², pH midis 7.0 dhe 9.5, ngjyra pantone 427c – 429c. Sipas raportit të testimit të laboratorit “ECCAT” SHPK rezulton, se gramatura për këtë kuti është 617.48 g/m² pra është mbi minimumin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, pH për këtë kuti është 7.29 pra ndërmjetë vlerave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, ngjyra korrespondon me kodin pantone 427c të kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike si dhe përmasat paraqesin një tolerancë ± 3 mm. **4- Për dosjen për ruajtje të përhershme** është kërkuar që dosja të ketë këto përmasa (36 x 24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm), gramatura të jetë së paku 325 g/m², pH midis 7.0 dhe 9.5, ngjyra pantone 427c – 429c. Sipas raportit të testimit të laboratorit “ECCAT” SHPK rezulton, se gramatura për këtë kuti është 326.95 g/m² pra është mbi minimumin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, pH për këtë kuti është 7.14 pra ndërmjetë vlerave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, ngjyra korrespondon me kodin pantone 427c të kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike si dhe përmasat paraqesin një tolerancë ± 3 mm.

Në përfundim, sa më sipër analizuar, nga verifikimi i dokumentacionit dhe Raporteve të Testimit të mostrave me nr. 001, 002, 003, 004 prot., datë 15.01.2026, dërguar në KPP, me anë të shkresës nr. 369 prot., datë 16.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 2052/14 prot., datë 16.01.2026, të Laboratorit të akredituar “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, konstatohet, se komponenti gramaturë, pH, ngjyrë për mostrat kuti dhe dosje, është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor, për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, sipas treguesve të raporteve të testimit të kryer nga laboratorit “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK rezulton, se gramatura, pH dhe ngjyra e mostrave të operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për komponentet të cilat iu nënshtruan testimit nga laboratorë në Republikën e Shqipërisë të akredituar nga Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, ku referuar faqes zyrtare rezulton, se laboratorit testues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, është i akredituar me numër akreditimi LT 128, datë 11.03.2024.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK për mospërmbushje të specifikimeve teknike, nga sa më sipër, referuar informacionit dhe dokumentacionit të administruar, Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se kur nga vetë organi kompetent i caktuar me ligj si më sipër cituar, pra Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk ka një standart të miratuar apo laborator të akredituar për të kryer ato analizime, vlerësojmë se nuk mund të shprehim dhe të vlerësojmë përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të autoritetit kontraktor, për sa kohë që as ligji i prokurimit publik, dhe as aktet nënligjore në zbatim të tij nuk parashikojnë në asnjë rast kompetencën e KPP-së për t’u shprehur në lidhje me përputhshmërinë e tyre. Ndaj dhe

Komisioni mori në analizim vetëm ato specifikime për të cilat ka një standart të miratuar dhe një laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Për sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK nuk qëndron.

III.13. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK me arsyetimin se: *“Së Gjashti, Operatori ekonomik Kristalina KH shpk nuk disponon personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, në pikën 2.3.2. kapaciteti teknik, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, përcaktohet: 2. Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) punonjës, ku përfshihet edhe stafi teknik si më poshtë: - 1 (një) dizenjues (ose staf teknik ekuivalent) kërkesa për 1 (një) dizenjues është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi. - 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit kërkesa për 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi. - 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse kërkesa për 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi. - 1 (një) Shofer, i cili mund të jenë edhe me kontratë shërbimi. - 1 (një) punëtor shpërndarje. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet për plotësimin e këtij kriteri: - Listëpagesa e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik. - Kontrata pune të vlefshme, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme. - Kontratat e shërbimit të vlefshme për të gjithë periudhën kohore të realizimit të kontratës objekt prokurimi, për specialistët 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent; 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse dhe shoferin, në rast se këta punonjës janë me kontratë shërbimi. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme. - Diplome që vërteton kualifikim profesional për 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent. Ky dokument do të paraqitet për këtë punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur është marrë me kontratë shërbimi. Për punonjësit 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, duhet të paraqiten dokumentat: - Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional në drejtimin poligrafi të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ose Librezë pune apo çdo dokument të barazvlefshëm me të, që vërteton eksperiencën e punës jo më pak se dy vite në këtë profesion. Dokumentat e kërkuara për 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit dhe 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, do të paraqitet për këta punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur janë marrë me kontratë shërbimi. Shenim: Kriteri*

nr. 2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. Në kemi bindjen që OE Kristalina KH shpk nuk disponon të gjithë personelin teknik të nevojshëm, referuar objektit të prokurimit, të kërkuar në DST. Gjithashtu, në kemi bindjen që OE Kristalina KH shpk nuk ka paraqitur pranë AK dokumentacionin e nevojshëm ligjor, me anë të së cilës provohet/vërtetohet disponimi i stafit / personelit teknik të kërkuar në DST, si dhe dokumentacioni plotësues i kërkuar në DST. Së fundi, do të donim të parashtronim, se stafi / personeli teknik, i deklaruar nga OE Kristalina KH shpk., nuk është i regjistruar në listëpagesat e këtij operatori ekonomik, me kodet korresponduese përkatëse, sipas profesioneve të kërkuara në DST, objekt ankese, dhe në përputhje me kodet e listës kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”. Rrjedhimisht, përse i përket këtij kriteri teknik / profesional. Bazuar në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, si dhe në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST, OE Kristalina KH shpk do të duhet të skualifikohet”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.13.1. Në shtojcën 8/2, “Kriteret e Veccanta të kualifikimit” të dokumentave të tenderit, pikën 2.1.a është përcaktuar kriteret si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

III.13.2. Në shtojcën 8/2, “Kriteret e Veccanta të kualifikimit” të dokumentave të tenderit, pikën 2.3.2 “Kapacitetit teknik” është përcaktuar kriteret si më poshtë:

Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) punonjës, ku përfshihet edhe stafi teknik si më poshtë:

- 1 (një) dizenjues (ose staf teknik ekuivalent)
Kërkesa për 1 (një) dizenjues është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.
- 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit
Kërkesa për 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.
- 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse
Kërkesa për 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse është e detyrueshme vetëm në rastin kur operatorët ekonomikë ofertojnë në cilësinë e prodhuesit të mallrave. Ky punonjës mund të jetë edhe me kontratë shërbimi.

- 1 (një) Shofer, i cili mund të jenë edhe me kontratë shërbimi.
- 1 (një) Punëtor shpërndarje.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet për plotësimin e këtij kriteri:

- Listëpagesa e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik.
- Kontrata pune të vlefshme, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme.
- Kontratat e shërbimit të vlefshme për të gjithë periudhën kohore të realizimit të kontratës objekt prokurimi, për specialistët 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent; 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse dhe shoferin, në rast se këta punonjës janë me kontratë shërbimi. Për shoferin të paraqitet edhe leje drejtimi e vlefshme.
- Diplome që vërteton kualifikim profesional për 1 (një) dizenjues ose staf teknik ekuivalent. Ky dokument do të paraqitet për këtë punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur është marrë me kontratë shërbimi.

Për punonjësit 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit; 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, duhet të paraqiten dokumentat:

- Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional në drejtimin “Poligrafi” të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- ose
- Librezë punë apo çdo dokument të barazvlefshëm me të, që vërteton eksperiencën e punës jo më pak se dy vite në këtë profesion.

Dokumentat e kërkuara për 1 (një) ofsesist për makinën e shtypit dhe 1 (një) ofsesist/ punonjës prerës për makinat prerëse, do të paraqitet për këta punonjës, si në rastin kur është pjesë e stafit të operatorit ekonomik ashtu edhe në rastin kur janë marrë me kontratë shërbimi.

Shenim: Kriteri nr. 2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

III.13.3. Në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën III, “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, ndër të tjera, parashikohet se:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:

Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Profili i punonjësve</u> _____ <u>Makineri e mjete</u> Po [☐] Jo [☐] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

III.13.4. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar fizikisht nga autoritetit kontraktor si dhe dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK ka dorëzuar:

- Shtojca 9 Formualri Përmbledhës Vetëdeklarimit i plotësuar në të gjitha fushat i firmosur dhe vulosur.

B: DEKLARATË	
Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)	
Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [☒] Jo [☐] Nëse, po, numri i punonjësve: Numri i punonjësve është 20(njëzet). Profili i punonjësve: Të gjitha profilet e nevojshme dhe të kërkuara në DST për realizimin e plotë të kontratës në përputhje me DST. Deklaroj se disponoj në stafin tim : 1 (një) dizenjues: Znj. Ana Cara deklaruar me kodin 2163.11 1 (një) ofsetist për makinën e shtypit: Z. Albert Madani deklaruar me kodin 7321.13 1 (një) ofsetist/punonjës prerës për makinat



	prerëse : Znj. Anida Qori deklaruar me kodin 7323.11 • 1 (një) Shofer: Z.Elvis Dodaj deklaruar me kodin 8322.01 • 1 (një) Punëtor shpërndarje: Z.Ardjan Brahimi deklaruar me kodin 9621.06 Gjithashtu gjeni të ngarkuara kontratat sipas ligjit në fuqi për secilin prej punonjësve të deklaruar me sipër si dhe diplomën dhe certifikatën për dizenjatorin , lejen e drejtimit për shoferin, librezat e punës për ofsetistin për makinën e shtypit, punonjës in prerës për makinat prerëse dhe për dizenjatorin. Gjithashtu në SPE gjeni dhe Vërtetimin për pagimin e kontributeve si dhe listepagesat për muajin mars, prill dhe maj 2025. Makineri e mjete Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: Deklaroj se disponoj të gjitha makineritë e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Deklaroj se diponoj: • 1 (një) mjet transporti në pronësi të shoqërisë tonë me targë AA982XH. Mjeti është i paisur me : Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor, Leje Qarkullimi, Siguracion mjeti, Certifikatë e Kontrollit teknik të mjetit , taksat vjetore të mjetit të paguara. Të ngarkuara ne SPE gjeni dokumentacionin e mesiperm për mjetin e transportit.
Emri, Mbiemri: Z.Kadri Hykaj Firma _____ Vula _____	

- Dokumentacioni fizik i operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe ardhur me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025 protokolluar me tonën me nr. 2052/4 prot datë 13.08.2025, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka dërguar edhe dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, konkretisht edhe dokumentacionin e punonjësve si më poshtë [...]

Nr	Profesioni	Numri i punonjesve	Dokumentacioni fizik i dorëzuar
1	Dizenjues (ose staf teknik ekuivalent)	1	Kontratë pune midis subjektit Kristalina KH shpk dhe Znj. A. C, datë 01.04.2023, Diplomë nr. 4607 të lëshuar nga UT, me titull Piktör, Dëshmi për kryerjen e trajnimit professional Dizajn Grafik Nr. 000166, Librezë P, Listpagesa.
2	Ofsetist për makinën e shtypit	1	Kontratë pune midis subjektit Kristalina KH shpk dhe Z. A. M, datë 01.04.2023, Librezë P, Listpagesa.
3	Ofsetist/punonjës prerës për makinat prerëse	1	Kontratë pune midis subjektit Kristalina KH shpk dhe Z. A. Q, datë 01.04.2023, Librezë P, Listpagesa.

4	Shofer	1	Kontratë pune midis subjektit Kristalina KH shpk dhe Z. E. D, datë 01.07.2023, Leje Drejtimi, Listpagesa.
5	Punëtor shpërndarje	1	Kontratë pune midis subjektit Kristalina KH shpk dhe Z. A. B, datë 01.03.2025, Listpagesa.

III.13.5. Në neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.13.6. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.13.7. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën

sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.13.8. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat për mallra”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.13.9. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari 23 përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës”.

III.13.10. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..”*.

III.13.11. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.13.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.13.13. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, KPP vëren, se autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në shtojcën 8/2

“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, ka hartuar kriterin e pikës 2.3.2 të modifikuar. KPP konstaton, se qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar, të verifikohet, që operatorët ekonomikë të kenë staf të kualifikuar për realizimin e kontratës si dhe stafi i deklaruar të figurojë në listëpagesat e shoqërisë. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor konstaton, se ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur në SPE dhe dorëzuar fizikisht pranë KPP-së, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Kontratat e Punës për secilin punonjës të deklaruar, Diplomën/Certifikatat e kualifikimit, Libreza Pune, Leje drejtimi, si dhe listëpagesa. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe atij fizik pranë KPP-së nga operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit për të cilat ngre pretendime operatori ekonomik ankimues, referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, konkretisht kriterëve të veçanta të kualifikimit të pikës 2.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe fizikisht nga ana e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, Komisioni konstatoi që ky i fundit e plotëson kriterin 2.3.2, duke provuar se disponon punonjësit sipas profileve me dokumentacionin përkatës për realizimin e kontratës.

Gjithashtu në lidhje me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK se operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK nuk i ka deklaruar në listapagesa punonjësit sipas kodeve të përcaktuara në VKM 514, datë 20.09.2017. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

Në nenin 92 pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një

ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji". Komisioni i Prokurimit Publik thekson pozitën e tij të veçantë si një organ quazi gjyqësor dhe si i tillë në vendimarrjen e tij bazohet në fakt, prova dhe ligj. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 92 pika 4 e LPP-së, i cili parashikon se *"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji"*, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Në rastin konkret, KPP konstaton se referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor në drejtim të plotësimit të dëshmisë së fuqisë punëtore ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik detyrimin për dorëzimin e listëpagesave të punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi, për të gjithë punonjësit në rast se janë të punësuar pranë operatorit ekonomik. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit, kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në asnjë rast se punonjësit e kërkuar në pikën 2.3.2 të DST duhet të jenë të deklaruar në listpagesa sipas kodeve të profesioneve të parashikuar nga në VKM 514, datë 20.09.2017. Komisioni gjykon se pretendimet e cituara në ankesës nuk janë të mbështetura mbi ndonjë kriter, pra janë pretendime për një kriter të pakërkuar. Në këtë kuptim KPP gjykon, se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi janë mbështetur mbi kriterë të pakërkuara dhe të pa përcaktuar në Shtojcën 8/2 të dokumentave të tenderit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në

dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. KPP gjykon se në cilësinë e një organi quazi gjyqësor, në vendimarrjen e tij, ky i fundit i referohet parimeve të së drejtës *Judicis est judicare secundum allegata et probate* (organi vendos në bazë të fakteve dhe provave të administruara në proces). KPP nuk mund të gjykojë mbi plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit mbi kriterë të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në dokumentet e garës.

Për sa më sipër pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK nuk qëndrojnë.

III.14. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK me arsyetimin se: “Së Shtati, mendojmë që në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST, dhe rregullat e prokurimit publik, OE Kristalina KH shpk., ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur detyrime tatimore të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar mbi këtë ankesë dhe përsa i përket kësaj pike, të kërkojnë zyrtarisht një informacion nga Drejtoria e përgjithshme e Tatimeve”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.14.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit” pika 1 “dh” të dokumentave standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Ofertuesi deklaron se:

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

Këto kriterë duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9

III.14.2. Në shtojcën 8/2, “Kriteret e Veçanta të kualifikimit” të dokumentave të tenderit, pikën 2.1.a është përcaktuar kriteret si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

III.14.3. Në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë “Për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

III.14.4. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK;

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Vërtetim për pagimin e kontributeve, Vërtetim pagimin e detyrimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Vërtetim për likuidimin e detyrimeve vendore lëshuar nga Bashkia Tiranë

- Dokumentacioni fizik i operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe ardhur me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025 protokolluar me tonën me nr. 2052/4 prot datë 13.08.2025, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka dërguar edhe dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, konkretisht edhe:

- Vërtetim Nr. T13505690, datë 19.06.2025 (Për Pagim Detyrimesh), nga ku vërtetohet se tatimpaguesi “Kristalina KH” SHPK nuk ka asnjë detyrim të papaguar deri më datë 19.06.2025.
- Vërtetim Nr. T13515284, datë 20.06.2025 (Për Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin E-Sig 02/a), nga ku vërtetohet se tatimpaguesi “Kristalina KH” SHPK nga të dhënat për kontributet të regjistruara në organin tatimor deri në datë 20.06.2025, që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datë 20.06.2025, rezultron se ky subjekt ka për të paguar 0 lekë detyrime, nga të cilat: Kontribute gjithsej 0 lekë. Kamatëvonesa për kontribute 0 lekë. Gjoba lidhur me kontributet 0 lekë.

III.14.5. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.14.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta,

formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”.

III.14.7. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.14.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 Shtuar me VKM 498/2024 22 Shtuar me VKM 498/2024 30 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.14.9. Në pikën a) të nenit 11, të ligjit nr. 9163, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar parashikohet se: “Deklarimet e parashikuara në nenin 10 dhe pagesa

e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme: a) nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër”.

III.14.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.14.11. Konkretisht, referuar kriterëve të përgjithshme të kualifikimit pikës dh) të shtojcës 8 ku përcaktohet se nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se, këto kërkesa do të përmbushen nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr. 1092/32 prot., datë 12.08.2025, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2052/4 prot, datë 13.08.2025, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka dorëzuar dokumentacionin fizik të operatorit ekonomik “Kristaliona KH” SHPK që vërteton përmbushjen e deklarimeve të bëra në Shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të dorëzuar në dokumentacionin e ofertës. Nisur nga pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues me arsyetimin se: “OE Kristalina KH shpk., ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur detyrime tatimore të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara”. Komisioni konstaton se në përmbushje të pikës dh) të shtojcës 8 Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit operatori

ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin si vijon: - Vërtetim Nr. T13505690, datë 19.06.2025 (Për Pagim Detyrimesh), nga ku vërtetohet se tatimpaguesi “Kristalina KH” SHPK nuk ka asnjë detyrim të papaguar deri më datë 19.06.2025. -Vërtetim Nr. T13515284, datë 20.06.2025 (Për Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin E-Sig 02/a), nga ku vërtetohet se tatimpaguesi “Kristalina KH” SHPK nga të dhënat për kontributet të regjistruara në organin tatimor deri në datë 20.06.2025, që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datë 20.06.2025, rezultron se ky subjekt ka për të paguar 0 lekë detyrime, nga të cilat: Kontribute gjithsej 0 lekë. Kamatëvonesa për kontribute 0 lekë. Gjoha lidhur me kontributet 0 lekë. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, KPP vëren, se qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet vetdeklarimeve dhe dokumentacionit të dorëzuar në autoritetin kontraktor pasi të shpallen fitues, të verifikohet, që operatorët ekonomikë nuk kanë detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të maturuara të pashlyera. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor konstaton, se ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur në SPE dhe dorëzuar fizikisht pranë KPP-së, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, vërtetimet e sipërcituara të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe atij fizik pranë KPP-së nga operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit pikës dh) të shtojcës 8 ku përcaktohet se nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së, nga verifikimet e kryera Vërtetimit Nr. T13505690, datë 19.06.2025 dhe Vërtetim Nr. T13515284, datë 20.06.2025, rezulton se në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi operatori ekonomik “Krtistalina KH” SHPK nuk ka patur detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të maturuara të pashlyera dhe për më tepër, sipas përcaktimeve në nenin 11 të ligjit nr. 9163, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar parashikohet se: “Deklarimet e parashikuara në nenin 10 dhe pagesa e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme: a) nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër”. Në rastin konkret operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK rezulton se nuk ka patur detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të pashlyera në datë 23.06.2025, duke përmbushur kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën/dh “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit” të Shtojcën 8 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.15. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK se: “Gjithashtu, mendojmë që OE Kristalina KH shpk., nuk ka paraqitur / dorëzuar në sistemin SPE të APP, një vërtetim të vlefshëm, i cili vërteton shlyerjen e të gjitha

detyrimeve të faturave të energjisë elektrike. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk., do të duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe në rregullat e prokurimit publik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.15.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “e” e dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

[...]

Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

III.15.2. Në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë “Për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____.

III.15.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar fizikisht nga autoritetit kontraktor si dhe dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK ka dorëzuar:

- Shtojca 10 Formulari Përmbledhës Vetëdeklarimit i plotësuar në të gjitha fushat i firmosur dhe vulosur.

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Vërtetim debie nga Furnizuesi i Shërbimit Universal
--

- Dokumentacioni fizik i operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe ardhur me shkresën nr. 1092/32 prot, datë 12.08.2025 protokolluar me tonën me nr. 2052/4 prot datë 13.08.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, ku ndër të tjera është dorëzuar edhe dokumenti: Vërtetim debie nr. OSHEE-2025-2332120-KS, datë 18.06.2025, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z. K.H, vërtetojmë se kërkuesi Kristalina KH SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod)

TR2D070XXXXXXXX26, titullar i të cilave është “Kristalina KH” SHPK, rezulton te kete ne total 0 lekë detyrime per faturat e energjise elektrike, vlere e llogaritur deri me daten 18.06.2025 përfshirë faturën koherente të muajt Maj 2025.

III.15.4. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohe për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurë.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohe të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë. 5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.

III.15.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.15.6. Në nenin 77 pika 1 të ligjit 162/2020 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.15.7. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, A, parashikohet “Deklaratë Për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”. Nisur nga pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë

ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, dhe nga dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës nr. prot 1092/32 prot, datë 12.08.2025, protokolluar në KPP me nr. 2052/4, datë 13.08.2025, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, gjithsej 436 faqe. Referuar pretendimeve të ankimuesit, se operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK nuk përmbush kriterin lidhur me deklaratimet dhe vërtetimet e OSHEE, Komisioni i Prokurimit Publik pasi verifikoi dokumentacionin e ardhur nga autoriteti kontraktor konkretisht “Vërtetim debie nr. OSHEE-2025-2332120-KS, datë 18.06.2025, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z. K.H, vërtetojmë se kërkuesi Kristalina KH SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod) TR2D070XXXXXX26, titullar i të cilave është “Kristalina KH” SHPK, rezulton te kete ne total 0 lekë detyrime per faturat e energjise elektrike, vlere e llogaritur deri me daten 18.06.2025 përfshirë faturën koherente të muajt Maj 2025”.

III.15.8. Në nenin 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do ti dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.”.

III.15.9. Në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.”.

III.15.10. KPP, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë tij, si dhe duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, lidhur me një nga pretendimet e ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, dhe pasi verifikoi dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor konkretisht dokumentin “Vërtetim debie nr. OSHEE-2025-2332120-KS, datë 18.06.2025, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z. K.H, vërtetojmë se kërkuesi Kristalina KH SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod) TR2D070XXXXXX26, titullar i të cilave është “Kristalina KH” SHPK, rezulton te kete ne total 0 lekë detyrime per faturat e energjise elektrike, vlere e llogaritur deri me daten 18.06.2025 përfshirë faturën koherente të muajt Maj 2025”. Referuar informacionit të dhënë nga Furnizuesi Shërbimit Universal Sh.A., i cili menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike, për të gjithë kontratat e lidhura midis Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA dhe subjekteve përdoruese të

energjisë elektrike, me anë të së cilës vërtetohet, se subjekti “*Kristalina KH*” SHPK nuk rezulton debitor, përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit. Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në autoriteti kontraktor, i cili shërben si provë për vertetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmush kërkesat e autoritetit kontraktor. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar për përmushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit, operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së, si dhe nga verifikimi i kryer rezulton se operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor.

III.16. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Marketing & Distribution*” SHPK në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK në këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.16.1. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “*Afatet për ankimim*” të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.16.2. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.

III.16.3. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet: “1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.16.4. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimitimi locus standi), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t'u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.16.5. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës, pasi pas ankesës së bërë nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, dhe pranimit nga KPP, statusi i operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK do të ndryshojë nga i kualifikuar në të skualifikuar si rrjedhojë e mos përmbushjes së specifikimit teknik gramaturës së kutive dhe dosjes. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin, do të ndryshojë status nga kualifikuar në të skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundërt atij imagjinar), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK nuk merren në shqyrtim.

III.17. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, referuar vlerësimit të kryer nga autoritetit kontraktor, rezulton se operatori ekonomik ankimues “Kristalina KH” SHPK ka ofertuar me vlerë më të ulët kundërt operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK për të cilët paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur kështu një interes të ligjshëm të ankohet për operatorë ekonomikë të renditur sipër tij, referuar vlerës

ekonomike. Sa më sipër, KPP gjykon, se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Në rastin konkret, KPP konstaton, se operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, rezulton i klasifikuar me ofertë më të ulët ekonomike se operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, rrjedhimisht duke mos patur interes mbi kualifikimin e këtyre të fundit. Akoma më tej, referuar arsyetimit të këtij vendimi operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, do të vijojë të qëndrojë i kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, duke realizuar kështu interesin e tij të ligjshëm dhe nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi të cilët kanë ofertuar me një vlerë më të lartë ekonomike.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dynamicx Group” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas

Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
3. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
4. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
5. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

6. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së, për kualifikimin e operatorit ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
 7. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 8. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK, “*Dynamicx Group*” SHPK, “*Marketing & Distribution*” SHPK dhe “*Adel Co*” SHPK.
 9. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK.
 10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 11. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiovent Zguro

